



**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**

**DEPARTAMENTI I MONITORIMIT/DIVIZIONI PËR SUNDIMIN E LIGJIT**  
**Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor**

**Privatizimi në Kosovë:**

**Shqyrtim Juridik i**  
**Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga**  
**Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme**

**Maj 2008**

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
<b>I. HYRJE.....</b>	<b>6</b>
<b>II. HISTORIKU, EKSPROPRIJIMET DHE NDËRMARRJET NË PRONËSI SHOQËRORE .....</b>	<b>6</b>
A. EKSPROPRIJIMET, PRONËSIA SHOQËRORE, PRIVATIZIMET .....	6
B. ADMINISTRIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE .....	8
<b>III. KORNIZA LIGJORE MBI AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT.....</b>	<b>9</b>
A. AGJENCIA E MIRËBESIMIT ADMINISTRON NDËRMARRJET SHOQËRORE .....	9
B. SHITJA E FILIALEVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE .....	10
C. PRONËSIA .....	11
D. RIORGANIZIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE PËRMES PROCEDURAVE TË MORATORIUMIT .....	12
E. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE .....	13
1) Pezullimi i mundshëm i padive dhe anulimi i transaksioneve.....	13
2) Komisionet e Likuidimit.....	14
3) Shqyrtimi i vendimeve të Komisioneve të Likuidimit nga Komisioni Shqyrtues dhe Dhoma e Veçantë.....	15
F. TRANSFORMIMI I SË DREJTËS PËR SHFRYTËZIM TË PRONËS NË QIRA .....	15
G. TË DREJTAT E PUNONJËSVE LEGJITIM TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE .....	16
1) Punonjësit që kanë të drejtë në 20% nga të ardhurat.....	16
2) Lista e punonjësve legjitim (“lista e punonjësve”) dhe shqyrtimi.....	16
3) Dëshmia e diskriminimit .....	17
4) Radhitja e ankesave të punonjësve në likuidim .....	17
H. SIGURIA E KËRKESAVE LIDHUR ME NDËRMARRJE SHOQËRORE.....	17
I. POZICIONI I AGJENCISË SË MIRËBESIMIT DHE I DREJTORËVE TË SAJ .....	18
1) Përgjegjësitë e kufizuara të Agjencisë të Mirëbesimit dhe juridiksioni ekskluziv i Dhomës së Veçantë.....	18
2) Përgjegjësia e Bordit dhe e personelit të Agjencisë të Mirëbesimit.....	18
<b>IV. PROBLEMET LEGJISLATIVE ME KORNIZËN LIGJORE MBI AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT .....</b>	<b>19</b>
A. LEGJISLACIONI ËSHTË I NDËRLIKUAR.....	19
B. LEGJISLACIONIT NDONJËHERË I MUNGOJNË HOLLËSITË .....	19
C. MIRËBESIMI NUK ËSHTË I DEFINUAR, KONCEPTET TJERA NUK JANË TË QARTA .....	20
D. PEZULLIMI I PROCEDURAVE KU PËRFSHIHEN KËRKESAT PËR PRONËSI NË LIKUIDIM DHE KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT .....	21
E. DËSHMIA E DISKRIMINIMIT NË RASTET ME LISTAT E PUNONJËSVE .....	22
F. PUBLIKIMI NGA ANA E AGJENCISË SË MIRËBESIMIT, I POLITIKAVE OPERATIVE, RAPORTET VJETORE DHE RAPORTET E AUDITIVIT .....	23
1) Politikat operative .....	23
2) Raportet tremujore dhe vjetore.....	24
H. ZGJEDHJA E LIGJIT DHE RREGULLAT E TENDERIMIT.....	24
<b>V. PRIVATIZIMI MUND TË DËRGOJË NË EKSPROPRIJIM TË PALIGJSHËM.....</b>	<b>25</b>
A. EKSPROPRIJIMI SIPAS PROTOKOLLIT 1 TË KONVENTËS .....	26
B. NENET 5.3 DHE 5.4 TË RREGULLORES SË UNMIK-UT 2005/18.....	28
C. S’KA SHFUQIZIM, S’KA RIKTHIM.....	31
D. MASAT E PËRKOHSHME.....	32
E. DHOMA E VEÇANTË URDHËROI QË KONVENTA MBIZOTËRON LIGJIN VENDOR .....	33
<b>VI. KORNIZA LIGJORE MBI DHOMËN E VEÇANTË .....</b>	<b>34</b>
A. JURIDIKSIONI I DHOMËS SË VEÇANTË .....	35
B. GJYQTARI RAPORTUES DHE PROCEDURAT NORMALE.....	36
C. REFERIMI I PADIVE TEK GJYKATAT E RREGULLTA.....	37
D. KOLEGJET ME TRE GJYQTARË .....	38
E. NJË SHKALLË, ANKESË E KUFIZUAR .....	38

F. RISHQYRTIMET DHE ANKESAT .....	39
G. RREGULLAT TJERA PROCEDURALE .....	40
<b>VII. PROBLEMET LEGJISLATIVE ME KORNIZËN LIGJORE MBI DHOMËN E VEÇANTË..</b>	<b>40</b>
A. ANKESA E KUFIZUAR DHE PËRPUTHSHMËRIA ME STANDARDET PËR TË DREJTAT E NJERIUT .....	40
B. EMËRIMI I GJYQARËVE DHE PAVARËSIA E DHOMËS SË VEÇANTË.....	41
C. FUNKSIONET E SHUMËFISHTA DHE PAANËSIA E GJYQARËVE .....	42
<b>VIII. SHQETËSIMET E IDENTIFIKUARA NË SHQYRTIMIN GJYQËSOR TË</b>	
<b>AKTGJYKIMEVE TË DHOMËS SË VEÇANTË.....</b>	<b>43</b>
A. PUBLIKIMI I VENDIMEVE.....	43
B. GJYKATAT E RREGULLTA MARRIN JURIDIKSIONIN .....	44
C. CILËSIA E PËRFAQËSIMIT LIGJOR.....	46
1) Mungesa e njohurisë mbi ligjet në fuqi.....	47
2) Përgatitje e dobët apo dështim që të paraqitet në seancat gjyqësore.....	47
3) Mungesa e autorizimit të avokatit .....	49
D. VONESAT.....	50
E. GABIMET ADMINISTRATIVE .....	51
<b>IX. KONKLUZION .....</b>	<b>52</b>
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>53</b>
<b>SHTOJCA I: FAKTET DHE SHIFRAT E AGJENCISË SË MIRËBESIMIT DHE DHOMËS</b>	
<b>SË VEÇANTË.....</b>	<b>55</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport analizon privatizimin dhe shqyrtimin gjyqësor të vendimeve të privatizimit në Kosovë në frymën e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>1</sup> Ai përshkruan rregullat që qeverisin Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Agjencinë), institucion i ngarkuar me procesin e privatizimit, dhe Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, (Dhoma e Veçantë) që është organi gjyqësor me juridiksion për të shqyrtuar çështjet e privatizimit. Veç kësaj, raporti zbulon brengat që dalin nga monitorimi i drejtpërdrejt nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE), i rasteve pranë Dhomës së Veçantë.<sup>2</sup>

Agjencia e Mirëbesimit transferon disa asete dhe përgjegjësi të ndërmarrjeve shoqërore në filiale të formuara rishtas dhe pastaj i shet aksionet e këtyre filialeve në ankande publike. Ajo likuidon ndërmarrjet dhe asetet e mbetura dhe asetet, siç kërkohet me Rregulloret relevante të UNMIK-ut dhe i përdorë të ardhurat për t'i paguar pronar të dhe kreditorët e likuidimit dhe për të bërë disa pagesa të parapara me statut për punonjësit e mëparshëm dhe aktual të që kanë këtë të drejtë.

OSBE-ja është e brengosur për ndërlikueshmërinë e Rregulloreve dhe Urdhërave Administrative lidhur me procesin e privatizimit. Gjithashtu, rregullave ndonjëherë ju mungojnë hollësitë dhe nuk sqarojnë koncepte të rëndësishme, siç është ajo e mirëbesimit. Raporti analizon mbrojtën ligjore të punonjësve dhe sugjeron që Agjencia Kosovare e Mirëbesimit t'i vë në dispozicion të publikut politikat e saj operative dhe disa informacione tjera.

Rregullat legjislativë që qeverisin procesin e privatizimit kushtëzon se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit mund të shes pronë në pronësi të palëve të treta dhe se duhet t'u paguaj atyre vetëm kompensim nga të ardhurat e shitjes. Kjo mund të shkel standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, -- siç është neni 1 i Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) -- meqë privatizimi mund të rezultojë me eksproprijim pa pasur garancitë e nevojshme dhe kompensimin adekuat. Kjo gjithashtu ka mundur të sjellë konfuzion mes palëve, paditë pronësore të së cilave u janë refuzuar. Rishtas, Dhoma e Veçantë vendosi që disa nga dispozitat legjislativë që kanë të bëjnë me privatizimin, shkelin dhe tejkalojnë nenin 1 të Protokollit 1 dhe nenin 6 të Konventës.

Raporti gjithashtu përmbledh rregullat me të cilat udhëhiqen procedurat pranë Dhomës së Veçantë dhe identifikon mangësitë.

---

<sup>1</sup> Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (1950), konsiderohen të jenë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë sipas Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut Nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, neni 3.2 (b) dhe 3.3, dhe Rregulloren E UNMIK-ut Nr. 1999/24, neni 1 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/59.

<sup>2</sup> Sipas rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, OSBE-ja ka mandat të monitorojë sistemin e drejtësisë në Kosovë për përputhshmëri me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ky është raporti i parë i OSBE-së i bazuar në monitorimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. OSBE-ja filloi monitorimin e rasteve penale në vitin 1999, dhe zgjeroi monitorimin për të përfshirë edhe rastet civile në vitin 2004.

Duke u bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të Dhomës së Veçantë dhe shqyrtimit të shembujve të vendimeve, OSBE-ja vëren mangësi siç janë mospublikimi i vendimeve nga Dhoma e Veçantë, marrja e gabueshme e juridiksionit nga gjykatat e rregullta në raste të cilat duhet të shqyrtohen nga Gjykata Supreme, si dhe ushtrimi i dobët i detyrës nga avokatët para gjykatave.

Raporti përmbyllet me një numër rekomandimesh për legjislaturën, Dhomën e Veçantë, Agjencinë e Mirëbesimit, si dhe për aktorët tjerë relevant.

## **I. HYRJE**

Privatizimi në Kosovë është rishpërndarja e pasurive shoqërore tek individët privatë apo ndërmarrjet. Është proces ligjor i ndërlikuar dhe politikisht i ngarkuar, i cili do të ketë ndikim afatgjatë në ekonomi. Ai ka ndikim në shumë pronarë dhe punonjës të mëparshëm dhe ata aktual. Disa pronarë ose punonjës mund të përfitojnë diçka, përderisa të tjerët pothuajse asgjë. Ka gjithashtu edhe një komponentë etnike, meqë individët nga komunitete të ndryshme mund të thonë që diskriminimi i mëparshëm apo aktual ka ndikuar në mundësinë e tyre për të përfituar nga privatizimi. Kjo do të ndikojë në “margaritarët” e mundshëm të Kosovës, siç janë miniera e vlefshme e Trepçës dhe qendra skitare në Brezovicë/Brezovica. Kjo gjithashtu ndikon në shumë hotele, zotërimi pronash dhe biznese të vogla.

Privatizimi gjithashtu ngrit çështje emocionale nga e kaluara: konfiskimet, racionalizimet, krijimi i pronës shoqërore dhe më vonë transformimi i bizneseve. Kur privatizohet prona shoqërore, mund të ketë padi pronësore nga individët apo pasardhësit e tyre, të cilët kanë qenë pronarë të pronave para se të konfiskohen apo pas transformimit të tyre. Situata në Kosovë komplikohet edhe më tej sepse shumë regjistra të pronës janë zhdukur si rezultat i konfliktit të vitit 1999.

Rëndësia e procesit të privatizimit është pasqyruar në atë që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mbanë kompetencën ekskluzive për administrim të ndërmarrjeve dhe pronave. Procesi i privatizimit i është deleguar Agjencisë së Mirëbesimit dhe kontestet zakonisht parashtrihen pranë Dhomës së Veçantë.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/4 plotëson Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13 “Mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme për Çështjet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” që do të hyjë në fuqi me 31 maj 2008. Implikimet më të rëndësishme në këto plotësime përfshijnë rritjen e numrit të gjyqtarëve në Dhomën e Veçantë dhe krijimin e te drejtës për ankesë. Pritet se legjislacioni tjetër (siç është Urdhërsa Administrative mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë) si the Rregullorja dhe Urdhërsa Administrative mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit do të plotësohen gjithashtu.

## **II. HISTORIKU, EKSPROPRIJIMET DHE NDËRMARRJET NË PRONËSI SHOQËRORE**

### **A. Eksproprijimet, Pronësia Shoqërore, Privatizimet**

Valët e njëpasnjëshme të eksproprijimeve, nacionalizimeve, socializimeve dhe transformimeve që ndodhën gjatë periudhës së Jugosllavisë pas vitit 1945 dukshëm komplikojnë përpjekjet për privatizim në Kosovë.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Shih Institutin Kosovar për Hulumtim të Politikave dhe Zhvillim, *Misioni i OKB-së në Kosovë dhe privatizimi i Pronave shoqërore, Përvijim kritik i procesit aktual të privatizimit në Kosovë*, Prishtinë/Priština, qershor 2005, faqe 5-6, citat i V. Misajlovski: Mbi shfrytëzimin e objekteve që përkasin në prona shoqërore, në: *Zakunitost*, Zagreb, 1958, faqe 438 dhe në vazhdim. Shih gjithashtu M. Tondini, *Sistemi i Privatizimit në Kosovë, Ngritja në drejtim të një ardhmërie të pasigurt*, Prishtinë/Priština, dhjetor 2003. Disa nga ligjet relevante janë: Ligji i Kosovës mbi Tokën Ndërtimore, nenet 38 dhe 39 (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste të Kosovës 14/80); Ligji Federal mbi

Pas Luftës së Dytë Botërore, autoritetet Jugosllave konfiskuan pronën private të “armiqve” dhe “bashkëpunëtorëve”. Më vonë, qeveria nacionalizoi tokën bujqësore që tejkalonte madhësinë e lejuar me ligj për pronësinë private.<sup>4</sup> Gjithashtu, Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë e vitit 1953 i klasifikoi të gjitha burimet natyrore si pronë shtetërore.

Gjatë viteve të gjashtëdhjeta këshillat e punëtorëve zëvendësuan kontrollin shtetëror dhe prona shoqërore zëvendësoi pronën e nacionalizuar. Kjo arriti kulmin me Kushtetutën e Republikës Federative të Jugosllavisë të vitit 1974, e cila përcaktonte se të gjitha mjetet e prodhimit dhe mjetet tjera të punës kolektive, prodhimi i punës kolektive dhe burimet natyrore, si dhe asetet e tjera të përcaktuara për përdorim publik ishin prona shoqërore. Prona shoqërore u përcaktua si kategori ligjore në vete, e ndryshme nga prona private dhe shtetërore. Karakteristika kryesore e pronës shoqërore ishte se bartësit privat të pronave shoqërore nuk fitonin pronësinë, por në fakt të drejtën për shfrytëzim të një asemi të kualifikuar si pronë shoqërore. Ndërmarrjet ishin Ndërmarrje në Pronë Shoqërore (NSh-të)<sup>5</sup> dhe NSh-të shfrytëzonin asetet në pronësi shoqërore. Titullari suprem i pronës shoqërore ishte shoqëria.<sup>6</sup>

Konfiskimet, nacionalizimet dhe socializimet e kaluara e komplikojnë privatizimin aktual sepse ka paqartësi lidhur me këto prona. Ka mundësi që, disa njerëz kanë të drejtë në rikthim të pronës apo kompensimit material sepse më parë kanë qenë pronar të ndonjë prone që është eksproprijuar në mënyrë të paligjshme apo shndërruar në pronë shoqërore dhe tani i përket ndonjë NSh-je, të cilën AKM-ja e privatizon apo likuidon.<sup>7</sup> Megjithatë, deri më sot nuk ka asnjë ligj që rregullon rikthimin e pronës së

---

Kompanitë, nenet 75-79 (Gazeta Zyrtare e Republikës Federative të Jugosllavisë 77/78); Ligji Federal mbi Marrëveshjet e Detyrueshme, Falimentimin dhe Likuidimin, neni 135 (Gazeta Republikës Federative të Jugosllavisë 84/89).

<sup>4</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë 64/1945.

<sup>5</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18, neni 3, e përkufizon ndërmarrjen shoqërore si “(i) person juridik (përveç ndërmarrjes në pronësi publike), që në kohën e themelimit ka qenë paraparë në paragrafët 1 ose 2 të nenit 2 të Ligjit mbi Ndërmarrjet ose (ii) person juridik (a) që në kohën e themelimit ka qenë paraparë në paragrafin 3 të nenit 2 të Ligjit mbi ndërmarrjet dhe (b) ku shumica e pasurisë së tij është në pronësi shoqërore ose kur kapitali shumicë përfshin kapital shoqëror.” Neni 2 i Ligjit Jugosllav mbi Ndërmarrjet, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë thotë: “1. Ndërmarrjet në vijim janë pronësi shoqërore: ndërmarrjet shoqërore, ndërmarrjet publike, shoqëritë aksionare dhe kompanitë me përgjegjësi të kufizuar kur operojnë me pasuri në pronësi shoqërore. 2. Ndërmarrjet në vijim janë pronësi kooperative: ndërmarrjet kooperative, shoqëritë aksionare, partneritetet me përgjegjësi të kufizuara dhe kompanitë me përgjegjësi të përbashkët dhe të pakufizuar të disa anëtarëve të tyre, nëse pasuritë në pronësi kooperative janë investuar në ato. 3. Ndërmarrjet në vijim janë pronësi e përzier: shoqëritë aksionare, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, partneritetet e kufizuara, kompanitë me përgjegjësi të përbashkët dhe të pakufizuar të disa anëtarëve të tyre, kur pasuritë në forma të ndryshme të pronësisë janë investuar në ato – pronësi shoqërore, pronësi kooperative, pronësi e qytetarëve, pronësi e subjekteve civile ligjore dhe në pronësi të personave të huaj.

<sup>6</sup> Me sa duket ka tre subjekte që mund të konsiderohen si organe që përfaqësojnë shoqërinë: (1) Shteti (d.m.th., Federata Jugosllave, Republika e Serbisë ose Krahina e Kosovës), (2) komunat ose (3) këshillat e punëtorëve. Për më shumë informata shih Institutin Kosovar për Zhvillim dhe Hulumtim të Politikave, *Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore*, faqe 5-6.

<sup>7</sup> Çështja se a do të njihet pronësia e mëparshme varet nga disa faktorë, siç janë: sipas cilit ligj është marrë prona, a është marrë në pajtim me atë ligj dhe a siguronte ai ligj afat kohorë për ta kundërshtuar marrjen. Shih, p.sh., procesverbalin i Dhomës së Veçantë gjatë seancës shqyrtuese të 2 gushtit 2007, në rastin *Mehmet Shiroka dhe të tjerët kundër AKM-së*, SCC-07-0030.

eksproprijuar më herët siç është rasti në shtetet në tranzicion të Evropës Lindore. Mungesa e ligjit mbi rikthim ka rritur dukshëm vështirësitë, ndërlikimet dhe problemet në programin e privatizimit në Kosovë. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, për disa vjet me radhë ka bërë thirrje për Ligj mbi rikthim në Kosovë, në mënyrë që të kërkoj t'i adresoj disa prej këtyre vështirësive.

Mes viteve 1989-1999 Republika Federale e Jugosllavisë – e më pas Republika e Serbisë – vendosi “Masa të Përkohshme”<sup>8</sup> për t'i ndryshuar menaxhmentet, këshillat e punëtorëve dhe fuqinë punëtore të NSH-ve. Veç kësaj, një formë privatizimi ndodhi përmes transaksioneve të cilave u referohen si transformime.<sup>9</sup> Përmes transformimeve, disa persona (shpesh serb nga “Serbia aktuale” si dhe serb të Kosovës) kanë fituar të drejta të pronësisë private (sipas ligjit në fuqi në atë kohë në Kosovë) në NSH-të e Kosovës. Privatizimi nga Agjencia e Mirëbesimit, siç është e paraparë me Rregulloret e aplikueshme të UNMIK-ut, mund të rezultojë me eksproprijim të pronës të serbëve të Kosovës dhe shtetasve të huaj, të cilët ishin përfituesit e transformimeve të tilla të bëra nga autoritetet serbe.<sup>10</sup> Veç kësaj, edhe pse legjislacioni specifikon se kur duhet të njihen transformimet, (d.m.th. kur ato janë bazuar dhe ndërmarr në pajtueshmëri të plotë me ligjin e aplikueshëm dhe nuk kanë qenë as diskriminuese e as në shkelje të Konventës)<sup>11</sup> është e paqartë se në çfarë raste në të vërtetë plotësohet këto kushte.

## **B. Administrimi i Ndërmarrjeve Shoqërore**

Që nga viti 1999, UNMIK-u është fokusuar në çështjen e të drejtave pronësore në Kosovë, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me pronën shoqërore.<sup>12</sup> Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë<sup>13</sup> siguron që kompetenca të caktuara të mos përfshihen në ato të Institucioneve të Përkohshme të Kosovës, por të mbesin ekskluzivisht në duart e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Në mesin e këtyre kompetencave janë autoriteti për administrimin e pronës publike, shtetërore dhe shoqërore; rregullimi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, si dhe

---

<sup>8</sup> Ligji mbi Masat e Autoriteteve të Republikës në Rrethana të Jashtëzakonshme, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë Nr. 30/90, dhe Ligji mbi Marrëdhëniet e Punës në Rrethana të Jashtëzakonshme, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë Nr. 40/90.

<sup>9</sup> Ligji mbi kushtet dhe procedurën për transformimin e pronave shoqërore në forma tjera të pronës (i ndryshuar), Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë 48/91, 75/91 dhe 51/94.

<sup>10</sup> Shih, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave *Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore*, 2005, faqe 11.

<sup>11</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 5.3 (b).

<sup>12</sup> Rregullorja e UNMIK –ut Nr. 1999/1 e 25 korrikut 1999, “mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë” e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/54, në nenin 6 siguron:

6.1 “UNMIK-u do të administrojë me pasurinë e tundshme ose të patundshme në territorin e Kosovës [...] kur UNMIK-u ka baza të arsyeshme dhe objektive të përfundojë se prona e tillë është:

- i. pronë apo pronë e regjistruar në emër të Republikës Federale të Jugosllavisë apo të Republikës së Serbisë apo të cilido organ të tyre; ose
- ii. pronë shoqërore”.

6.2 “Administrimi nga UNMIK-u i pronës në pajtim me nenin e mësipërm 6.1 bëhet pa i cenuar të drejtat e asnjë personi apo entiteti për të mbrojtur pronësinë apo të drejtat e tjera në lidhje me pronën në gjykatat kompetente në Kosovë apo me mekanizmat gjyqësore të vendosura me anë të rregullores”.

Rregullorja e UNMIK-ut 1999.1 konsiderohet të ketë hyrë në fuqi që nga 10 qershori 1999, data e miratimit të Rezolutës 1244 (1999) nga Këshilli të Sigurimit të OKB-së; shih neni 7.

<sup>13</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, e datës 15 maj 2001.



definimi i juridiksionit dhe kompetencës për zgjidhjen e kontesteve ekonomike të pronës.<sup>14</sup>

UNMIK-u ka shpallur legjislacione dhe ka krijuar dy institucione - Agjencinë e Mirëbesimit dhe Dhomën e Veçantë - lidhur me administrimin dhe privatizimin e pronës publike, shtetërore dhe shoqërore.

### **III. KORNIZA LIGJORE MBI AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT**

Dokument themelor që krijon Agjencinë e Mirëbesimit dhe që përshkruan funksionet e saj është Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18.<sup>15</sup>

#### **A. Agjencia e Mirëbesimit administron Ndërmarrjet Shoqërore**

Agjencia e Mirëbesimit ka kompetenca për të administruar ndërmarrjet publike dhe NSh-të e regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988 dhe pronën shoqërore që gjendet në Kosovë që nga 22 marsi 1989.<sup>16</sup> Duke vepruar kështu, Agjencia e Mirëbesimit duhet të veprojë në interes të pronarëve të NSh-ve dhe zhvillimit të Kosovës si tërësi, si dhe për mirëqenien e banorëve të saj.<sup>17</sup>

Nën autoritetin që gëzon, Agjencia e Mirëbesimit ka kompetenca të gjëra menaxhuese.<sup>18</sup> Ajo mund gjithashtu të krijojë një apo më shumë filiale të NSh-ve,<sup>19</sup> në pronësi të atyre NSh-ve por të administruara nga Agjencia e Mirëbesimit, si dhe të transferojë një pjesë apo tërë pasuritë dhe detyrimet e zgjedhura (zakonisht ato aktuale) të atyre NSh-ve në të tilla filiale.<sup>20</sup> Veç kësaj, Agjencia e Mirëbesimit mund

---

<sup>14</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr 2001/9, Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë të datës 15 maj 2001, neni 8.1(q), (r) dhe (u).

<sup>15</sup> Agjencia e Mirëbesimit ishte krijuar përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/15 “mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, e cila ishte ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18. Sipas njohurisë së OSBE-së, një ligj i ri që rregullon Agjencinë e Mirëbesimit, që do të zëvendësonte Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/12 ( e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18) është përpiluar dhe i është dorëzuar për shqyrtim Asamblesë së Kosovës.

<sup>16</sup> Veç kësaj, Agjencia e Mirëbesimit administron ndërmarrjet shoqërore dhe me interesat e pakicave në NSh-të të regjistruara në Kosovë që nga 31 dhjetori 1988. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 5.1.

<sup>17</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 2.2 siguron: “... Agjencia (a) Administron ndërmarrjet si administrues i besuar i pronarëve të tyre...dhe (c) “Kryen detyra të tjera për të ruajtur apo për të rritur vlerën ose shanset për sukses të aktiviteteve në fjalë dhe ndërmerr hapa ose masa të tjera të tilla ... të cilat inkurajojnë rindërtimin ekonomik dhe zhvillimin në Kosovë dhe mirëqenien e banorëve të saj apo atyre të cilitdo rajoni të caktuar”. Sipas raportit të auditimit të Zyrës së Auditorit Gjeneral (dhjetor 2006, faqe 6), kjo gjuhë (e jetësuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18) ka mundësuar Agjencisë së Mirëbesimit të përfshijë në kushtet e privatizimit garancitë nga një investitor që do të punësojë anëtarë të grupeve etnike nga komuniteti lokal.

<sup>18</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18, neni 6.1.

<sup>19</sup> Nëse NSh-ja ka gamë të gjerë të bizneseve që nuk ngjasojnë, Agjencia e Mirëbesimit mund të krijojë disa filiale.

<sup>20</sup> Sipas nenit 6.1(p) dhe (q) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, Agjencia e Mirëbesimit mund gjithashtu të transformojë Ndërmarrjet Publike (d.m.th. pronë e shtetit) në Korporata apo të ristrukturojë një Ndërmarrje Publike në disa ndërmarrje apo korporata dhe t'i transferojë të gjitha pasuritë e ndërmarrjeve të tilla në korporata të tilla.

të shes një pjesë apo të gjitha aksionet në të tilla filiale në emër të NSh-së<sup>21</sup> dhe të administrojë me të ardhurat apo aksionet që rezultojnë nga shitje të tilla.<sup>22</sup> Agjencia e Mirëbesimit i mbanë këto të ardhura në mirëbesim për të mirë të kreditorëve dhe pronarëve të NSh-ve.<sup>23</sup>

Zakonisht, shumica e detyrimeve dhe punonjësve mbesin me NSh-të ashtu që, pas shitjes së filialit(eve) pronari(ët) i/e ri nuk janë përgjegjës për ato, dhe Agjencia e Mirëbesimit do t'i likuidojë NSh-të e tilla.<sup>24</sup> Nëse Agjencia e Mirëbesimit beson që pasuritë e një NSh-je nuk formojnë një biznes të vlefshme, ajo nuk do të krijojë filiale por thjesht do të likuidojë NSh-në.<sup>25</sup>

Për informata faktike lidhur me Agjencinë e Mirëbesimit dhe NSh-të, shih Shtojcën I.

## **B. Shitja e Filialeve të Ndërmarrjeve Shoqërore**

Procedurat që udhëheqin shitjen e aksioneve në një filiale ku është transferuar një pjesë e NSh-ve, nuk përshkruhet në Rregullore por në “Rregullat e Tenderimit për privatizime me spin-off” të Agjencisë së Mirëbesimit.<sup>26</sup> Forma aktuale standarde e këtyre rregullave siguron që aksionet në filiale do të shiten në ankand publik bazuar në një “memorandum për informim”, i cili përshkruan pasuritë dhe detyrimet e filialeve.<sup>27</sup> Është përgjegjësi e tenderuesve të bëjnë hetim “vigjilent” të filialit dhe pasurive të tij.<sup>28</sup> Pozicionimi i tenderëve dhe përzgjedhja e tenderëve është si vijon: tenderuesi me ofertë më të lartë mund të blejë filialin në çmimin e tij tenderues. Megjithatë, nëse tenderuesi me ofertë më të lartë nuk vazhdon procedurën, tenderuesi me ofertë më të lartë pas tij mund të blejë filialin në çmimin më të lartë të ofruar. Nëse tenderuesi me ofertë të dytë më të lartë gjithashtu nuk vazhdon procedurën, ofertuesi me ofertën e tretë më të lartë mund të blejë filialin me çmimin më të lartë të ofruar.<sup>29</sup> Tenderuesit nuk mund t'i ndryshojnë ofertat e tyre dhe bisedimet sa i përket marrëveshjes për blerje të aksioneve mbahen në minimum.<sup>30</sup> Megjithatë, sipas

---

<sup>21</sup> Agjencia e Mirëbesimit mund të mos veprojë kështu në rastin e ndërmarrjeve publike. (Shih Rregullorja 2005/18, nenet 6.2 dhe 8.4.)

<sup>22</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 6.1(o), 6.2 dhe 8.

<sup>23</sup> Rregullorja UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 8.6.

<sup>24</sup> Shih [http://www.kta-kosovo.org/\(NSH-të\)](http://www.kta-kosovo.org/(NSH-të)): shih gjithashtu Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 9.

<sup>25</sup> Shih Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, nenet 6.2 (c) dhe 9.

<sup>26</sup> Për tekstin e Rregullave të Tenderit, shih [www.kta-kosovo.org](http://www.kta-kosovo.org).

<sup>27</sup> Raporti i auditimit i Zyrës së Auditorit Gjeneral, faqe. 11.

<sup>28</sup> Rregullat e Tenderit, neni 4.

<sup>29</sup> Rregullat e Tenderit, neni 11. Në praktikë, bëhet dallim në mes spin-off-eve të rregullta dhe atyre speciale. Spin-off-et speciale bëhen në raste të NSh-ve të mëdha, strategjike e të rëndësishme me numër të madh punonjësish. Sipas raportit të auditimit të Zyrës së Auditorit Gjeneral, të dhjetorit 2007, faqet 9-10 dhe f. 12-13, Agjencia e Mirëbesimit ka një politikë të shqyrtimit të çdo kompanie që ka së paku 150 punonjës dhe me mundësi qarkullim prej 10 milion € si kompani e një rëndësie strategjike për Kosovën dhe prandaj e denjë për trajtim me spin-off special. Në rast të spin-off-eve të rregullta, zakonisht zhvillohet një raund i ofertimit gjatë tenderit dhe oferta fituese zgjidhet vetëm në bazë të çmimit më të lartë të ofertuar. Në raste të spin-off-eve speciale, zhvillohen dy raunde të ofertimit dhe mund të aplikohen tri kritere standarde: (i) çmimi i ofertës (50% e çmimit totalit të ofertës(ii) garancitë për punësim (25% të çmimit të ofertës) dhe (iii) garancitë për investime (25% të çmimit të ofertës). Kritere tjera mund të aplikohen në raste individuale.

<sup>30</sup> Rregullat e Tenderit, nenet 12 dhe 13.

Rregullave të Tenderimit, Bordi i Agjencisë së Mirëbesimit mund të shtyj apo anulojë tenderin në çfarëdo kohe dhe për çfarëdo arsye sipas zgjedhjes së saj.<sup>31</sup>

Që nga themelimi i saj, Dhoma e Veçantë ka ndryshuar pikëpamjen e saj për natyrën e Agjencisë të Mirëbesimit dhe autoritetin e tij për të anuluar tenderë. Fillimisht, Dhoma i lejonte Agjencisë të Mirëbesimit zgjedhje të gjerë për të anuluar tenderë. Pastaj, ajo ia kufizojë këtë zgjedhje dhe theksoi që Agjencia e Mirëbesimit duhet të veprojë në mënyrë të drejtë. Kohëve të fundit, Dhoma e ka klasifikuar Agjencinë e Mirëbesimit si një organ administrativ dhe anulimin e një tenderi si një vendim administrativ që duhet t'i përmbush kërkesat e Ligjit mbi Procedurën Administrative.<sup>32</sup>

### C. Pronësia

Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, Agjencia e Mirëbesimit nuk duhet të përcaktojë statusin e pronësisë së pasurive të NSh-ve para privatizimit. Në vend të kësaj, ajo është e obliguar ta qartësojë këtë çështje pasi të jenë shitur pasuritë, natyrisht duke përfshirë këtu pasi që fillimisht të ketë vendosur se entiteti bie brenda autoritetit të vet, bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18.<sup>33</sup> Si rrjedhim, skema legjislative i lejon Agjencisë së Mirëbesimit të drejtojë pasuritë që janë në pronësi të palëve të treta. Kjo diskutohet në kapitullin V.

<sup>31</sup> Rregullat e Tenderit, neni 15.1.

<sup>32</sup> Ligji i Kuvendit të Kosovës Nr. 02/L-28 mbi Procedurën Administrative, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/33 më 13 maj 2006 dhe ka hyrë në fuqi më 13 nëntor 2006.

Rastet në vijim tregojnë këtë evolucion të interpretimit ligjor:

- Në aktgjykimin e datës 10 gusht 2004 (*Osman Mecinaj dhe të tjerët kundër AKM-së*, SCC-03-0002) Dhoma e Veçantë vërejtë pa koment që Rregullat e Tenderit ia lënë AKM-së në zgjedhje mundësinë për ta anuluar apo vazhduar tenderin, nëse përmbushen kërkesat e pjesës relevante të Rregullave.
- Në aktgjykimin e datës 10 tetor 2006 (*“Grand Group Partnership”, Sh.a. kundër AKM-së*, SCC-06-0176), Dhoma e Veçantë doli me qëndrim se Agjencia e Mirëbesimit duhet të veprojë sipas parimeve normale të ligjit, që përfshinë edhe obligimin për t'i respektuar Rregullat e saj të Tenderit dhe t'i trajtojë palët në mënyrë të barabartë. Procesi i tenderit nuk krijon marrëdhënie kontraktuale, por më saktë një obligim për tenderuesin që të veprojë në mënyrë të drejtë. Rregullat e Tenderit i obligojnë ofertuesit, por gjithashtu e obligojnë Agjencinë e Mirëbesimit me një kërkesë që t'i zbatojë ato në mënyrë të barabartë për të gjithë ofertuesit.
- Në aktgjykimin e datës 16 maj 2007 (*Kompania private Doni kundër AKM-së*, SCC-06-0436), Dhoma citoi disa nene të Ligjit mbi Procedurën Administrative (1986) dhe theksoi se ky ligj është i zbatueshëm për Agjencinë e Mirëbesimit sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24: “Dhoma nuk ka dyshim se Agjencia e Mirëbesimit bie nën përkufizimin e një organi administrativ... Agjencia e Mirëbesimit mori vendim për diskualifikim të kërkuarit nga tenderi-oferta pa ndonjë verifikim paraprak. Ky veprim është në kundërshtim me dispozitat e nenit 135(1) të [Ligjit mbi Procedurën Administrative]”.

Sa i përket zgjedhjes së pohuar që gëzon Agjencia e Mirëbesimit për të mos marrë parasysh ndonjë tender:

“Dhoma vëren që koncepti i zgjedhjes absolute të autoriteteve administrative ka pësuar shkelje të ndryshme në ligj gjatë viteve të kaluara në interes të ligjshmërisë, interesit të publikut dhe transparencës, si dhe në bazë të të drejtave themelore të njeriut. Agjencia e Mirëbesimit nuk mund t'i shpërfillojë të gjitha rregullat.... Në të vërtetë çdo vendim administrativ duhet të jetë i drejtë dhe i arsyeshëm, si dhe i bazuar në argumentim të saktë. Zgjedhja absolute administrative tani është një mit dhe autoriteti administrativ duhet të dëshmojë se vendimet e tij merren duke u bazuar në arsyen ligjore.”

Si rrjedhim, në vendimin e saj të majit 2007, Dhoma e klasifikojë Agjencinë e Mirëbesimit si organ administrativ.

<sup>33</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 5.3.

#### **D. Riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore përmes Procedurave të Moratoriumit**

Nëse një NSh nuk mund t'i përmbush obligimet për më shumë se gjashtë muaj, apo nëse detyrimet e tejkalojnë pasurinë e saj dhe nëse Agjencia e Mirëbesimit mendon se NSh-ja mund të vazhdojë biznesin e saj si rezultat i riorganizimit, Agjencia e Mirëbesimit mund të aplikojë riorganizim e NSh-së. Dhoma e Veçantë do të urdhërojë procedura për riorganizim nëse plotësohen disa kushte ("Vendimi për Moratorium").<sup>34</sup>

Qëllimi i riorganizimit është të mbrohet NSh-ja dhe pasuria e saj nga kreditorët. Gjatë moratoriumit, të gjitha veprimet për të plotësuar çfarëdo kërkesë kundër NSh-së apo pasurisë së saj suspendohen dhe vazhdojnë vetëm me leje të Dhomës së Veçantë.<sup>35</sup>

Dhoma e Veçantë emëron një apo më shumë administratorë të NSh-së.<sup>36</sup> Administratori do të jetë i pavarur.<sup>37</sup> Ai ose ajo ka pushtet të gjerë. Megjithatë, miratimi i Agjencisë të Mirëbesimit dhe/ose Dhomës së Veçantë kërkohet për disa veprime.<sup>38</sup>

Takimi i kreditorëve do të diskutojë dhe votojë mbi një apo disa plane të propozuara të riorganizimit të NSh-ve.<sup>39</sup> Administratori parashtron planet e votuara pranë Dhomës së Veçantë, e cila cakton seancën shqyrtuese dhe vendos mbi planet.<sup>40</sup>

Miratimi i një plani nga Dhoma e Veçantë nënkupton që të gjitha paditë kundër NSh-së dhe obligimet e NSh-së riformulohen dhe qeverisen nga kushtet e planit të konfirmuar të riorganizimit. Megjithatë, administratori mund të hedh poshtë ndonjë padi apo të bëjë vlerësimin përfundimtar të padive.<sup>41</sup>

Pas dëshmime të mëtejshme të kërkesave.<sup>42</sup> administratori parashtron një listë përfundimtare të të gjitha padive, të klasifikuara në grupe sipas prioritetit, pranë Dhomës së Veçantë. Kërkesat trajtohen sipas prioritetit që ka grupi.<sup>43</sup>

Dhoma e Veçantë mund të urdhërojë mbylljen e procedurave të riorganizimit dhe të planit të konfirmuar ri-organizues.<sup>44</sup> Pas kësaj, të gjitha borxhet e NSh-së që burojnë para datës së vendimit të moratoriumit shuhen automatikisht sipas ligjit dhe çfarëdo veprimi për t'i mbledhur ato borxhe të shuara do të ndalohet, përveç nëse ndryshe nuk urdhëron Dhoma e Veçantë. Veç kësaj, NSh-ja konsiderohet si e rimëkëmbur

<sup>34</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, nenet 3 dhe 4.

<sup>35</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 5.1.

<sup>36</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 8.

<sup>37</sup> Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 10, "[A]dministratori do të jetë i pavarur nga Agjencia, Ndërmarrja, kreditorët dhe IPVQ-të[...]"

<sup>38</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, nenet 10 - 15.

<sup>39</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 24.3 dhe 25.

<sup>40</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 27.1 dhe 27.3.

<sup>41</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 28.

<sup>42</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, nenet 30 dhe 31.

<sup>43</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 37.

<sup>44</sup> Kjo mund të bëhet pas marrjes së raportit përfundimtar dhe formularit për aplikacion nga administratori duke kërkuar mbyllje të riorganizimit. Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48, nenet 39 - 41.

financiarisht dhe mund t'i vazhdojë aktivitetet afariste pa kufizime apo mbikëqyrje të mëtejshme.<sup>45</sup>

Deri më këtë datë, sipas parashtresës nga ana e Agjencisë së Mirëbesimit, Dhoma e Veçantë është pajtuar me fillimin e riorganizimit të vetëm një kompanie: Trepça (dhe NSh-të e ndërlidhura me të).<sup>46</sup> Megjithatë, ende nuk është emëruar një administrator.

### **E. Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore**

Nëse Agjencia e Mirëbesimit beson që asetet (e mbetura) e një NSh-je nuk mund të rikthehet në një biznes realizues, ajo inicion likuidimin vullnetar të NSh-së apo çfarëdo pjese të saj.<sup>47</sup>

#### 1) Pezullimi i mundshëm i padive dhe anulimi i transaksioneve

Për dallim nga moratoriumi (i cili urdhërohet nga Dhoma e Veçantë), likuidimi (i cili inicohet nga Agjencia e Mirëbesimit) nuk suspendon me ligj paditë e kreditorëve kundër NSh-së apo kreditorëve të saj. Deri pak kohë më parë, për të suspenduar paditë kundër një NSh-je, Agjencisë së Mirëbesimit i është duhur që të parashtrojë një kërkesë në gjykatën ku kishte filluar veprimi ligjor ndaj një NSh-je.<sup>48</sup> Një ndryshim ligjor i bërë rishtas e ka lehtësuar pezullimin e kërkesave kundër NSh-ve në likuidim. Tani, një njoftim nga Komisioni i Likuidimit përkatës i dërguar në Dhomën e Veçantë se një NSh të caktuar është në likuidim ka efektin e moratoriumit<sup>49</sup> dhe suspendon të gjitha veprimet për t'iu përgjigjur kërkesave kundër NSh-së në të gjitha gjykatat e Kosovës. Sipas të njëjtit ndryshim, kreditorët të cilët nuk parashtrojnë dëshmi mbi kërkesat e tyre pranë Komisionit të Likuidimit brenda dy muajve pas marrjes së njoftimit për likuidim nuk do të përfitojnë nga shpërndarja prej likuidimit.<sup>50</sup>

<sup>45</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2005/48, neni 42.

<sup>46</sup> Më 2 qershor 2005, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm lëshoi Udhëzimin Administrativ 2005/7 për ndalimin e të gjitha veprimeve zbatuese kundër pasurive të Ndërmarrjeve të cilat janë pjesë e Trepçës, bazuar në aktgjykimet e Dhomës së Veçantë apo gjykatave tjera, për një periudhë tre mujore. Kjo ndalesë është vazhduar. Më 9 mars 2006, Dhoma e Veçantë lëshoi një vendim për moratorium, i cili thekson, mes tjerash, "Që nga data e këtij vendimi për moratorium, të gjitha veprimet, procedurat apo veprimet e çfarëdo lloji që synojnë zbatimin apo plotësimin e padive kundër Trepçës nën administrimin e AKM-së siç përcaktohet më lartë, apo pasurive të saj suspendohen dhe do të vazhdojnë vetëm me lejen e kësaj gjykate në pajtim me nenin 5.2 të rregullores së UNMIK-ut 2005/48."

<sup>47</sup> Agjencia e Mirëbesimit mund të veprojë në këtë mënyrë nëse beson se likuidimi është në interes të kreditorëve dhe/ose pronarëve të NSh-ve të tilla, shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 9.1. Agjencia e Mirëbesimit kryen likuidimin në pajtim me Rregulloren mbi Shoqëritë Tregtare (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 9.1 i referohet Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/6), dhe Rregullorja mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve (Rregullorja E UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 43.4). Veç kësaj, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 43.1 siguron procedurat e likuidimit të urdhëruara nga Dhoma e Veçantë në raste të caktuara që lidhen me procedurat e riorganizimit. Në procedura të tilla të likuidimit të urdhëruara nga gjykata funksionet e administratorit ushtrohen nga një komision Likuidimi, të emëruar nga Bordi i Agjencisë së Mirëbesimit dhe që i përgjigjet vetëm atij. Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48, neni 43.3 dhe Urdhëresën Administrative 2007/1, nenet 3 dhe 4. Me aq sa është e njoftuar OSBE-ja, nuk ka pasur asnjë likuidim të urdhëruar nga gjykatat.

<sup>48</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18, neni 9.3 përshkruan dokumentet, të cilat duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit.

<sup>49</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 13.1.

<sup>50</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 14, i referohet Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 43.1(d)(ii). Kjo referencë me gjasë duhet të jetë te neni 43.3(d)(ii) i cili parasheh që kreditorët të cilët nuk dorëzojnë kërkesat e tyre brenda dy muajve nga njoftimi i dytë për likuidim nuk do të përfitojnë nga shpërndarja e hiseve nga procedura e likuidimit

Megjithatë, nëse kreditori ofron arsyetim të mjaftueshëm për parashtrësë të vonuar, nga Komisioni i Likuidimit kërkohet që të pranojë padinë e parashtruar pas skadimit të afatit kohor.<sup>51</sup>

Gjatë likuidimit të një NSh-je, Agjencia e Mirëbesimit mund të kërkojë që Dhoma e Veçantë të anulojë çfarëdo transaksioni të NSh-së, nëse transaksioni është bërë më parë së 90 ditë para datës së publikimit të dytë të njoftimit për likuidim.<sup>52</sup>

## 2) Komisionet e Likuidimit

Në çfarëdo likuidimi, Agjencia e Mirëbesimit emëron Komisionin e Likuidimit.<sup>53</sup> Komisionet e Likuidimit i përgjigjen vetëm Bordit të Agjencisë së Mirëbesimit dhe nuk i japin llogari asnjë pale të tretë.<sup>54</sup> Asnjë nga Komisionet e Likuidimit, Agjencia e Mirëbesimit dhe punonjësit e saj nuk mbahen përgjegjës për humbjet që i shkaktohen ndonjë kreditori, NSh-je, çfarëdo punonjësi apo çfarëdo pale tjetër për pasojat e vendimeve të tyre me kusht që Komisioni i Likuidimit ka vepruar me kujdes të arsyeshëm.<sup>55</sup>

Komisionet e Likuidimit kanë të gjitha fuqitë e menaxhimit dhe organet e kontrollit të NSh-ve,<sup>56</sup> përfshirë fuqinë për të dhënë udhëzime tek menaxhmenti i NSh-ve, për të marrë posedimin mbi apo për të mbledhur prona, të shes apo japë me qira pasuritë dhe të punësojë apo pushojë nga puna punonjës të NSh-ve.<sup>57</sup> Megjithatë, Komisioni i Likuidimit duhet të marrë pëlqim paraprak të Agjencisë së Mirëbesimit apo të Dhomës së Veçantë për kategori të caktuara të veprimeve.<sup>58</sup>

Të gjithë kreditorët potencial duhet t'i parashtrojnë kërkesat e tyre dhe informacionet e kreditorit pranë Komisionit të Likuidimit.<sup>59</sup> Komisioni i Likuidimit i trajton regjistrimet apo dorëzimin e kërkesave pranë Agjencisë të Mirëbesimit si pezullim të vazhdimit të periudhës kufizuese nga data kur kërkesa është regjistruar apo dorëzuar pranë Agjencisë së Mirëbesimit.<sup>60</sup>

Komisioni i Likuidimit mund të thërras mbledhje të kreditorëve dhe të emërojë një komision të kreditorëve për të asistuar Komisionin e likuidimit. Pavarësisht nga mocionet e aprovuara gjatë takimit të kreditorëve, Komisioni i Likuidimit nuk është i detyruar të ndër marr ndonjë veprim specifik.<sup>61</sup>

---

<sup>51</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 14.2. Kjo dispozitë (duke krijuar obligim) me gjasë anashkalon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/48, nenin 43.1 në bazë të së cilit Komisioni i Likuidimit “mund sipas diskrecionit të vet” të pranojë një padi të parashtruar pas dy muajve, edhe në qoftë se kreditori ofron arsyetim të mjaftueshëm për parashtrësë të vonuar.

<sup>52</sup> Rregullorja 2005/18, neni 9.4.

<sup>53</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 9.2 dhe Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 3.

<sup>54</sup> Urdhëresa Administrative 2007/1, neni 4

<sup>55</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 10.3 dhe 10.4, referuar nga nenet 43.3 dhe 43.4.

<sup>56</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, nenet 9.1 dhe 9.2.

<sup>57</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 11.

<sup>58</sup> Shih, p.sh., Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 15 (referuar nga nenet 43.3 dhe 43.4), Urdhëresa Administrative nr 2007/1, neni 11, dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 13.2 (referuar nga Urdhëresa Administrative 2007/1, neni 13.4).

<sup>59</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 13.2.

<sup>60</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 7.

<sup>61</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 6.

Komisioni i Likuidimit njofton çdo kreditor të prekur, me shkrim nëse ai refuzon ndonjë padi, duke dhënë sqarim me arsyetimin për refuzim apo ulje të padisë. Kreditori i prekur mund të aplikojë pranë Agjencisë së Mirëbesimit për shqyrtim të vendimit.<sup>62</sup>

3) Shqyrtimi i vendimeve të Komisioneve të Likuidimit nga Komisioni Shqyrtues dhe Dhoma e Veçantë

Pas ndryshimit në vitin 2007, Agjencia e Mirëbesimit ka themeluar një Komision të brendshëm të Shqyrtimit, të pavarur nga Komisioni i Likuidimit për t'i shqyrtuar vendimet dhe veprimet e Komisioneve të Likuidimit që sfidohen nga ndonjë palë e pakënaqur. Vendimet e Agjencisë së Mirëbesimit bazohen në rekomandimet e Komisionit të Shqyrtimit dhe i nënshtrohen shqyrtimit nga Dhoma e Veçantë.<sup>63</sup>

Komisioni i Likuidimit, para pagesës, dorëzon listën përfundimtare të kërkesave për aprovim pranë Bordit të Agjencisë së Mirëbesimit.<sup>64</sup> Kërkesat e kreditorëve do të trajtohen sipas klasifikimit të tyre dhe në mënyrën e specifikuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/48.<sup>65</sup>

Pas përfundimit të procedurave të likuidimit dhe me aplikimin e Komisionit të Likuidimit, Dhoma e Veçantë mbyll likuidimin nëse është e bindur se të gjitha asetet e NSh-së janë likuiduar dhe të gjitha fondet e mbledhura janë paguar në masë të madhe.<sup>66</sup> Pastaj, NSh-ja konsiderohet ligjërisht e shpërbërë dhe jo-ekzistuese dhe nuk mund të imponohen më kërkesa të mëtejshme të kreditorëve apo të pronësisë kundër Agjencisë së Mirëbesimit apo pasurive të ish NSh-së.

Agjencia e Mirëbesimit nuk ka finalizuar asnjë nga likuidimet që ka filluar.

## **F. Transformimi i së Drejtës për Shfrytëzim të Pronës në Qira**

Legjislacioni i UNMIK-ut<sup>67</sup> parasheh se çfarëdo e drejte për shfrytëzim të pronës (d.m.th tokë apo banesa të klasifikuara si “pronë shoqërore e patundshme”) të regjistruara në emër të një NSh-jë që është transferuar në një filiale të NSh-së, si pjesë e riorganizimit apo që është përfshirë në likuidim të NSh-së, do të transformohet në qira gjatë transferimit apo likuidimit. Qiraja e tillë statusore do të përfshijë të drejtën në posedim, përdorim, transferim dhe vendosjes së hipotekës mbi pronë të palët e treta (gjithmonë duke iu nënshtuar qirasë).<sup>68</sup>

<sup>62</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 8.

<sup>63</sup> Urdhëresa Administrative nr 2007/1, neni 9.

<sup>64</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 07/1, neni 12 dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 35

<sup>65</sup> Pas disa padive prioritare (përfshirë këtu shpenzimet e Dhomës së Veçantë, Komisionit të Likuidimit dhe për veprimtarinë e biznesit pas fillimit të likuidimit) ndiq (i) të drejtat e punonjësve në 20 % të ardhurave (shih më poshtë); (ii) paditët e siguruara të realizuara nga pasuritë; (iii) padive për pronësi të pasurive specifike përfshi edhe pasurinë e patundshme; (iv) bëjnë kërkesa deri në fillimi të likuidimit; (v) kërkesat e pasiguruara dhe (vi) kërkesat e pronarëve të NSh-ve; Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 44.

<sup>66</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 17 dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 45.

<sup>67</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr 2003/13, nenet 2 – 9, e ndryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/45, neni 2 dhe e zbatuar nga Urdhëresa Administrative Nr. 2005/12, nenet 2 dhe 3.

<sup>68</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, neni 2.1, e ndryshuar nga Rregullorja 2004/45, neni 1.

Qiraja 99 vjeçare është krijuar në privatizime dhe likuidime.<sup>69</sup> Transferet dhe vënia e çfarëdo barre duhet të bëhen në të shkruar dhe duhet, sikur transformimi i një të drejtë në qira, të regjistrohen.<sup>70</sup> Qiraja nuk do të ndikohet nga çfarëdo ndryshimi në pronësinë themelore të pronës dhe mund të eksproprijohet vetëm sipas procedurave dhe kushteve të njëjta të caktuara për eksproprijim të pronësisë të pronës së patundshme.<sup>71</sup>

## **G. Të Drejtat e Punonjësve Legjitim të Ndërmarrjeve Shoqërore**

### **1) Punonjësit që kanë të drejtë në 20% nga të ardhurat**

Privatizimi dhe likuidimi ndikon në statusin special të punonjësve përkatës të NSh-ve. Për këtë arsye, punonjësit e NSh-ve që janë privatizuar kanë të drejtë, si prioritet, në 20% nga të ardhurat e shitjes së aksioneve të ndonjë filiale të NSh-së që është privatizuar dhe të pasurive tokësore që i nënshtrohen likuidimit vullnetar.<sup>72</sup>

Agjencia e Mirëbesimit do ta deponojë shumën e rezervuar në llogarinë e veçantë të kursimit<sup>73</sup> për shpërndarje nga ana e Federatës së Sindikatave të Pavarura në të punëtorët me këtë të drejtë.<sup>74</sup>

### **2) Lista e punonjësve legjitim (“lista e punonjësve”) dhe shqyrtimi**

Punonjësit mund të marrin pjesë në vetëm 20% aksione nëse ata janë të regjistruar si punëtorë të NSh në kohën e privatizimit,<sup>75</sup> ose në kohën e inicimit të likuidimit<sup>76</sup> dhe që kanë qenë në listën e rrogave të NSh-së për jo më pak se tre vite (në çfarëdo kohe). Për të përcaktuar se kush ka të drejtë në këto beneficione, organi përfaqësues i punonjësve në NSh, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, do të krijojnë në baza jo diskriminuese dhe do ta parashtrojnë në Agjencinë e Mirëbesimit një listë të punonjësve legjitim (“listën e punonjësve”).

<sup>69</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, nenet 1 dhe 3. 1.

<sup>70</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, nenet 3.2 dhe 6.

<sup>71</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, nenet 8 dhe 9.

Agjencia e Mirëbesimit ka krijuar një praktikë sipas së cilës i siguron blerësit në privatizim apo likuidim dokumentet me të cilat blerësi mund të regjistrojë qiranë në kadastrë.

<sup>72</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, neni 10, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/45, neni 10 dhe e zbatuar nga Urdhërsa Administrative 2005/12, neni 4.

<sup>73</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, Neni 10.5 dhe Urdhërsa Administrative Nr. 2007/1, Neni 15.

<sup>74</sup> Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, Neni 10.5, 75% 75 për qind e shumës do t'i shpërndahet në sasi të njëjta secilit punëtor që e ka këtë të drejtë në NSh.

<sup>75</sup> Sipas Urdhëresës Administrative Nr. 2005/12, Neni 4.2, Nëse Agjencia heq dorë nga pasuria e ndërmarrjes shoqërore përmes shitjes së aksioneve të korporatave vartëse të ndërmarrjeve shoqërore në procesin e privatizimit, duhet të lëshojë një listë të punonjësve me të drejtë. Kërkesat e së drejtave duhet të përcaktohen në baza të privatizimit të mëparshëm dhe inicimi i likuidimit të ndërmarrjes së tillë shoqërore. Sipas Urdhëresës Administrative Nr. 2005/12, Neni 4.3, koha e privatizimit të një ndërmarrjeve shoqërore është data dhe koha e realizimit të një marrëveshjeje për shitje të aksioneve të një filiale të NSh-së.

<sup>76</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13 neni 10.4 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/45, nenin 1.B dhe Urdhëresën Administrative Nr. 2005/12 nenin 4.4.



Në të kaluarën, Agjencia e Mirëbesimit nuk i ka shqyrtuar këto lista dhe punonjësit kanë mundur të parashtrijnë ankesa drejtpërdrejt në Dhomën e Veçantë.<sup>77</sup> Shqyrtimi i këtyre ankesave ia kishte kërkuar shumicën e kohës së Dhomës së Veçantë. Që nga ndryshimi i rregullave në vitin 2006,<sup>78</sup> Agjencia e Mirëbesimit së pari duhet të publikojë një listë me emrat e punonjësve legjitim dhe në afat prej 20 ditëve çdo person mund të parashtrijë padi ose të sfidojë listën. Agjencia e Mirëbesimit do të kërkojë paraqitjen e dëshmimeve dhe mund të mbajë seancën dëgjimore për dëshmi. Më pas, Agjencia duhet të rregullojë listën dhe ta publikojë atë. Vetëm atëherë punonjësit mund të parashtrijnë ankesën në Dhomën e Veçantë, me Agjencinë e Mirëbesimit si palë e paditur.<sup>79</sup>

### 3) Dëshmia e diskriminimit

Punonjësit të cilët pohojnë se ata do të jenë të regjistruar në kohën e privatizimit ose likuidimit të NSh-së dhe që kanë qenë të punësuar për jo më pak se tre vite dhe kanë qenë të diskriminuar, mund të parashtrijnë padi pranë Dhomës së Veçantë.<sup>80</sup>

### 4) Radhitja e ankesave të punonjësve në likuidim

20%-shi nga likuidimit, ose shitja e aksioneve janë sipas zbatimit të ligjit, në mënyrë automatike të alokuara për përfitim të “punonjësve që kjo u takon”.<sup>81</sup> Këto të drejta radhiten lartë: nën shpenzime të veçanta administrative dhe të gjykatës, por përmbi ankesave të siguruar të pronarit(ëve) të mjeteve që janë të përfshira.<sup>82</sup>

## H. Siguria e Kërkesave lidhur me Ndërmarrje Shoqërore

Shumë masa kanë për qëllim që të sigurojnë që procedurat e shitjes së aksioneve të një korporate vartëse në NSh që rriten për kreditorët ose pronarët e të njëjtës NSh dhe jo për palët tjera. Agjencia e Mirëbesimit duhet të mbajë të ardhurat e fituara nga shitja e aksioneve në dobi të kreditorëve dhe pronarëve të ndërmarrjes përkatëse.<sup>83</sup> Agjencia e Mirëbesimit gjithashtu duhet të mbajë xhirollogaritë dhe asetet tjera të administruara nga ajo në trust, ndarazi nga njëra tjetra dhe nga xhirollogaritë dhe

---

<sup>77</sup> Shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/13, Neni 10 Në një rast sipas kësaj rregulloreje para se të ndryshohet (*Termosistemi kundër AKM-së*, SCEL 04-0001), Agjencia e Mirëbesimit e kishte njoftuar Dhomën e Veçantë që nuk i ka shqyrtuar ankesat. Para se të merr një rol aktiv në proces, Agjencia e Mirëbesimit kishte pritur vendimin e Dhomës së Veçantë sa i përket ushtrimit të kompetencave të saja në përpilimin e listës së punonjësve legjitim. Dhoma e Veçantë e kishte konsideruar këtë parashtrësë si “jashtëzakonisht të pa pranueshme”.

<sup>78</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, Neni 64.

<sup>79</sup> Sipas pikëpamjeve të Dhomës së Veçantë, ankesat për legjitimitet për 20% të shitjes së aksioneve të NSh-së nuk mund të kombinohen me ankesat për kompensim për të ardhurat vetanake për vitet që punonjësit nuk kanë punuar për shkak të diskriminimit. Ankesat e tilla duhet të parashtrihen si të veçanta në Dhomën e Veçantë. Vendimi i 16 majit 2007 (*Bexhet Shabani et al. kundër AKM-së*, SCEL-06-001).

<sup>80</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr 2003/13, Neni 10.4 e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr 2004/45 neni 1. B dhe 10.6. Për komente, shih Kreun IV të këtij raporti.

<sup>81</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13, neni 10.1.

<sup>82</sup> Sidoqoftë, ankesat për të ardhura që kanë mbetur pa u paguar deri në kohën e vendimit të Dhomës së Veçantë ose e Agjencisë së Mirëbesimit për të filluar procedurat e likuidimit (të kufizuara në tre muaj të të ardhurave bruto për person) radhiten më ulët, për shembull, ankesat e pasiguruara dhe ankesat tjera për të ardhura. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, Neni 44.1 (c) dhe (f).

<sup>83</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 8.6.

asetet e Agjencia së Mirëbesimit. Veç kësaj asetet e trustit dhe NSh-të nuk duhet mbuluar kurrfarë borxhi të trustit të Agjencisë.<sup>84</sup>

## **I. Pozicioni i Agjencisë së Mirëbesimit dhe i Drejtorëve të saj**

1) Përgjegjësitë e kufizuara të Agjencisë të Mirëbesimit dhe juridiksioni ekskluziv i Dhomës së Veçantë

Përgjegjësia e Agjencisë të Mirëbesimit në mënyrë strikte është e kufizuar në mjetet e Agjencisë të Mirëbesimit, plus pjesës së papaguar të kapitalit të saj të atribuuar Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet ndërmarrjeve dhe drejtorëve të tyre.<sup>85</sup> Më tepër, Agjencia është përgjegjëse vetëm për veprimet dhe mosveprimet që janë jashtë autoritetit të saj, që paraqet keqpërdorim të pozitës zyrtare, ose paraqet shkeljen e obligimeve kontraktuese të shkaktuar nga Agjencia e Mirëbesimit.<sup>86</sup> Andaj, çdo përgjegjësi e tillë e Agjencisë së Mirëbesimit është e kufizuar për personat që vuajnë humbje financiare si rezultat i drejtpërdrejt të veprimit ose mosveprimit të Agjencisë së Mirëbesimit. Agjencia në asnjë rast nuk përgjigjet për dëmet që janë bërë si rrjedhim i tërthortë ose si pasojë e masave ndëshkuese.<sup>87</sup>

Palët të cilat parashtrajnë ankesë kundër Agjencisë së Mirëbesimit, mund ta bëjnë atë vetëm në Dhomën e Veçantë. Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë së Mirëbesimit dhe kërkohet njoftim paraprak në afat prej 60 ditëve për Agjencinë e Mirëbesimit.<sup>88</sup>

2) Përgjegjësia e Bordit dhe e personelit të Agjencisë të Mirëbesimit

Bordi, udhëheqësia dhe personeli i Agjencisë të Mirëbesimit nuk janë përgjegjëse ndaj asnjë pale përveç Agjencisë të Mirëbesimit për çdo veprim në emër të Agjencisë të Mirëbesimit brenda shtrirjes së autoritetit të tyre.<sup>89</sup>

---

<sup>84</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, nenet 18.1, 18.2 dhe 18.3.

<sup>85</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, nenet 18.1, 18.2.

<sup>86</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 18.4. Në një aktgjykim të 10 tetorit 2006 (*Grand Grup Partneriteti, JSC kundër AKM-së, SCC-06-0176*), Dhoma e Veçantë kishte mendimin që, duke iu referuar nenit 10.4 të Rregullores e UNMIK-ut Nr. 2002/13, këto dispozita janë të zbatueshme për kërkesat për dëme ose mjetet të ngjashme nga Agjencia e Mirëbesimit dhe jo për “vendimet e zakonshme gjyqësore”.

<sup>87</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 18.5.

<sup>88</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 30.

<sup>89</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 16.9. Sipas Rregullores e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 13.5, Agjencisë së Mirëbesimit drejtorët janë përgjegjës para Agjencisë për pasojat e vendimeve që ata realisht i kanë marrë kur kanë marrë pjesë nëse: (1) Kanë vepruar në kundërshtim me nenin 13.4; (2) Kanë ditur ose ka qenë e arsyeshme të dinë se një vendim i tillë është në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2005/18 apo me ndonjë ligj tjetër në fuqi ose me ndonjë vendim të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe (3) nëse drejtori ka shpërfillur në masë të madhe standardet e administrimit të mirë që duhet të zbatohen për ata që kanë pozita të tilla. Ka pasur raste kur parashtruesi i ankesës kishte paditur anëtarët e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë së Mirëbesimit pranë Dhomës së Veçantë. Për shembull, në një rast (*Grand Hotel Grupi i Partneritetit, JSC kundër AKM, SCC-06-0176*) parashtruesi i ankesës kishte argumentuar që Drejtori Menaxhues i Agjencisë së Mirëbesimit i ka shkaktuar dëme parashtruesit të ankesës, dhe kishte qenë përgjegjës për, dhe i duhej të paguaj, për dëme të tilla sipas nenit 154.1 të Ligjit të Kosovës mbi Detyrimet. Dhoma e Veçantë e kishte pezulluar ankesën.

#### **IV. PROBLEMET LEGJISLATIVE ME KORNIZËN LIGJORE MBI AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT**

##### **A. Legjislacioni është i Ndërlikuar**

Legjislacioni i cili e udhëheqë Agjencinë e Mirëbesimit dhe procesin e privatizimit është i ndërlikuar dhe përfshihet në instrumente të ndryshme. Ja edhe disa shembuj:

- Likuidimi vullnetar i NSh-ve bazohet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/18, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nenin 9. Ky nen i referohet “procedurës së krijuar sipas Rregullores për Shoqëritë Tregtare”.<sup>90</sup> Për më tepër, neni 43.4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve të tyre siguron që likuidimet vullnetare duhet të bëhen në përputhje me dispozitat për likuidimet e urdhëruara nga gjykata të asaj rregulloreje. Urdhëresa Administrative nr. 2007/1 veçon disa çështje që janë të rëndësishme në likuidimet dhe kjo urdhëresë ka krijuar komisione shqyrtuese. Urdhëresa Administrative nr. 2006/17 përshkruan procedurat për riorganizim dhe likuidim dhe për shqyrtim të vendimeve të komisioneve për likuidim pranë Dhomës së Veçantë.
- Krijimi i qiradhënies për toka është bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13 e cila është ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45 dhe zbatuar me Urdhëresën Administrative nr. 2005/12.
- E drejta e punonjësve për 20% nga mjetet e shitjes është shkruar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe në ndryshimet e saja. Urdhëresa Administrative nr. 2006/17 i përshkruan procedurat për ankesa në lidhje me listat para Dhomës së Veçantë. Ligji kundër diskriminimit është relevant për ankesat e bazuara në diskriminim.

##### **B. Legjislacionit Ndonjëherë i Mungojnë Hollësitë**

Rregulloreve dhe Urdhëresave Administrative nganjëherë iu mungon qartësia dhe hollësitë e mjaftueshme. Kjo i ka shtyrë si Agjencinë e Mirëbesimit, ashtu edhe Dhomën e Veçantë që të kërkojnë udhëzues.

Për shembull, sipas rregullave të mëparshme në lidhje me të drejtën e punonjësve për 20% të mjeteve nga shitja, Agjencia e Mirëbesimit në një rast kishte informuar Dhomën e Veçantë se nuk kishte marrë parasysh ndonjë ankesë. Kishte pritur vendimin e Dhomës së Veçantë në lidhje me atë se si ta ushtrojë autoritetin e saj kur i përpilon listat e punonjësve legjitim para se të luaj ndonjë rol aktiv në proces.<sup>91</sup> Që atëherë, rregullat janë qartësuar nga ligjvënësi (UNMIK-u) dhe ofrojnë hollësi më të shumta për dobi si të Agjencisë të Mirëbesimit, ashtu edhe Dhomës së Veçantë.<sup>92</sup>

<sup>90</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/6.

<sup>91</sup> Shih aktgjykimin e 9 qershorit 2004 në *Vahdet Kollari në rastin Termosistemi kundër AKM-së*, SCEL04-0001.

<sup>92</sup> Urdhëresa Administrative 2006/17, neni 64.

Sa i përket të njëjtave rregulla, Dhoma e Veçantë ka kërkuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, që të qartësojë se a i zëvendëson Ligji Kundër Diskriminimit i Kosovës dispozitat për llojin e dëshmive të diskriminimit.<sup>93</sup>

Kur përcaktohet pronësia e mjeteve të cilat i privatizon Agjencia e Mirëbesimit, Agjencia e Mirëbesimit ka kërkuar nga Dhoma e Veçantë që të lëshojë një vendim mbi rregullat e privatizimit, veçanërisht sa i përket pronësisë. Dhoma e Veçantë e ka refuzuar këtë padi dhe i ka parashtruar pyetje Përfaqësuesit Special i Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me përputhshmëri të neneve 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18 dhe të nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 me dispozitat e veçanta të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (1950) (“Konventa”).<sup>94</sup>

Dhoma e Veçantë nuk ka kompetencë të jap mendime këshilluese dhe mund të lëshojë vendime vetëm në lidhje me raste specifike. Nga ana tjetër, sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/59,<sup>95</sup> Dhoma e Veçantë mund të kërkojë sqarime nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me zbatimin e Rregullores; këtu përfshihet edhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

### **C. Mirëbesimi nuk është i Definuar, Konceptet Tjera nuk janë të Qarta**

Koncepti ligjor i mirëbesimit luan rol të rëndësishëm në funksionimin e Rregullores dhe Urdhërësës Administrative në lidhje me Agjencinë e Mirëbesimit. Për shembull, neni 2.2 (a) i Rregullores e UNMIK-ut nr. 2005/18 thotë që Agjencia e Mirëbesimit udhëheqë Ndërmarrjet si administrues i besueshëm për pronarët e tyre dhe neni 8.6 thotë që procedurat nga shitja e aksioneve duhet të mbahet në besë nga ana e Agjencisë të Mirëbesimit për dobi të kreditorëve dhe pronarëve të ndërmarrjes në fjalë. Sipas nenit 18.3, llogaria dhe mjetet tjera të ndërmarrjes të udhëhequra nga Agjencisë të Mirëbesimit do të mbahet në trust ndaras nga të tjerat dhe ndaras nga llogaritë dhe mjetet tjera të Agjencisë të Mirëbesimit. Sidoqoftë, koncepti i trustit nuk është i definuar ose i përshkruar në asnjë ligj të zbatueshëm në Kosovë.<sup>96</sup>

Konceptet tjera ligjore nuk janë definuar qartë. Për shembull, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18, neni 3, e definojnë “Pronarin” si “person ose subjekt me të drejtë në pronë”. Gjithashtu, efekti ligjor i “hedhjes poshtë” të mjeteve në riorganizim të një ndërmarrje sipas nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 është i paqartë.

<sup>93</sup> Shih aktgjykimin e 17 janarit 2006 në *Qemajl Peja në rastin Ndërmarrja Progres kundër AKM-së*, SCEL-05-0002.

<sup>94</sup> Me kërkesë të 16 qershorit 2005, Agjencia e Mirëbesimit i kërkoi Dhomës së Veçantë të bashkojë pesë raste (në të cilin ka qenë e paditur), duke theksuar që secili nga këto raste ngriste këto çështje të përbashkëta; (i) ligjshmërinë e akteve të Agjencisë së Mirëbesimit në shitjen e asetëve të subjekteve me anë të privatizimit me spin-off; si dhe (ii) nëse disa lloje transformimesh mes marsit 1989 dhe qershorit 1999 janë ndërmarrë në pajtim me ligjin në fuqi apo janë zbatuar në mënyrë jo-diskriminuese. Ato gjithashtu ngrisin çështjen nëse “masat e kalimtare” dhe “ligji i transformimit” ishin “ligj në fuqi”. Agjencia e Mirëbesimit shtoi: “gjykimi mbi ligjet e lartshënuara do të qartësonin shumë situatën ligjore në rreth 70% të rasteve të Agjencisë së Mirëbesimit”. Dhoma e Veçantë refuzoi këtë kërkesë me vendimin e 29 shtatorit 2005 (*Balkanbelt kundër AKM-së*, SCC-04-0188)

<sup>95</sup> Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë.

<sup>96</sup> Përderisa koncepti i mirëbesimit mund të jetë mjaftueshëm i definuar në sistemet tjera juridike, kjo nuk është e definuar në ligjin e Kosovës.

## **D. Pezullimi i Procedurave ku përfshihen Kërkesat për Pronësi në Likuidim dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

Neni 6 i konventës siguron që “çdo njëri ka të drejtë për seancë të drejtë dhe publike në kohë të arsyeshme [...]”. Neni 13 i Konventës kërkon që “Çdonjëri të cilit iu janë shkelur të drejtat dhe liritë e parapara në Konventë ka të drejtë për mjete efektive juridike para një autoriteti kombëtar [...]”. Mirëpo, e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute. Në shumicën e shteteve palë nënshkruese të konventës, e drejta për qasje në gjykatë kufizohet kur debitori falimenton. Kufizime të tilla nuk përbëjnë domosdo shkelje të nenit 6 të Konventës atëherë kur qëllimi që ndiqet është legjitim dhe mjetet e përdorura për të arritur qëllimin janë proporcionale.<sup>97</sup>

Sidoqoftë, është shqetësuese se a i përmbush kërkesat e neneve 6 dhe 13 të Konventës pezullimi i çdo procedure ku përfshihen kërkesat për pronësi kundër NSh-ve me njoftim të thjeshtë, nga Komisioni i Likuidimit të Agjencisë së Mirëbesimit në vend të vendimit nga Dhoma e Veçantë.<sup>98</sup> Pas suspendimit, kreditorët dhe pronarët potencial duhet ta parashtrorjnë kërkesën e tyre pranë Komisionit për Likuidim brenda dy muajve pas njoftimit.<sup>99</sup> Procedurat e pezulluara gjyqësore mund të vazhdojnë vetëm me leje të Dhomës së Veçantë.<sup>100</sup>

Agjencia e Mirëbesimit konsideron se pezullimi i procedurës nuk përbën shkelje të standardeve ndërkombëtare sepse (i) pala e pakënaqur mund të parashtrorjë kërkesë pranë gjykatës që procedura të vazhdojë; (ii) komisionet e likuidimit janë të obliguar t’i njoftojnë të gjithë kreditorët dhe pronarët (që do të përfshijë palët procedurat e të cilëve janë pezulluar) se likuidimi ka filluar dhe ata mund të parashtrorjnë kërkesat e tyre; (iii) Agjencia e Mirëbesimit mund të pranojë një paditës i cili ofron arsye të mjaftueshme të parashtrorës të vonshme të padisë së tij/saj; dhe (iv) personi i pakënaqur me vendimin e Agjencisë së Mirëbesimit lidhur me likuidimi, mund ta sfidojë atë pranë Dhomës së Veçantë.

Megjithatë, si pasojë shtesë, sipas legjislacionit relevant, kreditorët dhe pronarët potencial kanë vetëm të drejtën e ndarjes së të ardhurave nga likuidimi.<sup>101</sup> Madje edhe nëse Dhoma e Veçantë eventualisht e tërheq suspendimin e procedurës gjyqësore, dhe vendoset se ka pronarë privat të pronës në likuidim, pronarët kanë të drejtë vetëm në ndarje të pronës. Mirëpo ata nuk mund ta rimarrin pronën e tyre. Kështu, OSBE-ja beson se njoftimi nga Komisioni për Likuidime për Dhomën e Veçantë bazuar në nenin 13.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/1, e cila ka efektin e njëjtë si Moratoriumi -- suspendimi i të gjithë procedurave gjyqësore dhe cenimi i së drejtës mbi kthim të pronës të pronarëve potencial -- mund të përbëjë shkelje të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>102</sup>

<sup>97</sup> Shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *M kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 12040/86: 52 D. R. 269.

<sup>98</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 13.1.

<sup>99</sup> Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut Nr. 2007/1, neni 14.1; Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 43.3 (d).

<sup>100</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/48, neni 5.1.

<sup>101</sup> Rregullorja e UNMIK-ur Nr. 2005/48, neni 44.1 (e).

<sup>102</sup> Shih gjithashtu kapitullin V. C. Të këtij raporti, *S’ka Shfuqizim, s’ka Rikthim*.

Në një rast (*Meti Impex, Kompani Private kundër KHT Kosova në likuidim dhe kundër AKM-së*, SCC-06-0449) Agjencia e Mirëbesimit vazhdimisht ia kishte dërguar Dhomës së Veçantë njoftimin për likuidim të NSh-së dhe gjithashtu edhe padinë për suspendim të bazuar në ligjin e vjetër.<sup>103</sup> Gjatë seancës dëgjimore të 5 shtatorit gjyqtari kryesor kishte deklaruar:

“Dhoma [...] është pajtuar që suspendimet e tilla e kundërshtojnë nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe se suspendimet e tilla mund të zbatohen vetëm në ekzekutimin e aktgjyqimeve”.<sup>104</sup>

OSBE-ja beson se kufizimi mund të justifikohet vetëm nëse qëllimi është legjitim dhe mjetet e përdorura janë proporcionale. Me sa duket proporcionaliteti mund të arrihet vetëm nëse pezullimi nuk bëhet thjeshtë nga një njoftim nga Komisioni i Likuidimit – i emëruar dhe përgjegjës ndaj Agjencisë së Mirëbesimit, që është njëra nga palët në procedurë e cila mund të iu nënshtrohet pezullimit. Në vend të kësaj pezullimi duhet të vendoset nga gjykata (Dhoma e Veçantë).

### **E. Dëshmia e Diskriminimit në Rastet me Listat e Punonjësve**

Neni 10.6 (b) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 kërkon që padia e parashtruar në Dhomën e Veçantë me supozimin që paditësi është përjashtuar nga lista e punonjësve legjitim për shkak të diskriminimit, të shoqërohet me prova materiale. Sidoqoftë, Dhoma e Veçantë ka përcaktuar që kjo padi nuk përputhet me nenin 14 (ndalim prej diskriminimit) i Konventës,<sup>105</sup> me nenin 221.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore<sup>106</sup> dhe me nenin 8 të Ligjit kundër Diskriminimit i Kosovës.<sup>107</sup>

Duke iu referuar disa aktgjyqimeve dhe sqarimit të nenit 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.<sup>108</sup> Dhoma e

---

<sup>103</sup> Parashtrimet e padive të 4 qershorit, 30 gushtit dhe 27 shtatorit 2007 të bazuara në Rregulloren 2002/12, neni 9 dhe në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/6, neni 39.3.

<sup>104</sup> Dhoma e Veçantë ende nuk ka vendosur për njoftim sipas rregullave të reja.

<sup>105</sup> Neni 14 i Konventës citon: “Gëzimi i të drejtave dhe lirive siç parashihet në këtë Konventë duhet të sigurohen pa diskriminim në asnjë bazë [...]”.

<sup>106</sup> Neni 221.4 i Ligjit të Procedurës Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë Nr. 4/77-1478, 36/80-1182 dhe 69/82-1596) citon: “Nevojiten të dëshmohen faktet që janë çështje e njohurive të përbashkëta.”

<sup>107</sup> Neni 2.1 i Ligjit Nr. 2004/3 i shpallur përmes rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/32 (Ligji kundër Diskriminimit), neni 8.1, citon që kur personat prezantojnë fakte të cilat mund të prezumohet që ka pasur diskriminim të drejtpërdrejt apo të tërthortë, duhet që pala përgjegjëse të dëshmojë që nuk ka pasur ndonjë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

<sup>108</sup> Në një procedurë që ka të bëjë me ankesat e një numri të njerëzve që supozojnë që janë përjashtuar nga lista e punonjësve për shkak të diskriminimit, Dhoma e Veçantë ka vendosur (vendimi i 9 qershorit 2004, *Vahdet Kollari në rastin Termostemi kundër AKM-së*, SCEL 04-0001):

“Dhoma e Veçantë do të merr parasysh jo vetëm provat materiale siç kërkohet me nenin 10.6 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, për arsye se kjo dispozitë në kufizimin e llojit të dëshmisë së kërkuar është diskriminuese sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket nenit 14 të Konventës.” Aq më tepër, Dhoma e Veçantë iu kishte referuar nenit e 221.4 të Kodit të Procedurës Civile, duke theksuar që faktet janë çështje e njohurive të përbashkëta dhe nuk ka nevojë të dëshmohen.

Në një aktgjykim të 17 janarit 2006 (*Qemajl Peja në rastin e NSh Progres kundër AKM-së*, SCEL-05-0002), Dhoma iu kishte referuar një precedenti gjyqësor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu kishte cituar qartësimin që kishte kërkuar nga PSSP-ja që dispozitat e nenit 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit t’i zëvendësojnë dispozitat e nenit të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 që

Veçantë në përgjithësi ka qëndrimin<sup>109</sup> që personi mund të parashtrorë deklaratë standarde për diskriminim, faktet nga të cilat mund të prezumohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë si dhe një kopje të certifikuar të bllokut të shënimeve që tregon për përkushtimin në NSh në datën më shumë se tre vite përpara dhe që tregon që është ende e hapur. Nën rrethanat e tilla, individi në përgjithësi do të konsiderohet punonjës legjitim.<sup>110</sup>

## **F. Publikimi nga ana e Agjencisë së Mirëbesimit, i Politikave Operative, Raportet Vjetore dhe Raportet e Auditivit**

### 1) Politikat operative

Neni 10 i Rregullores 2005/18 e obligon Bordin e Agjencisë të Mirëbesimit që “të lëshojë politikat operative që e udhëzojnë Agjencinë e Mirëbesimit si t’i ushtrojë kompetencat e saja...”. Këto politika duhet të përmbajnë rregulla që e rregullojnë shitjen publike të vartësit të NSh-ve.

OSBE-ja beson që legjislacioni duhet të parasheh se politikat operative nuk duhet të përmbajnë vetëm rregulla për shitjen e aksioneve, por gjithashtu edhe për administrim dhe për riorganizim dhe likuidim të NSh-ve. Edhe pse OSBE-ja nuk i ka shqyrtuar politikat operative, Agjencia e Mirëbesimit ka këshilluar se disa nga fushat - siç janë çështjet e ndërlidhura me administrimin e NSh-së - tashmë janë të mbuluara me politikat operative.<sup>111</sup> Rregullat e riorganizimit, deri më tani janë zbatuar vetëm në Trepçë, dhe nuk njihen më gjerë. Administrimi dhe likuidimi i NSh-ve ka tendenca të bëhet vetëm në nivelin lokal dhe kështu janë më pak transparente për publik.

Kur OSBE-ja ka kërkuar një kopje të politikave operative në nëntor të vitit 2007, Agjencia e Mirëbesimit ka refuzuar, duke argumentuar se politikat operative janë “të

---

kërkojnë prova materiale të diskriminimit. (qartësimi nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003 e datës 12 maj 2003, 11 janar 2006. Pas qartësimit, Dhoma e Veçantë gjithashtu kishte vlerësuar që UNMIK-u kishte nxjerr Ligjin Kundër Diskriminimit sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 që thotë në mënyrë të qartë që ai mbizotëron mbi ligjet e mëparshme në këtë fushë.

Dhoma e Veçantë ka konstatuar që Ligji Kundër Diskriminimit në Kosovë “zhvlerëson ato dispozita të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13 që janë në kundërshtim me [...] Dhoma duhet të merr në konsideratë faktet që mund të prezumohet që ka pasur diskriminim të drejtpërdrejt ose të tërthortë. Nuk mund ta kufizojë veten vetëm në prova materiale, por duhet gjithashtu të merr parasysh edhe llojet tjera të dëshmimeve, përfshirë dëshmitë statistikore dhe çështjet e njohurive të përgjithshme. Krahas kësaj, pasi ta ketë përgatitur parashtruesi rastin në shikim të parë (prima facie) të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pala përgjegjëse (Agjencia e Mirëbesimit) do të vërtetojë që nuk ka pasur shkelje të parimit të barazisë.”

<sup>109</sup> Shih për shembull vendimet në vijim: *Dragoljub Grujic në rastin e NSh Ringov, Peja kundër AKM-së*, SCEL-05-0016, 20 korrik 2006; *Jovan Stankovic në rastin NSh Bosko Cakic/Mustafa Rexhepi kundër AKM-së*, 31 janar 2007, SCEL-06-020 dhe *Asija Niksic në rastin NSh “1 Maji” në Mitrovicë/Mitrovica kundër AKM-së*, 31 janar 2007, SCEL-06-026.

<sup>110</sup> Ankesat për listën e punonjësve janë refuzuar kur këto kritere nuk janë përmbushur, kur ankesat janë parashtruar me vonesë, ose kur avokati i cili ka përfaqësuar punonjësit nuk ka prezantuar autorizimin për avokat mbrojtës nga klientët e tij. Shih për shembull vendimin *Dragoljub Grujic NSh Ringov, Peja, kundër AKM-së* të 20 korrikut 2006 dhe *Qemajl Peja NSh Progres kundër AKM-së* të 17 janarit 2006.

<sup>111</sup> Sipas informatës së dhënë nga Agjencia e Mirëbesimit për OSBE-në në prill 2008.

brendshme dhe janë dokumente të ndjeshme komerciale” pasi që kanë përmbajtur seksione që kanë të bëjnë me, për shembull, marrëveshjet e ofertuesve. Agjencia e Mirëbesimit pohon se ka përvojë në tentimet që janë duke u bërë nga ofertuesit që të blejnë ndërmarrjet, përmes marrëveshjeve, frikësimeve e falsifikimeve dhe është angazhuar që të themeloi rregulla për t’i kundërshtuar ato më së miri që të jetë e mundur.<sup>112</sup>

OSBE-ja beson që politikat operative të Agjencisë të Mirëbesimit janë dokument të rëndësishme pasi që ato i shtjellojnë procedurat e privatizimit. Kjo nuk është e rëndësishme vetëm për Agjencinë e Mirëbesimit, por edhe për palët e treta që hyjnë në marrëveshje kontraktuese me Agjencinë e Mirëbesimit dhe do të dëshironin që të vërtetojnë përputhshmërinë e vet rregullave të Agjencisë të Mirëbesimit. Për këto arsye, OSBE-ja sugjeron që politikat operative duhet të bëhen publike.<sup>113</sup>

## 2) Raportet tremujore dhe vjetore

Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18 e obligon Bordin e Agjencisë të Mirëbesimit që duhet t’ia dorëzojë raportet tremujore Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm<sup>114</sup> dhe duhet të publikojnë raportet vjetore të Agjencisë të Mirëbesimit.<sup>115</sup>

Bordi gjithashtu duhet të miratojë aktet nënligjore të Agjencisë së Mirëbesimit dhe politikat financiare.<sup>116</sup> Veç kësaj, Rregullorja e obligon Agjencinë e Mirëbesimit të bëjë revizionin vjetor. Këto revizione duhet të zgjerohen në secilën ndërmarrje dhe të përgjegjësit e trustit të administruara nga Agjencia e Mirëbesimit.<sup>117</sup>

OSBE-ja beson që Agjencia e Mirëbesimit do të rrisë transparencën e saj duke publikuar në faqen e saj të internetit raportet tremujore dhe ato vjetore dhe raportet e revizionit. Veç kësaj, për të promovuar transparencën e operacioneve të saja, raportin vjetor të Agjencisë të Mirëbesimit, duhet të përfshijë statutet dhe politikat financiare të Bordit.

## H. Zgjedhja e Ligjit dhe Rregullat e Tenderimit

---

<sup>112</sup> Rregullat e Tenderit (për privatizim), natyrisht janë dokumente në dispozicion të publikut.

<sup>113</sup> Neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18 parasheh se Bordi i Agjencisë së Mirëbesimit do t’i publikojë politikat operative dhe numëron 13 pika që do të mbulohen në veçanti nga këto politika. OSBE-ja sugjeron që këto politika operative të bëhen publike për shkak se natyra e shumicës nga këto çështje dhe fjalët e përdorura në disa nënparagrafë (“transparent”, “proceset lidhur me çështjet që kërkojnë procese të menjëhershme”, “nxjerrjen e njoftimeve”) lënë të kuptohet se kjo do të ishte e arsyeshme.

<sup>114</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 20.1 obligon që raportet tremujore duhet të përmbledhin aktivitetet dhe të reflektojnë rezultatet financiare të Agjencisë së Mirëbesimit.

<sup>115</sup> Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 20.2, raporti vjetor duhet të përfshijë deklaratat përgjegjëse dhe mjetet e mbajtura nga Agjencia e Mirëbesimit, një regjistër i ndërmarrjes të mbikëqyruar drejtpërdrejt nga administrata e Agjencisë së Mirëbesimit, një regjistër të krijimit të shitjes së vartësve të NSh-ve, të arritura gjatë periudhës së raportuar dhe të pezulluara, një regjistër të ndërmarrjes së likuiduar dhe një regjistër të ndërmarrjes së deklaruar si e falimentuar.

<sup>116</sup> E kërkuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 14 dhe neni 19.

<sup>117</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 25.2.



Rregulla e tenderimit nuk e specifikon ligjin e zbatueshëm ose nuk përmban zgjedhjen e dispozitave të ligjit. Kjo mund të rezultojë me konflikt nëse pala e huaj është në mesin e tenderuesve ose fiton tenderin,

Në një rast *Industria e Drurit LLC kundër AKM-së* (SCC-04-0130), parashtruesi i ankesës e kishte argumentuar këtë konflikt sa i përket tenderit sipas rregullave të tenderimit që iu ishte nënshtruar ligjit të shtetit të Nju Jorkut/ New York për shkak se një draft i kontratës përmbante dispozitë për atë efekt. Me aktgjykim të 26 tetorit 2005, Dhoma e Veçantë e kishte refuzuar këtë argumentim.<sup>118</sup>

Rregullat e tenderimit gjithashtu janë të dykuptimta sa i përket juridiksionit të çfarëdo gjykate për konfliktet e mundshme që kanë të bëjnë me procesin e tenderimit.<sup>119</sup> Sidoqoftë, Dhoma e Veçantë ka hedhur poshtë pohimin e Agjencisë të Mirëbesimit se rregullat e tenderimit i garantojnë Agjencisë të Mirëbesimit që vendimet e tyre janë të prera dhe e ka marrë juridiksionin.<sup>120</sup>

OSBE-ja beson që rregullat e tenderimit duhet të përmbajnë klauzola të qarta në lidhje me zgjedhjen e ligjit.

## **V. PRIVATIZIMI MUND TË DËRGOJË NË EKSPROPRIJIM TË PALIGJSHËM**

Sipas mendimit të OSBE-së, nëse asetet në një NSh-je dalin nga një eksproprijim i paligjshëm (për shembull, një konfiskim i paligjshëm nga autoritetet Jugosllave pas luftës së dytë botërore),<sup>121</sup> privatizimi i një NSh-je të tillë nga Agjencia e Mirëbesimit do të ishte gjithashtu një eksproprijim i paligjshëm. Kjo, për shkak se ligjet për privatizimin (si Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 dhe 2002/13) mund të mos i plotësojnë kërkesat për eksproprijime sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të zbatueshme në Kosovë, posaçërisht neni 1 i Protokollit 1 të Konventës.<sup>122</sup>

---

<sup>118</sup> Dhoma konsideron që: “është parim i vërtetuar në çështjet e konfliktit të ligjeve që përderisa palët janë të lira, brenda kufizimeve, të zgjedhin çfarëdo ligji për t’i rregulluar marrëdhëniet kontraktuese, në mungesë të kontratës obligative duhet të merren parasysh faktorët tjerë. Vendi ku eventualisht do të bëhet kontrata, vendi ku gjendet prona e cila është bazë e kontratës dhe vendi ku do të bëhet aktiviteti i mbuluar me kontratë, të gjitha këto janë faktorë domethënës. E vetmja lidhje me New York në këtë rast duket të jetë zyra e regjistruar e parashtruesit të ankesës”.

<sup>119</sup> Neni 17 i rregullave të tenderimit citon: “1. Sipas nenit të mëposhtëm 17.2, vendimet e agjencisë ... janë të prera dhe nuk mund të apelojnë në asnjë gjykatë ose në ndonjë organ. Tenderuesit nuk kanë të drejtë të parashtrorjës çfarëdo ankese, brenda, ose jashtë Kosovës ...” “2. Pavarësisht klauzolës së procedurës, palët e dinë dhe pajtohen që Dhoma e Veçantë... ka juridiksion ekskluziv dhe të prerë mbi agjencinë”.

<sup>120</sup> Shih për shembull vendimin e 18 majit 2006 (*Grand Grupi i Partneritetit JSC kundër AKM-së*, SCC-06-0176. përfaqësuesit e Agjencisë së Mirëbesimit kanë konfirmuar që në praktikë Agjencia e Mirëbesimit e pranon juridiksionin e Dhomës së Veçantë në konfliktet që kanë të bëjnë me rregullat e tenderit.

<sup>121</sup> Shih Kapitullin II të këtij raporti.

<sup>122</sup> Sa i përket aplikimit të drejtpërdrejtë shih: nenin 3.2 (b) dhe 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë: Shih gjithashtu Rr Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/24 për Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë i ndryshuar me Rregulloren Nr. 2000/29 seksioni 1.3: “për ushtrimin e funksioneve të tyre, të gjithë personat që ushtrojnë detyra publike apo që mbajnë poste publike në Kosovë i respektojnë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç janë reflektuar posaçërisht në Konventë, përfshirë nenin 1 të

## A. Eksproprijimi sipas Protokollit 1 të Konventës

Si përmbledhje, duke iu referuar interpretimit të nenit 1 i Protokollit 1 të Konventës<sup>123</sup> nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, shpronësimi duhet t'i përmbushë kërkesat në vijim.

1. Para se të paraqitet shpronësimi, autoriteti duhet të përcaktojë që marrja e pronës është “për interes publik”. Për këtë përcaktim, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut i ofron legjislacionit vendor fushëveprim të gjerë dhe do t'i shfuqizoj aktgjykimet legjislative vetëm nëse përcaktimi është “i manifestuar pa ndonjë bazë të paarsyeshme”.<sup>124</sup> Për shembull, ky mund të jetë rasti nëse privimi nga prona bëhet për të transferuar pronën nga individ i privat te individ tjetër. Sidoqoftë, varësisht nga rrethanat, edhe në ato raste mund të ketë interes publik.<sup>125</sup>

2. Duhet të ketë proporcionalitet ndërmjet interesit të komunitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të individit.<sup>126</sup> Faktorët që janë të rëndësishëm në përcaktimin se a është arritur baraspeshimi përfshijnë:

- a) Se a pranon individ i privuar kompensim të mirëfilltë. Kjo është shpesh- por jo edhe gjithherë- e konsideruar të jetë vlera e tregut e mjetit. Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut ka pranuar përjashtime në këtë rregull. Në disa raste, Gjykata Evropiane për të

---

Protokollit 1. Në raportin e OSBE-së, *Shqyrtimi i Parë mbi Sistemin e Drejtësisë Penale, 10 gusht 2000*, fq 16 dhe në vazhdim

([http://www.osce.org/documents/mik/2000/08/970\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2000/08/970_sq.pdf)), OSBE kishte njohur rëndësinë e epërsisë së zbatimit të standardeve për të drejtat e njeriut. Edhe pse Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/24 nuk e kishte paraparë në mënyrë eksplicite epërsinë e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në një letër dërguar Kryetarit të Odës së Avokatëve në Beograd me datë 14 qershor 2000, kishte konfirmuar se neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 vlen për gjyqtarë dhe kjo do të thotë se ata nuk duhet ta aplikojnë asnjë paragraf të ligjit vendor i cili nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Veç kësaj, neni 3.3 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë konfirmon zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

<sup>123</sup> Neni 1 i Protokollit 1 i Konventës citon: “Çdo person fizik ose ligjor ka të drejtë të gëzojë në paqe pronën e tij. Askush nuk do të privohet nga pronësia e tij përveç nëse është interesi publik në pyetje dhe që i nënshtrohet kushteve të parapara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. [...]”

<sup>124</sup> Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *James dhe tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1986, aplikacioni Nr. 8793/79, para. 46; *Lithgoë dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, aplikacioni Nr. 9006/80, 9262/81, 9263/81, 9265/81, 9266/81, 9313/81, 9405/81, para. 122; *Pressos Compania Naviera S. A. dhe tjerët kundër Belgjikës*, 20 nëntor 1995, aplikacioni Nr. 17849/91, para. 37; *Ish Mbreti i Greqisë dhe tjerët kundër Greqisë*, 23 nëntor 2000, aplikacioni Nr. 25701/94, para. 87; *Broënioëski kundër Polonisë*, 22 qershor 2004, aplikacioni Nr. 31443/96, para. 149.

<sup>125</sup> Aktakuza e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, e datës 21 janar 1986, aplikacioni nr. 8793/79, paragrafi 40.

<sup>126</sup> *P. van Dijk dhe G. J. H. van Hoof, Teoria dhe Praktika e GJEDNJ*, fq. 881; shih gjithashtu, aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Sporrong dhe Lonroth kundër Suedisë*, 23 shtator 1982, aplikacionet nr. 7151/75, 7152/75, paragrafi. 69; *Jahn dhe të tjerët kundër Gjermanisë*, 30 qershor 2005, aplikacioni Nr. 46720, 72203 dhe 72552, paragrafi 93.

Drejta të Njeriut ka konsideruar që mjaftojnë disa shuma të vogla.<sup>127</sup> Ka konsideruar që në disa raste me përjashtim, mungesa e kompensimit ishte e arsyetueshme.<sup>128</sup> Në atë rast (për shembull në rast të “një individ dhe ngarkesa e tepërt” për pronarin), kërkohet një shumë më e madhe.<sup>129</sup>

- b) Qëndrimin dhe rrethanat personale të palëve të përfshira siç janë:
  - a ka vepruar autoriteti vendor në kohë të arsyeshme dhe në mënyrë të mirëfilltë dhe të qëndrueshme,<sup>130</sup>
  - a ka pranuar individi marrjen,<sup>131</sup> dhe
  - a ka qenë i mundshëm shqyrtimi gjyqësor.<sup>132</sup>
- c) Sidoqoftë, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në një rast ka theksuar se kur ka një numër të madh të ankesave të njëjta, pranohen kategoritë dhe standardet e përgjithshme.<sup>133</sup>

3. Privimi nga prona duhet t'i nënshtrohet kushteve të parapara sipas ligjit vendor dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

- Sa i përket ligjit vendor, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut nuk merret me çështjen se a është zbatuar drejt ligji vendor apo jo, po kërkon që të ekzistojë përputhja me dispozitat e qasshme dhe të qëndrueshme ligjore vendore.<sup>134</sup> Andaj, duhet të ketë mbrojtje, në formën e mbrojtjes procedurale, nga arbitrariteti.
- Referenca në parimet e së drejtës ndërkombëtare e obligon pagesën e dëmit. Sidoqoftë, ky parim ka të bëjë vetëm me

<sup>127</sup> Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Lithgow dhe tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, aplikacioni nr. 9006/80, 9262/81, 9265/81, 9266/81, 9313/81 9405/81, paragrafi 121; *Manastiret kundër Greqisë*, 9 dhjetor 1994, aplikacioni Nr. 13092/87, 13984/88, para. 70-71: “qëllimet legjitime të interesit publik mund të kërkojnë më pak se kompensimi i vlerës së plotë të tregut.”

<sup>128</sup> Aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Jahn dhe tjerët kundër Gjermanisë*, 30 qershor 2005, aplikacioni nr. 46720, 72203 dhe 72552, paragrafët 94, 111 dhe 116-117, në baza, *inter alia*, të së drejtës sociale (sa i përket palës që ka pranuar fitim të papritur).

<sup>129</sup> Aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hentrich kundër Francës*, 22 shtator 1994, aplikacioni Nr. 13616/88, paragrafët 43-49.

<sup>130</sup> Aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Broniowski kundër Polonisë*, 22 qershor 2004, aplikacioni nr. 31443/96 paragrafi 151.

<sup>131</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Allan Jacobsson kundër Suedisë*, 25 tetor 1989, aplikacioni nr. 10842/84, paragrafi 61.

<sup>132</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Hentrich kundër Francës* 22 shtator 1994, aplikacioni nr. 13616/88, paragrafi 49.

<sup>133</sup> Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur që: “paqartësia, gjykimi, shpenzimet dhe shtyrjet që pashmangshëm do të shkaktohen... sipas skemës së shtjellimit të secilit rast prej mijëra rasteve” mund të nënkuptohet që “vet sistemi nuk mund të zhvlerësohet si jo racional dhe jo i përshtatshëm”. Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1986, aplikacioni nr. 8793/79 paragrafi 68. Shih gjithashtu edhe aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Lithgow kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, aplikacioni nr. 9006/80, 9262/81, 9265/81, 9266/81, 9313/81 9405/81, paragrafët 121 dhe 122.

<sup>134</sup> Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Lithgow kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, aplikacioni nr. 9006/80, 9262/81, 9265/81, 9266/81, 9313/81 9405/81, paragrafi, 110; *Hentrich kundër Francës*, 22 shtator 1994, aplikacioni nr. 13616/88 paragrafi 42.

nacionalizimin e pronës së huaj dhe nuk mund të kërkohet të bëhet kundër nënshtetësisë së pronarit.

## B. Nenet 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18

Pas ndryshimit të Rregullores së mëparshme të UNM IIK-ut 2002/12,<sup>135</sup> sipas neneve 5.3 dhe 5.4 të Rregullores 2005/18, kërkohet nga Agjencia e Mirëbesimit pasi të ketë privatizuar ose likuiduar një NSh të përcaktojë se a është transformuar në mënyrë të vlefshme entiteti i tillë dhe a është implementuar ky transformim në mënyrë jo-diskriminuese të atillë që një palë e tretë të mund të njihet si pronar i entitetit. Kështu pas privatizimit, Agjencia e Mirëbesimit (ose personi të cilit iu ka shitur mjeti) nuk ia kthen mjetet pronarëve.<sup>136</sup> Por në vend të kësaj, pronarët ndajnë pjesën e tyre prej të ardhurave të shitjes, por vetëm pas heqjes së shpenzimeve administrative dhe të 20% të të ardhurave për punonjësit “në listën e punonjësve”. Kjo rregullore e re i ka dhënë juridiksion të qartë Agjencisë së Mirëbesimit lidhur me cilëndo ndërmarrjes që ka qenë pronë shoqërore në mënyrën e përshkruar në Seksionin 5, pa marrë parasysh transformimin. Andaj, Agjencia e Mirëbesimit do të mundte, sipas ligjit të zbatueshëm, të shes pronën e cila ka mundësi të jetë private.

Kjo gjithashtu zbatohet edhe për palët e treta që janë bërë pronarë të mjeteve sipas transformimit (çdo lloj i ristrukturimit të ndërmarrjes që ka mundur të rezultojë në privatizim, shih Kreun II), që citon:

- Pagesa për hiset që iu janë ndarë atyre, dhe
- Transformimi
  - Që është bërë ndërmjet 22 marsit 1989 dhe 13 qershorit 2002,<sup>137</sup>
  - Në përputhje me ligjin e zbatueshëm, dhe

---

<sup>135</sup> Nevoja për ndryshim të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2002/12 u vë në pah, kur në tetor 2003, drejtuesi i atëhershëm i Bordit të Agjencisë së Mirëbesimit suspendoi përkohësisht procesin e privatizimit për shkak të shqetësimit se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12 përmbante dobësi të cilat do t'i bënin transaksionet e ardhshme të privatizimit të ndjeshme ndaj sfidave ligjore (shih Ahmet Shala, *Privatizimi në Kosovë; më i miri në Ballkan?*) Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12 ngarkoi Agjencinë e Mirëbesimit me barrën e provimit lidhur me juridiksionin e saj për të privatizuar një NSh. Shtrirja e autoritetit të Agjencisë së Mirëbesimit ishte e paqartë, gjë që nuk ishte të shërbim as të Agjencisë së Mirëbesimit. Nuk ishte e qartë se a binte çfarëdo entiteti brenda shtrirjes së autoritetit të Agjencisë së Mirëbesimit (dhe si i tillë objekt i privatizimit); Agjencia e Mirëbesimit kishte juridiksion vetëm mbi ndërmarrje të tilla nëse të njëjtat kishin kaluar nëpër transformim (për shembull, nën programin Jugosllav të privatizimit ose përmes bashkimeve/shkrirjeve apo blerjeve) para 22 marsit 1989, ose në qoftë se ka ndodhur pas kësaj date, është bërë bazuar në ligj të aplikueshëm dhe zbatuar në mënyrë jo-diskriminuese (neni 5, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12). Me 17 gusht 2004, Kai Eide, i dërguari i posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve, konkludoi në *Raportin e tij për Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Situata në Kosovë* se privatizimi është bërë shenjë e premtimeve të pa-përmbushura, dhe kështu rekomandoi që procesi i privatizimit të ec përpara pa zvarritje dhe në mënyrë efektive. Me Rregulloren e re të UNMIK-ut Nr. 2005/18, procesi i privatizimit kishte rinisur dhe ishte përshpejtuar me të madhe

<sup>136</sup> Në lidhje me këtë, është i çuditshëm definimi i “pronarit” në nenin 3 Rregullores 2005/18 si “si person ose subjekt që pretendon se është pronar i ndërmarrjes”.

<sup>137</sup> Me letërën e 24 gushtit 2004, Këshilltari Ligjor i UNMIK-ut kishte deklaruar që sipas Rregullores 1999/1, UNMIK-u ka autoritet të administrojë pronat shoqërore përfshirë këtu edhe Ndërmarrjet Shoqërore që nga 10 qershori i vitit 1999, data e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB 1244. Transformimet e NSh-ve pas 10 qershorit 1999, duke u bazuar në legjisllacionin i cili nuk është nxjerr nga UNMIK-u, nuk janë ligjshmërisht të vlefshme.

- As që ka qenë diskriminues e as nuk i ka shkelur parimet e Konventës.

Nëse nuk përmbushen këto kushte, palët e treta që përfitojnë nga transformimi nuk janë të mbrojtura dhe nuk ndajnë hiset në të ardhura.

Pasi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18 i lejon Agjencisë të Mirëbesimit që të sheshet mjetet pa përcaktimin paraprak të pronësisë së atyre mjeteve,<sup>138</sup> dhe i mbron palët që kanë blerë pronën nga Agjencia e Mirëbesimit. Si pasojë, privatizimi mund të rezultojë në eksproprijim - shitja e mjeteve që janë pronë e palëve të treta. Megjithatë, si shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, Rregullorja 2005/18, neni 5.3, nuk e përfshinë mbrojtjen e domosdoshme procedurale.

Së pari, shtrohet pyetja se a janë këto eksproprijime në interes të publikut. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjeti se autoritetet kombëtare janë në pozicionin më të mirë t'i përcaktojnë interesat e publikut. Nga këndvështrimi i Agjencisë së Mirëbesimit, ligjvënësi ka konsideruar se interesi i publikut nga programi i privatizimit në Kosovë është që të lehtësohet tranzicioni i ekonomisë jo-produktive dhe joefikase në një ekonomi që është efektive, garuese dhe që do të punësojë qindra mijëra persona të papunë në Kosovë. Kjo me të vërtetë mund të konsiderohet si interes i publikut.

Megjithatë, ndërmjetësimi duhet në jetë në përputhje me ligjin. Ligji duhet të jetë mjaft i qartë dhe i qashtë për publikun.<sup>139</sup> Shqetësuese për OSBE-në është së Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 nuk precizon se nën çfarë rrethana mund të ndodh privimi nga prona.<sup>140</sup> Në veçanti nenet 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18 ndryshojnë nga mekanizmat mbrojtës gjithëpërfshirës procedural të cilat i përmban Ligji për Eksproprijime i Kosovës, që rregullon procedurat për autoritet publike që t'i privojnë individët nga posedimet e tyre të cilat janë në interes të publikut.<sup>141</sup> Ligji për Eksproprijime përmban katër nene për "përcaktimin e interesit të përbashkët", pesë nene për "aktivitetet përgatitore për eksproprijim", dhe, vlen të ceket, 30 nene për "kompensim për pronën e eksproprijuar".

Së dyti, heqja e pronës duhet të jetë proporcionale. Mund të diskutohet se qëllimi i ringjalljes së ekonomisë në të vërtetë mund të arrihet pa eksproprijime në qoftë se

<sup>138</sup> Veprimet dhe hetimet që për momentin Agjencia e Mirëbesimit i ndërmerr para se në të vërtetë i shet mjetet mund të përshkruhet në politikat e saja operative duke u referuar në nenin 10 të Rregullores 2005/18. Sidoqoftë, siç u diskutua më lartë, Agjencia e Mirëbesimit nuk ia ka mundur OSBE-së t'i merr këto politika operative.

<sup>139</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Lithgow kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, aplikacioni nr. 9006/80, 9262/81, 9265/81, 9266/81, 9313/81 9405/81, paragrafi 110.

<sup>140</sup> Nga këndvështrimi i Agjencisë së Mirëbesimit, interesi i publikut i cituar më lartë është përmbledhur në nenin 2.2 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18. Ky nen parasheh se Agjencia e Mirëbesimit ka kompetencë "kryen detyra të tjera për të ruajtur apo për të rritur vlerën ose shanset për sukses të aktiviteteve në fjalë dhe ndërmerr hapa ose masa të tjera të tilla që, sipas diskrecionit të vet, i konsideron adekuate... e të cilët inkurajojnë rindërtimin ekonomik dhe zhvillimin në Kosovë dhe mirëqenien e banorëve të saj apo atyre të cilido rajoni të caktuar". Megjithatë, mbase mandati ligjor i Agjencisë së Mirëbesimit pikë së pari është sipas nenit 2.2 (b) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18 "të zhvillon aktivitete ndihmëse për të ruajtur ose për të rritur vlerën, shanset për sukses dhe qeverisjen e ndërmarrjeve", në të cilat mungon çfarëdo referimi mbi interesin e publikut. Kështu, nocioni i interesit të publikut mund të mos jetë i precizuar në mënyrë të mjaftueshme në rregullore.

<sup>141</sup> Gazeta Zyrtare e Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës Nr. 21/78.

kërkesat për posedim janë vlerësuar para vendimit për të privatizuar ndërmarrjen. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18, Agjencia e Mirëbesimit duhet të lëshojë politika operative me qëllim që të sigurojë pajtueshmëri nga ana e Agjencisë së Mirëbesimit me parimet e neni 1 protokollit 1 të Konventës, përfshirë këtu edhe procedurat përkitazi me çështjet e procesit të shpejtë të duhur. Shqyrtimi nga ana e Agjencisë së Mirëbesimit të padive pronësore nuk e rrezikon tërë procesin e privatizimit. Vetëm ata paditës të cilët mund të dëshmojnë se ose mbajnë titull të vlefshëm mbi pronësinë ose transformimi sipas Ligjit Jugosllav nuk përputhej me ligjin e zbatueshëm të asaj kohe, kanë të drejtë për rikthim të pronës.<sup>142</sup> Andaj, OSBE konsideron se eksproprijimi i pronës private pa vlerësim të mëparshëm të padive është jo-proporcional dhe i paarsyeshëm.

Vlen të ceket se në mungesë të legjislacionit për rikthim, asnjë gjykatë në Kosovë përfshirë këtu edhe Dhomën e Veçantë nuk ka juridiksion të shqyrtojë kërkesat kundër shpronësimeve të cilat ishin vendosur si pronë shoqërore në përputhje me ligjin e atëhershëm të aplikueshëm Jugosllav.<sup>143</sup>

Veç kësaj, si argument, neni 5.3 nuk e shkel baraspeshimin e kërkuar ndërmjet interesit të komunitetit dhe mbrojtjes së pronarit- individit. Çështja është se a e mbulon e ardhura nga shitja (në tenderin publik ose në likuidim) minus shpenzimet administrative dhe 20% për punonjës kompensimin sipas kërkesave të precedentit të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Dhoma e Veçantë konsideron që jo:

“shitja e (pronës) me privatizim duket që shitet më pak se vlera e vërtetë në treg. Kështu, nëse parashtruesi i ankesës ia del që dëshmimin e pronës, do të jenë të pamjaftueshme fondet për t’i kompensuar drejtë ata për konfiskim”.<sup>144</sup>

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18 nuk ka nevojë të përmbajë dispozitat e hollësishme të Ligjit mbi Eksproprijimin. Më shumë se kaq, ajo duhet ndryshuar duke kërkuar që Agjencia e Mirëbesimit të përcaktojë para secilit privatizim pronësinë e atyre pasurive që mëton t’i shesë, si dhe t’i kthejë ato pasuri tek pronari legjitim. Një procedurë e tillë do të çonte drejt privatizimit dhe rikthimit, e jo shpronësimit.<sup>145</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18 gjithashtu duhet të ofrojë detaje mbi atë se cilat paditësore dhe nga cilat periudha kohore janë të vlefshme ato. Në përmbledhje, ka pronarë (apo trashëgimtarë të pronarëve) toka dhe asetet e të cilëve janë eksproprijuar në mënyrë të paligjshme, transferuar në pronë shoqërore e tani janë privatizuar. Nën këto rrethana, OSBE mendon se privatizimi aktual nga Agjencia e Mirëbesimit mbase mund të rezultojë në shkelje të së drejtave pronësore.

<sup>142</sup> Sipas numrit të lëndëve në Dhomën e Veçantë, gati 100% të shpronësimeve që ndodhën gjatë kohës së Jugosllavisë ishin bërë në përputhje me ligjin e aplikueshëm të asaj kohe dhe për këtë arsye janë të vlefshme. Referenca - Memo e datës 8 shkurt 2008 nga Dhoma e Veçantë dërguar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, *Vështrimet lidhur me Memorandumin* e dërguar me 24 janar 2008 nga Agjencia e Mirëbesimit.

<sup>143</sup> Referenca - letra e Dhomës së Veçantë dërguar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, e datës 8 shkurt 2008, *Vështrimet lidhur me Memorandumin* e dërguar me 24 janar 2008.

<sup>144</sup> Vendimi i 12 tetorit 2005, *Famir Loxha dhe NSh Hotel Korzo kundër AKM-së*, SCC-05-0453.

<sup>145</sup> Alternativa do të ishte të përfshihen në mënyrë eksplicite rregullat e shpronësimit, siç janë përcaktimi paraprak i pronësisë, interesit publik dhe pagesës së kompensimit adekuat.

Këta pronarë kanë të drejtë në garancitë sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.<sup>146</sup>

### C. S'ka Shfuqizim, s'ka Rikthim

Me nenin 10.5 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 ligjvënësi synoi të krijojë të pakthyeshmë sistemin ku privatizimi nga Agjencia e Mirëbesimit do të çonte në kompensim material, në vend të rikthimit në lloj të njëjtë (kthim i pronës tek pronari i ligjshëm).

“Asnjë palë nuk duhet t’i akordohen mjete juridike në dobi të saj nëse kjo gjë kërkon anulimin e një transaksioni ose shfuqizimin e një kontrate të lidhur nga [Agjencia e Mirëbesimit], në bazë të autoritetit të saj,[...] sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.”<sup>147</sup>

Kështu, një pronar që humb pasurinë e tij apo saj në privatizim, nuk mund të kërkojë shfuqizimin e transaksionin dhe të fitojë rikthimin. Ai apo ajo është i/e kufizuar vetëm në kërkesën për kompensim.

OBSE konsideron se duke përjashtuar paditë për anulim dhe shfuqizim të kontratave të nënshkruara nga Agjencia e Mirëbesimit mund të shkelet nenin 6 i Konventës, i cili përshkruan të drejtën për gjykim të drejtë. Në mënyrë më specifike, sipas të drejtës precedentale të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6 përfshin edhe të drejtën e qasjes në gjykatë për të realizuar të drejtat ligjore.<sup>148</sup>

Nga këndvështrimi i Agjencisë së Mirëbesimit, neni 10.5 i ndryshuar i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13, është në pajtueshmëri me Konventën. Agjencia e Mirëbesimit i referohet aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Në këtë aktgjykim, Gjykata gjeti se Parlamenti mund të nxjerr ligj për eksproprijim të të drejtave pronësore në interes të publikut pa i dhënë individit të drejtë për ta sfiduar atë. Megjithatë, situata faktike në atë rast ndryshon nga situata në Kosovë. Në rastin

---

<sup>146</sup> Dhoma e Veçantë ka nënvizuar se shumica e shpronësimeve që ndodhën gjatë kohës së Jugosllavisë ishin bërë në përputhje me ligjin e aplikueshmë të asaj kohe dhe për këtë arsye janë të vlefshme Pasi që aktualisht nuk ka legjislacion mbi “rikthim”, asnjë gjykatë në Kosovë, përfshirë këtu edhe Dhomën e Veçantë nuk ka juridiksion t’i shqyrtojë paditë kundër shpronësimeve të tilla.

<sup>147</sup> Në fuqi prej 31 maj 2008, neni 10.5 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 do ta plotësojë këtë përmbledhje si në vijim: “Asnjë palë nuk duhet t’i akordohen mjete juridike në dobi të saj nëse kjo gjë kërkon anulimin e një transaksioni të përfunduar ose shfuqizimin e një kontrate të lidhur me një palë të tretë e cila veprimi në mirëbesim dhe krejtësisht në pajtim me Agjencinë, në bazë të autoritetit të saj,, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12.”

<sup>148</sup> Shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975, aplikacioni Nr. 4451/70, para 35-36: “Do të ishte jo-konceptuese, për mendimin e Gjykatës, që nenit 6 para 1 (neni 6-1) do të duhej të përshkruante në hollësi garancitë procedurale që i ofrohen palëve në një procedurë gjyqësore në proces, e të mos mbronin fillimisht të vetmen gjë që në fakt e bënë të mundshme të përfitohet nga garanci të tilla, domethënë, qasja në gjykatë. Karakteristikat për procedura të drejta, publike dhe ekspeditive nuk kanë vlerë nëse nuk ka seanca gjyqësore [...] [...] neni 6 para 1 (neni 6-1) siguron të drejtën për të parashtruar pranë gjykatës çfarëdo padi që ka të bëjë me të drejtat dhe obligimet e veta qytetare”. Dhoma e Veçantë i ka dërguar Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm një kërkesë për sqarim të shqetësimit të vet rreth neneve 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18 dhe nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13.

*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ishte vlerësuar se eksproprijimi kishte gjasa të ndikojë në përafërsisht 98 deri 99 % të një milion e një çerek shtëpive ndaj të cilave referohej legjislacioni. Kështu që, refuzimi i një individi ta sfidojë atë duke i drejtë.<sup>149</sup> Megjithatë, vetëm një përqindje e vogël e ndërmarrjeve në Kosovë, që janë objekt i privatizimit, në të vërtetë i përkasin pronarëve privat.<sup>150</sup> Në këtë kontekst, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjeti se një ngarkesë e tillë mund të jetë legjitime vetëm në qoftë se ofrohen garanci procedurale.<sup>151</sup>

Me gjithë këtë, autoritetet kompetente legjislative në Kosovë mund ta nxjerrin një ligj që do të lejonte eksproprijimin e pronës, ligj që do të ishte mjaft preciz dhe i parashikueshëm dhe i cili do të ofronte mekanizmat mbrojtës të duhur në pajtim me nenin 1 të protokollit 1 të Konventës.<sup>152</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2005/18, nuk i plotëson këto standarde.

#### **D. Masat e përkohshme**

Neni 5.3 dhe 5.4 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, lidhur me nenin 10.5 të Rregullores 2002/13, çojnë në konkluzionin si në vijim për paditësit të cilët kanë asete në NSH-të:

- Para shitjes në ankand publik apo likuidimit, mund të ndodh rikthimi.<sup>153</sup> Një person i cili merr pronësinë e një NSH-je ose mbi një NSH ose aset që mbahet nga NSH-ja mund të merr pronën e tij duke parashtruar një padi mbi pronësinë. Nëse Agjencia e Mirëbesimi nuk ia kthen asetin pronarit, personi duhet të paraqesë padi për pronësi në Dhomën e Veçantë. Nëse shitja është e menjëhershme paditësi duhet të kërkojë një masë të përkohshme i cili do ta bllokojë shitjen përkohësisht.
- Nëse ka ndodhur shitja, rikthimi nuk mund të ndodh. Pronari mund të paraqesë padi vetëm për pronësi dhe të merr kompensim për këtë por jo rikthim.

Në mënyrë që të pranohet masa e përkohshme dhe shtyhet shitja e pronës<sup>154</sup>

---

<sup>149</sup> Shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1986, aplikacioni nr. 8793/79, paragrafi 68.

<sup>150</sup> Bazuar në informata nga Dhoma e Veçantë, deri më sot, vetëm në një rast paditësi ka arritur të dëshmojë se ka pronësi mbi pronën e kontestuar (në çështjen *Aleksandër Haxhijevic dhe Vera Frtunic kundër AKM-së dhe NSH-së Hotelet Trepça, restoranti Parajsa (Kompani Hoteliere Ibar)*, (SCC-06-0010).

<sup>151</sup> Shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hentrich kundër Francës*, 22 shtator 1994, aplikacioni nr. 13616/88, paragrafi 49.

<sup>152</sup> Në kontekst tjetër, OSBE-ja tashmë ka potencuar që Ligji i ri mbi Eksproprijimet duhet të përmbaj mbrojtje adekuate dhe efektive lidhur me të drejtën pronësore dhe të drejtat e njeriut që ndërlidhen me të, siç janë mjetet efektive ligjore, njoftimi adekuat, procedurat transparente dhe kompensime adekuate, shih raportin e OSBE-së, Eksproprijimet në Kosovë, dhjetor 2006, [http://www.osce.org/documents/mik/2006/12/22676\\_sq.pdf](http://www.osce.org/documents/mik/2006/12/22676_sq.pdf), fq 6 (rekomandimi i adresuar Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri të Asamblesë së Kosovës.

<sup>153</sup> Përfaqësuesit e Agjencisë së Mirëbesimit kanë deklaruar gjatë intervistave të bëra nga OSBE-ja në vjeshtë të vitit 2007, se nëse para privatizimit ose likuidimit përcaktohet se një ndërmarrje ose asetet e saj janë privatisht të poseduara, Agjencia e Mirëbesimit do të ia kthejë pronën pronarit ligjor.

<sup>154</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 52. Pala tjetër zakonisht duhet të informohet lidhur me kërkesën dhe duhet t'i jepet mundësi asaj që të paraqesë kundër-argument. Kjo nuk është rasti me kërkesat për vendime në gjykatat tjera, shih Ligji mbi Procedurën Kontestimore neni 277.



- Padiësi duhet të sigurojë dëshmi të besueshme të cilat tregojnë se do t'i ndodh një dëmtim i menjëhershëm dhe i pakthyeshem padiësit, nëse nuk sigurohet ndonjë masë e përkohshme dhe
- Kërkesa për masë të përkohshme duhet të dorëzohet së bashku me një padi "paraprake" ose një padi pasuese (në këto raste zakonisht për rikthim të pronës) e cila është dorëzuar më herët.

Vlen të përmendet, që Dhoma e Veçantë ka lëshuar kërkesa për vendime (duke ia mundësuar kështu padiësve që të parashtrojnë padi për rikthim të pronës së tyre) me argumentin që shitja e pronës palës së tretë do ta lejonte padiësin pa mundësi për të rikthyer pronën dhe se kompensimi financiar siç parashihet në Rregulloren 2005/18 me gjasë do të ishte i pakënaqshëm.<sup>155</sup>

Sistemi në të cilin pronarët mund të paraqesin padi vetëm para se Agjencia e Mirëbesim t'i ketë shitur pronat e tyre dhe duhet të kërkojë vendim nëse shitja është e menjëhershme, nuk është gjithmonë e qartë për palët apo avokatët e tyre. Në disa raste, padiësit kërkuar anulimin e tenderit të shitjes dhe rikthimin e pronës së tyre. Dhoma Speciale sqaroi që kjo nuk ishte e mundur me ligj dhe pasi që padiësi nuk i kishte kërkuar vendim para tenderit dhe shitjes, padiësi mund të kërkojë vetëm kompensim.<sup>156</sup>

#### **E. Dhoma e Veçantë urdhëroi që Konventa mbizotëron Ligjin Vendor**

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 nuk sqaron se cilat pretendime mbi pronësinë duhet apo mund të merren parasysh. Dhoma e Veçantë ka refuzuar kërkesën e Agjencisë së Mirëbesimit për të përcaktuar një rregull të përgjithshme lidhur me këtë çështje. Në vend të kësaj, Dhoma e Veçantë ka sjell aktvendime që kanë të bëjnë ekskluzivisht me fakte të posaçme të rasteve individuale. Ajo nuk ka kompetencë që të jap mendime këshilluese ose urdhra të përgjithshme (shih Kapitulli IV. B).

<sup>155</sup> Shembuj të praktikës gjyqësore të Dhomës së Veçantë lidhur me vendimet janë: vendimi i 14 shkurtit 2007 (*Muharrem Zenel Shabanaj dhe të tjerët kundër Rugova, Kooperativa Bujqësore dhe AKM-së*) SCC -7-0012; vendim i 20 shtatorit 2005 (*Ismajli kundër AKM-së dhe Hotel Turist Kosova*, SCC -5-177; vendim i 12 tetorit 2005 (*Fatmir Logja dhe të tjerët kundër AKM-së dhe Hotel Korzo NSh*) SCC -05-0453; vendim i 18 majit 2006 (*Grand Group Partnership JSC kundër AKM-së*), SCC -06-0176; vendim i 21 nëntorit 2006 (*Shaban Morina kundër AKM-së*), SCC -06-0415; vendim i 20 janarit 2006 (*Hotel Kosova Kristal kundër AKM-së*), SCC-05-0473.

<sup>156</sup> Në një rast (aktgjykimi i 30 nëntorit 2006, *Ballkanbellt kundër KTA*, SCC-04-188), dështimi për të fituar rikthimin e pronës për klientin e tij kishte bërë avokatin që të sfidonte mandatin e Kombeve të Bashkuara. Dhoma ishte përgjigjur që ky argument ishte i natyrës politike dhe si i tillë nuk mund të adresohet nga gjykata. Gjatë dëgjimit të 2 gushtit 2007 (në rastin *Mehmet Shiroka e të tjerët kundër AKM-së*, SCC -07-00030) Kryetari i Trupit Gjyqësor sqaroi që padiësi nuk kishte kërkuar vendim dhe se rregullorja e kishte ndaluar Dhomën që ta anulonte shitjen. Shih gjithashtu edhe çështjen *Yumco jsc kundër AKM-së* (SCC-05-0482). Në çështjen *Mehmet Shiroka dhe të tjerët kundër AKM-së* dhe gjatë seancës dëgjimore me 8 maj 2007 në çështjen *kompania private Doni kundër AKM-së* (SCC-06-0436), Dhoma e Veçantë e këshilloi fuqishëm padiësin që ta plotësojë padinë e tij dhe të kërkojë kompensim në vend të rikthimit. Në këtë rast Dhoma e Veçantë pranoi plotësimin verbal të padisë që Dhoma e Veçantë ja kishte sugjeruar padiësit dhe lejoi kompensimin (aktgjykimi i datës 16 maj 2007). Këta shembuj demonstronin se padiësit dhe avokatët e tyre shpesh nuk janë të njoftuar se ata mund të parashtrojnë padi pronësie vetëm para se ti ketë shitur Agjencia e Mirëbesimit pronat e tyre, dhe duhet të kërkojë masë të përkohshme nëse shitja është në pritje.

Në çështjen *Balkanbelt kundër. AKM* (SCC-04-0188), Dhoma e Veçantë kishte gjetur se në atë rast specifik, zbatimi i ligjeve mbi transferime rezultuan në diskriminim ndaj punonjësve shqiptarë. Kjo e bëri te pavlefshëm transferimin kështu që Balkanbelt nuk e kishte fituar ligjshmërisht pronën në fjalë dhe për këtë nuk kishte të drejtën për mbrojtje bazuar në Nenin 1 Protokollin 1 të Konventës.

Në çështjen *Yumco jsc kundër. AKM-së* (SCC - 05-0482) gjykata prapë, pas analizës së fakteve relevante të rastit arsyetoi se nuk ka pasur transferim valid të Yumco-Kosovë-s. Rrjedhimisht, Yumco jsc ka dështuar të dëshmojë pronësinë e vet dhe Agjencia e Mirëbesimit kishte autoritetin ekskluziv për të administruar dhe privatizuar Yumco-Kosovë-n.

Në rastet e sipërme, Dhoma e Veçantë kishte zbatuar nenet 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18. Megjithatë, në aktgjykimin e vet të 20 nëntorit 2007 në rastin *Alexander Hadzijevic dhe Vera Frtunic kundër AKM-së dhe NSh Hotelet e Trepçës Restorant Parajsa (Kompania Hoteliere Ibar)*, (SCC-06-0010), Dhoma e Veçantë, prapë bazuar në faktet konkrete të rastit specifik, vendosi që standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të mbizotëronin mbi rregullat e privatizimit. Dhoma e Veçantë konstatoi që pala paditëse, e jo i padituri – NSh, ishin pronarët legjitim të pronës. Dhoma e Veçantë konstatoi që nenet 5.3 dhe 5.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/18 nuk përputheshin me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës, sepse ato nuk themelojnë organe të autorizuara të kryejnë privatizimin dhe për të përcaktuar ekzistimin e interesit publik. Përveç kësaj, ligji nuk e definon interesin publik dhe përjashton kompensimin e drejtë. Për më shumë, Gjykata konstatoi që ndalimi i shfuqizimit të transaksioneve të kryera nga Agjencia e Mirëbesimit nuk është në pajtim me nenin 6.1 të Konventës. Me fjalët e Dhomës së Veçantë: “[Agjencia e Mirëbesimit] nuk siguron garancitë e kërkuara me nenin 6 të Konventës Evropiane. Kështu, vendimet e saj i duhen nënshtruar një shqyrtimi të plotë gjyqësor.” Agjencia e Mirëbesimit parashtrroi një kërkesë për rishqyrtim lidhur me këtë rast me 18 dhjetor 2007. Rasti ende është i pakryer.

## VI. KORNIZA LIGJORE MBI DHOMËN E VEÇANTË

Pjesët kryesore të legjislacionit që rregullon Dhomën e Veçantë janë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13<sup>157</sup> dhe Urdhëresa Administrative nr. 2006/17.<sup>158</sup> Sipas këtyre rregullave, Dhoma e Veçantë ka pesë gjyqtarë: tre prej të cilëve janë ndërkombëtarë ndërsa dy janë banorë të Kosovës.<sup>159</sup> Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron të gjithë gjykatësit pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Supreme të

<sup>157</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13 Mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, 13 qershor 2002. Me 5 shkurt 2008, Përfaqësuesi i Veçantë i Sekretarit të Përgjithshëm miratoi një Rregullore të re të UNMIK-ut mbi Dhomën e Veçantë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/4) e cila do të hyjë në fuqi me 31 maj 2008 dhe e cila do të ndryshojë Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13.

<sup>158</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17 e 6 dhjetorit 2006, “Për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2003/13, zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”.

<sup>159</sup> Sipas Rregullores së UNMIK-ut të dekretuar së fundi Nr. 2008/4 (e cila hyn në fuqi me 31 maj 2008), Dhoma e Veçantë do të jetë e përbërë prej deri në 20 gjyqtarë, 13 prej të cilëve do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë dhe shtatë prej tyre do të jenë banorë të Kosovës (neni 3).

Kosovës<sup>160</sup> dhe e cakton njërin nga gjyqtarët ndërkombëtarë si Kryetar të Trupit Gjykuës të Dhomës së Veçantë.<sup>161</sup>

Për informata faktike mbi Dhomën e Veçantë, shih Shtojcën I.

#### **A. Juridiksioni i Dhomës së Veçantë**

Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluziv për të gjitha paditë kundër Agjencisë së Mirëbesimit.<sup>162</sup> Kështu, secila palë që dëshiron ta padisë Agjencinë e Mirëbesimit duhet ta bëjë këtë tek Dhoma e Veçantë. Gjykatat tjera duhet t'i shpallin paditë e tilla si të papranueshme.<sup>163</sup>

Dhoma e Veçantë ka Juridiksion Primar për:<sup>164</sup>

- kundërshtimet e aktvendimeve apo veprimet tjera të Agjencisë së Mirëbesimit<sup>165</sup>
- paditë kundër Agjencisë së Mirëbesimit për humbje financiare që kanë rezultuar nga vendimet e Agjencisë së Mirëbesimit në cilësinë e saj si administratore e një NSh-je
- paditë kundër NSh-ve nën administrimin e Agjencisë së Mirëbesimit, nëse paditë e tilla janë ngritur gjatë ose para administrimit nga Agjencia e Mirëbesimit, dhe
- paditë tjera të përshkuara në nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13.<sup>166</sup>

Kështu, paditë e kreditorëve dhe pronarëve në likuidimin e një NSh-je duhen paraqitur tek Dhoma e Veçantë. Me kërkesë të Agjencisë së Mirëbesimit, Dhoma e Veçantë mund të tërheqë veprimet në pritje pranë gjykatave tjera në të cilat është palë ndonjë NSh e administruar nga Agjencia e Mirëbesimit.<sup>167</sup>

Dhoma e Veçantë gjithashtu ka kompetenca të merr:

---

<sup>160</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 3.1.

<sup>161</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 3.2.

<sup>162</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 30.1.

<sup>163</sup> Dhoma e Veçantë pranon padinë kundër Agjencisë së Mirëbesimit vetëm nëse 60 ditë para dorëzimit të padisë, i është dhënë njoftimi paraprak Kryesuesit të Bordit të Agjencisë së mirëbesimit, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 30.2.

<sup>164</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 4.1.

<sup>165</sup> Megjithatë, asnjë palë nuk duhet t'i akordohen mjete juridike në dobi të saj nëse kjo gjë kërkon anulimin e një transaksioni ose shfuqizimin e një kontrate të lidhur nga Agjencia, në pajtim me kompetencat e saj, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 (2005/18). Kështu, nëse Agjencia e Mirëbesimit ka shitur pasuritë e palës së tretë në privatizim apo likuidim, nuk mund të bëhet kthimi i pronës. Shih Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 10.5.

<sup>166</sup> Neni 4.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4 do të përforcoj juridiksionin e Dhomës së Veçantë, edhe pse e shumta e kompetencave do të mbesin të pandryshuara.

<sup>167</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 4.5.

- vendime për të përcjellë apo tërhequr paditë që janë nën juridiksionin primar të Dhomës së Veçantë tek apo prej gjykatave të rregullta<sup>168</sup>
- vendime në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me listat e punëtorëve të ligjshëm<sup>169</sup>
- aktgjykimet, aktvendimet dhe urdhrat në procedurat e riorganizimit dhe likuidimit
- aktgjykimet në ankesë nga aktgjykimet e gjykatave të rregullta në rastet që janë nën juridiksionin e Dhomës së Veçantë.<sup>170</sup>

Sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4, Dhoma e Veçantë do të ketë pesë kolegje për gjykim, secili prej të cilëve do të përbëhet prej dy gjyqtarëve ndërkombëtar dhe një gjyqtari banor i Kosovës, të specializuar në fushë të posaçme të ligjit.<sup>171</sup>

## B. Gjyqtari Raportues dhe Procedurat Normale

Kur padia parashtrohet tek Dhoma e Veçantë, Kryetari i Trupit Gjykses emëron një Gjyqtar Raportues<sup>172</sup> për të vlerësuar nëse padia plotëson të gjitha kriteret<sup>173</sup> (p.sh. nëse padia dhe dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe apo serbe, si dhe gjithmonë me versionin në anglisht<sup>174</sup>) dhe që është e pranueshme, si dhe nëse mund të mund të lejohet ndonjë lehtësi lidhur me padinë.<sup>175</sup> Nëse padia nuk i plotëson të gjitha kërkesat, Gjyqtari Raportues (varësisht nga lloji i kërkesave të paplotësuara) mund t'ia përcjellë padinë Dhomës së Veçantë me rekomandimin që padia të shpallet e papranueshme<sup>176</sup> ose të refuzohet, ose t'i lëshojë një urdhër paditësit me udhëzime specifike për plotësimin apo korrigjimin e padisë brenda një periudhe të caktuar kohore.<sup>177</sup> Nëse Gjyqtari Raportues konstaton që padia plotëson gjitha kërkesat, ai do t'ia dërgojë padinë të paditurit.<sup>178</sup>

<sup>168</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, nenet 4.2 dhe 4.5. Dhoma e Veçantë do të tërheqë lëndën nga gjykata tjetër nëse pala e rastit kërkon një gjë të tillë. Urdhëresa Administrative 2006/17, Neni 18.3. Shih gjithashtu, nenin 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4.

<sup>169</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 64.4. Shih gjithashtu, nenin 4.1 (e) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4.

<sup>170</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 55. Gjithashtu, neni 4.1 (i) i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4.

<sup>171</sup> Këto fusha të ligjit janë: çështjet që kanë të bëjnë me privatizimet; çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e punonjësve; paditë e përgjithshme mbi pronësi dhe ato të kreditorëve; çështjet që kanë të bëjnë me likuidimin e ndërmarrjeve; si dhe riorganizimin ose ristrukturimin e ndërmarrjeve.

<sup>172</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 14.

<sup>173</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, nenet 25.1(a) dhe 25.2. Shih gjithashtu Ligjin mbi Procedurën Kontestimore, nenet 109 dhe 281 dhe nenin 109. Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 25.2(f) i referohet neneve 22 dhe 24.

<sup>174</sup> Kërkesa nga Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 22.7, që nëse dokumentet paraqiten në gjuhën shqipe apo serbe, duhet siguruar përkthimi në anglisht, derisa e kundërta nuk është e nevojshme, favorizon ato palë gjuha e punës së të cilave është anglishtja.

<sup>175</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 25.1(b).

<sup>176</sup> Dhoma e Veçantë ka vendosur (aktgjykimi i 26 tetorit 2005, *Wood Industries LLC kundër AKM-së*, SCC-04-0130) që edhe pse Gjyqtari Raportues ka deklaruar kërkesëpadinë të pranueshme, kërkesëpadia mund të deklarohet si e papranueshme në një fazë të mëvonshme të procedurës. Vendimi i Gjyqtarit Raportues nuk është vendim përfundimtar i çështjes, pasi bazohet vetëm tek informatat e paraqitura nga paditësi.

<sup>177</sup> Dhoma e Veçantë ka zbatuar në mënyrë strikte periudhën kohore të dhënë nga Gjyqtari Raportues për të korrigjuar kërkesëpadinë kur ajo është deklaruar (urdhri i 17 nëntorit 2004, *Aqif Laqi kundër*

I padituri mund të paraqesë mbrojtjen brenda një muaji prej dërgimit të padisë. Pas kësaj, Gjyqtari Raportues përcakton periudhat brenda të cilave paditësi mund të paraqesë përgjigjen dhe pala e paditur kundërpërgjigjen. Gjyqtari Raportues pastaj i raporton Dhomës në përbërje të plotë se cilat fakte janë të kontestueshme dhe cilës palë i takon barra e të provuarit.<sup>179</sup> Në bazë të këtyre, mbahen dëgjimet për mbledhjen e dëshmimeve me një apo dy gjyqtarë dhe dëgjime me kolegë të plotë. Urdhëresa Administrative nr. 2006/17 përmban rregulla të elaboruara për këto dëgjime.<sup>180</sup>

Rregullat procedurale të aplikueshme në lidhje me procedurat e listave të punëtorëve dhe lëndëve të likuidimit dallojnë nga rregullat e përshkruara më lart. Në rastin e listave të punëtorëve, Agjencia e Mirëbesimit (e cila vepron si palë përgjegjëse në këto lëndë) mund të paraqesë vërejtjet e veta mbi ankesat. Nuk duhen paraqitur tjera deklarime me shkrim, por Dhoma e Veçantë mund të urdhërojë dëgjim.<sup>181</sup> Në rastin e likuidimit, Komisioni i Shqyrtimit të Likuidimit mund të paraqesë vërejtjet e veta në kundërshtimin e kreditorit.<sup>182</sup>

Në procedurat pranë Dhomës së Veçantë, palët paditëse dhe të paditurit duhet të “përfaqësohen nga një anëtar i Odës së Avokatëve në Kosovë ose në Serbi”<sup>183</sup> por personat fizikë mund të përfaqësojnë vetveten.<sup>184</sup> Kryetari i Trupit Gjykoës mund të lejojë palën të përfaqësohet nga një odë “e huaj” e avokatëve.<sup>185</sup> Avokati që vepron në emër të një pale duhet të paraqesë autorizimin. Nëse paditësi dështon të bëjë këtë, padia do të refuzohet si e papranueshme.<sup>186</sup>

### C. Referimi i Padive tek Gjykatat e Rregullta

Dhoma e Veçantë mund t’i referojë paditë mbi të cilat ka juridiksion primar tek gjykatat e rregullta, nëse gjitha palët e rastit pajtohen me këtë, ose nëse Dhoma e Veçantë është e bindur që gjykata tek e cila është referuar padia do të marrë vendim të paanshëm.<sup>187</sup> Kriteret që Dhoma e Veçantë duhet t’i përdorë për vendimin e saj janë: (i) natyra e palëve, (ii) shumica në kontest, si dhe (iii) rrethanat tjera.<sup>188</sup> Megjithatë,

---

*NPMK “Kosova Plastika” dhe AKM-së, SCC-04-0154*) e papranueshme, sepse paditësi nuk e kishte korrigjuar kërkesëpadinë e tij para afatit.

<sup>178</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, nenet 25.3 - 25.6.

<sup>179</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 31.

<sup>180</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, nenet 32 - 44. Dosjet e rasteve që janë hulumtuar në përgatitjen e këtij raporti në përgjithësi kanë treguar pajtueshmëri me këto procedura.

<sup>181</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 64.

<sup>182</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, nenet 65 dhe 66.

<sup>183</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 21.1.

<sup>184</sup> Kryetari i Trupit Gjykoës mund të urdhërojë që një palë të përfaqësohet nga një anëtar i odës së avokatëve në Kosovë apo Serbi nëse kjo kërkohet për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të atij personi. Kryetari i Trupit Gjykoës bën këtë vetëm nëse është i bindur që pala është në gjendje të paguajë përfaqësimin gjyqësor apo nëse mund të sigurohet ndihma juridike.

<sup>185</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 21.3.

Në disa raste të shqyrtuara për këtë raport, Dhoma e Veçantë ka lejuar avokatë të huaj. Për shembull, në vendimin e 9 shtatorit 2004 (*Wood Industries LLC kundër AKM-së, SCC-04-0130*) Kryetari i Trupit Gjykoës ka lejuar përfaqësimin e kërkuarit me një anëtar të odës së avokatëve në Shtetet e Bashkuara. E njëjta gjë u bë edhe në rastin *Shaban Morina kundër AKM-së (SCC-06-0415)* në lidhje me një anëtar të Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit.

<sup>186</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 21.4-6.

<sup>187</sup> Rregulloret e UNMIK-ut Nr. 2002/13 dhe Nr. 2008/4, neni 4.2.

<sup>188</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 4.2 dhe Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 17.

Dhoma e Veçantë nuk mund t'i referojë rastet të cilat nuk i përkasin kategorisë së “padive” mbi të cilat kjo Dhomë ka “juridiksion primar”, siç janë rastet e listave të punëtorëve dhe rastet e likuidimeve.<sup>189</sup> Urdhri i referimit duhet t'i theksojë arsyet për vendim dhe nëse ankesa duhet kërkuar tek Dhoma e Veçantë apo tek ndonjë gjykatë tjetër.<sup>190</sup>

#### **D. Kolegjet me Tre Gjyqtarë**

Kryetari i Trupit Gjykues ka kompetencë të caktimit të padive tek kolegjet me tre gjyqtarë. Kolegjet e tilla përbëhen nga një gjyqtar ndërkombëtar, një gjyqtar vendor dhe kryetari i trupit gjykues apo i emëruari i tij. Dhoma e plotë e Veçantë do të shqyrtojë vendimet e këtyre kolegjeve (i) nëse kolegji nuk mund të arrijë pajtueshmërinë, (ii) me kërkesë të një gjyqtari që nuk është pjesë e kolegjit, apo (iii) me kërkesë të një pale në procedurë.<sup>191</sup>

#### **E. Një shkallë, Ankesë e Kufizuar**

Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13, aktgjykimet e Dhomës së Veçantë janë përfundimtare dhe të detyrueshme.<sup>192</sup> Kjo do të thotë që nuk është e mundur ankesa ndaj vendimeve të Dhomës së Veçantë, si dhe që paditë brenda juridiksionit të Dhomës së Veçantë (p.sh. paditë kundër Agjencisë së Mirëbesimit) do të dëgjohen

---

<sup>189</sup> Dhoma e Veçantë mund t'i referojë paditë, derisa në rastet e listave të punëtorëve punëtorët parashtrajnë ankesa, ndërsa në rastet e likuidimit pala e dëmtuar zakonisht parashtron kundërshtim. Një gjyqtar në Dhomën e Veçantë ka konfirmuar që Dhoma e Veçantë shpesh i referon kërkesat e kreditorëve, kërkesat e punëtorëve (për rroga të papaguara, etj., por jo ankesa për listën e punëtorëve) dhe kërkesat e zakonshme pronësore (përveç çështjeve në lidhje me shpronësimin). Megjithatë, Dhoma e Veçantë nuk i referon kërkesat e ndjeshme të cilat kanë të bëjnë me shuma të mëdha parash apo shumë punëtorë, si dhe kërkesat pronësore ku mund të dalin probleme të ligjit ndërkombëtar dhe ndjeshmërisë politike (këto raste zakonisht lidhen me shpronësimet e viteve 1940-60). Kjo duket të jetë në pajtim me kriteret e lartpërmendura.

Sipas një deklaratë me shkrim të Dhomës së Veçantë për OSBE-në, qëllimi fillestar i referimit të rasteve ka qenë luftimi i mungesës së përhershme të resurseve njerëzore e materiale. Megjithatë, me kohë janë gjetur edhe qëllime tjera shtesë:

- Me referimin e rasteve, Dhoma iu mundëson gjykatave të rregullta të merren me raste me të cilat përndryshe nuk do të merreshin
- Duke e rezervuar të drejtën e ankesës, Dhoma e Veçantë mund të monitorojë dhe korrigjojë gjykatat e rregullta, si dhe të sigurojë jurisprudencë uniforme në çështjet që janë në juridiksionin e saj,
- Gjykatat e rregullta kanë qasje më të mirë ndaj provave në lidhje me rastet e referuara (p.sh. shënime të kadastrale, dokumentet e punësimit, inspektimet në terren, etj.) duke zvogëluar kohëzgjatjen e procedurave dhe duke përmirësuar efikasitetin e drejtësisë, si dhe
- Zvogëlohen shpenzimet (tarifat e gjykatës, tarifat e avokatëve, shpenzimet e përkthimit) e palëve.

<sup>190</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 17.2. Sipas gjyqtarëve të intervistuar, ankesa ndaj Dhomës së Veçantë apo një gjykate tjetër gjithmonë ruhet. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/4, neni 4.3. thotë se aktgjykimi ose vendimi i gjykatës në të cilën është referuar rasti mund të shkojë me ankesë vetëm para kolegjit të Dhomës së Veçantë, përpos në rastet kur kolegji vendos ndryshe.

<sup>191</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, nenet 13.3 dhe 13.4. Vlen të ceket se, Rregullorja e ndryshuar e UNMIK-ut Nr. 2008/4, neni 8.2. thotë se kolegji mund ta delegojë rastin në procedurë tek gjyqtari i vetëm ndërkombëtar ose tek nën-kolegji i përbërë nga dy prej anëtarëve të vet, njëri prej të cilëve do të jetë gjyqtar ndërkombëtar. Aktgjykimet ose vendimet e gjyqtarit apo nën-kolegjit të tillë do të kërkohej të merren nga kolegji gjykues, përpos në rastet kur urdhri me të cilin delegohet rasti kërkon që kolegji gjykues të marr vendimin apo aktgjykimin.

<sup>192</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 9.7; shih edhe Urdhëresën Administrative Nr. 2006/17, neni 45.6.

vetëm në një shkallë.<sup>193</sup> Megjithatë, Dhoma e Veçantë ka juridiksion mbi ankesat e vendimeve të gjykatave tjera tek të cilat Dhoma e Veçantë i ka referuar rastet ose të cilat kanë vendosur mbi paditë që janë në juridiksionin primar të Dhomës së Veçantë.<sup>194</sup>

Vlen të ceket se, Rregullorja e re e UNMIK-ut Nr. 2008/4 e cila do të hyjë në fuqi me 31 maj 2008, krijon mundësinë e ankesës ndaj aktgjykimeve ose vendimeve të kolegjit gjykues të Dhomës së Veçantë. Palët mund të parashtrajnë ankesë për rishqyrtim të vendimeve të tilla tek kolegji për ankesa brenda 30 ditëve pas pranimit të tyre.<sup>195</sup>

## F. Rishqyrtimet dhe Ankesat

Dhoma e Veçantë vetë ka pranuar mundësinë e kufizuar të ankesës (dhe mungesën e personelit dhe vonesat) si problem, dhe pas disa masave Dhoma e Veçantë kryen procedura që kanë më shumë afërsi me procedurën e ankesave:

- **Rastet e Listave të Punonjësve**

Deri në vitin 2006, Agjencia e Mirëbesimit nuk i ka shqyrtuar listat e punonjësve dhe punonjësit nuk kanë mundur që të parashtrajnë ankesa drejtpërdrejt në Dhomën e Veçantë. Mirëpo, qysh prej ndryshimit të ligjit,<sup>196</sup> Agjencia e Mirëbesimit duhet të publikojë dhe korrigjojë këto lista, të cilat pastaj i nënshtrohen shqyrtimit në shkallë të dytë nga Dhoma e Veçantë.

- **Komisioni i Shqyrtimit të Likuidimit**

Komisioni i shqyrtimit të likuidimit, i krijuar së voni,<sup>197</sup> shërben si organ shqyrtues në shkallë të parë i vendimeve të Komisioneve të Likuidimit. Vendimet e Komisionit Shqyrtues i nënshtrohen shqyrtimit në shkallë të dytë nga Dhoma e Veçantë.

- **Më shumë Raste të caktuara tek Kolegjet me Tre Gjyqtarë**

---

<sup>193</sup> Sipas një personi të përfshirë në hartimin e rregulloreve të hershme për themelimin e Dhomës së Veçantë, draftet në fillim kishin dispozita për Dhomën e Veçantë me dy shkallë, por pengesat financiare rezultuan në heqjen e dhomës së ankesave.

<sup>194</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 4.3 dhe Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 55. Ankesa duhet të parashtrohet tek Dhoma e Veçantë brenda dy muajsh prej dërgesës së vendimit tek palët, derisa afati për ankesë në procedurat tjera gjyqësore të Kosovës është 15 ditë pas pranimit të kopjes së aktgjykimit nga palët. Afati për shqyrtim nga Gjykata Supreme është 30 ditë. Shih Ligjin mbi Procedurën Kontestimore, nenet 348 dhe 382. Prej rasteve të shqyrtuara, duket që Dhoma e Veçantë e zbaton në mënyrë strikte rregullin që gjykimet e saj janë përfundimtare. Për shembull, në një gjykim të datës 7 nëntor 2007 (*Grand Group Partnership JSC kundër AKM-së*, SCC-06-0176), paditësi i kërkoi Dhomës së Veçantë të shqyrtojë vendimin e saj në lidhje me shpenzimet e procedurave. Dhoma e Veçantë konsideroi se paditësi kishte provuar të bëjë një dallim mes ankesës bazuar në thelbin e çështjes dhe ankesës për shpenzime, por që ligji nuk bën një dallim të tillë. Për më shumë, paditësi nuk kishte kërkuar për korrigjim të gjykimit apo shqyrtim të ndonjë lëshimi. (Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 46 parashikon korrigjimin e gabimeve administrative të bëra gjatë llogaritjes. Neni 47 parashikon që pala mund të aplikojë për plotësim të gjykimit nëse Dhoma nuk merr vendimin e caktuar mbi një pjesë të padisë apo mbi shpenzimet). Dhoma e Veçantë deklaroi këtë kërkesë si të papranueshme.

<sup>195</sup> Kolegji për ankesa do të përbëhet prej dy gjyqtarëve ndërkombëtar dhe një gjyqtari - banor i Kosovës dhe nga Kryetari i Dhomës së Veçantë. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/4, nenet 3.3, 4.4 dhe 9.5.

<sup>196</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 64.

<sup>197</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 9.

Aktualisht, Kryetari i Trupit Gjykses cakton kolegje me tre gjyqtarë<sup>198</sup> për shumicën e rasteve që nuk i referon tek gjykatat e rregullta. Edhe pse Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13 nuk parasheh mundësinë e ankesës me kërkesë të një gjyqtari apo pale, Dhoma e plotë e Veçantë do ta rishqyrtojë vendimin e kolegjit prej tre anëtarëve.<sup>199</sup> Kjo mund të konsiderohet si ankesë joformale.<sup>200</sup>

- **Më shumë Raste të caktuara tek Gjykatat e Rregullta**

Aktualisht, Dhoma e Veçantë i referon shumicën e padive tek gjykatat e rregullta.<sup>201</sup> Në vendimet e saj për referim, Dhoma mban të drejtën e ankesës, tek një gjykatë tjetër e rregullt apo tek vetë Dhoma.

## **G. Rregullat Tjera Procedurale**

Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që nuk mbulojnë më së miri kryesisht me rregullat procedurale të Urdhëresës Administrative nr. 2006/17, Dhoma e Veçantë mund të zbatojë Ligjin mbi Procedurën Kontestimore i zbatueshëm në Kosovë dhe ligjin në fuqi mbi kompetencat e Gjykatës Supreme në Kosovë.<sup>202</sup> Dhoma e Veçantë mund të lëshojë edhe vendime tjera procedurale,<sup>203</sup> edhe pse nuk e ka bërë këtë ndonjëherë më parë.

## **VII. PROBLEMET LEGJISLATIVE ME KORNIZËN LIGJORE MBI DHOMËN E VEÇANTË**

### **A. Ankesa e Kufizuar dhe Përputhshmëria me Standardet për të Drejtat e Njeriut**

Siç diskutohet më lart, në shumë raste të Dhomës së Veçantë sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 nuk ka të drejtë ankese. Neni 6.1 i Konventës<sup>204</sup> nuk krijon

---

<sup>198</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 13.3.

<sup>199</sup> Sipas një gjyqtari të intervistuar, shqyrtimi është kërkuar në rreth dhjetë deri në njëzetë përqind të vendimeve të kolegjeve me tre gjyqtarë.

<sup>200</sup> Kjo kërkesë për rishqyrtim do të bëhet e panevojshme pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 e cila do të krijojë mundësinë e ankesës formale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/4, neni 9.5.

<sup>201</sup> Sipas një gjyqtari të intervistuar, Dhoma e Veçantë tani i referon rreth 80% të padive të paraqitura pranë gjykatave të rregullta.

<sup>202</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 67.3.

<sup>203</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 67.1.

<sup>204</sup> Neni 6 (e drejta për gjykim të drejtë), paragrafi 1, i Konventës, parashikon: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazën e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose të sigurimit kombëtar në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces, ose në shkallën që çmohet tepër e domosdoshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta natyra e publicitetit do të dëmtojte interesat e drejtësisë.”



në mënyrë të shprehur një të drejtë të ankesës në çështje civile.<sup>205</sup> Neni 2 i Protokollit të Konventës dhe neni 14.5 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike parashikojnë të drejtën e ankesës vetëm në çështjet penale.<sup>206</sup> Megjithatë, në shumicën e shteteve që janë anëtare të Konventës është e mundur të parashtrahet ankesë ndaj vendimeve të gjykatës civile për t’iu siguruar palëve mbrojtje juridike shtesë. Kështu, OSBE-ja mirëpret themelimin e së të drejtës në ankesë ndaj aktgjykimeve dhe vendimeve të Dhomës së Veçantë sipas Rregullores së re të UNMIK-ut Nr. 2008/4, e cila do të hyjë në fuqi me 31 maj 2008.<sup>207</sup>

## **B. Emërimi i Gjyqtarëve dhe Pavarësia e Dhomës së Veçantë**

Ekziston brenga nëse procedura e emërimit të gjyqtarëve të Dhomës së Veçantë është në përputhje me pavarësinë e domosdoshme të gjykatës. Sa i përket të drejtës së dëgjimit nga një gjykatë e pavarur, siç garantohet nga neni 6.1 i Konventës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka theksuar:

“Për të përcaktuar nëse një organ mund të konsiderohet i “pavarur”, duhet pasur kujdes, *mes tjerash*, për mënyrën e emërimit të anëtarëve të atij organi si dhe mandatin e tyre, për ekzistimin e garancive kundër presioneve të jashtme si dhe për çështjen nëse ky organ shfaq një pamje të pavarësisë.”<sup>208</sup>

Gjyqtarët në Dhomën e Veçantë emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili është gjithashtu përgjegjës edhe për çështjet ekzekutive dhe legjislative. Kjo procedurë nuk është e kufizuar për Dhomën e Veçantë, por e njëjta procedurë aplikohet edhe për caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve tjerë ndërkombëtarë në gjykatat e Kosovës.<sup>209</sup> Për më tepër, në pajtim me praktikën e Kombeve të Bashkuara, gjyqtarët e Dhomës së Veçantë emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara çdo herë për periudha gjashtë-mujore. Ndonëse Dhoma e Veçantë shfaq një pamje të pavarësisë, emërimi i gjyqtarëve për periudha gjashtë-mujore nga institucioni që është bashkë-përgjegjës për pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë ngrit brenga sipas neni 6.1 të Konventës.

---

<sup>205</sup> Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Delcourt kundër Belgjikës*, aplikacioni nr. 2689/65, 17 janar 1970, paragrafi. 25; *Hoffmann kundër Gjermanisë*, 11 tetor 2001, aplikacioni nr. 34045/96, aktgjykimi i 11 tetorit 2001, paragrafi. 65.

<sup>206</sup> Protokollin e shtatë (1984) i Konventës parashikon në nenin 2: “1. Secili që është i dënuar për veprë penale nga një gjykatë do të ketë të drejtë të shqyrtimit të dënimit të tij nga një gjykatë më e lartë. Ushtrimi i kësaj të drejtë, duke përfshirë bazat mbi të cilat mund të ushtrohet ajo, do të rregullohet me ligj”. Shih tekstin e ngjashëm të neni 14.5 të Paktit Ndërkombëtarë mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

<sup>207</sup> Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2008/4, neni 3.3, 4.4 dhe 9.5.

<sup>208</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Langborger kundër Suedisë*, 22 qershor 1989 aplikacioni nr. 11179/84, aktgjykimi i, paragrafi. 32. Shih edhe *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuara*, 28 qershorit 1984, aplikacioni nr. 7819/77 dhe 7878/77, aktgjykimi i, paragrafi. 79 (rast penal).

<sup>209</sup> OSBE-ja më parë ka shprehur shqetësimet se procedura për caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, në veçanti atyre ndërkombëtarë, nuk është në përputhje me parimin e pavarësisë juridike. Shih Raportin e OSBE-së, *Shqyrtim i Sistemit të Drejtësisë Penale, shtator 2001 - shkurt 2002*, faqet 27-29.

Veç kësaj, sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18, Kryesuesi i Bordit të Agjencisë së Mirëbesimit është gjithashtu edhe Zëvendës Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm brenda UNMIK-ut. Andaj, si gjyqësori ashtu edhe Agjencia e Mirëbesimit i raportojnë individit të njëjtë - Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (i cili gjithashtu është ligjvënësi). Kjo do të mund të jap kontekst për paraqitje të mundshme të parregullsive në qoftë se Agjencia e Mirëbesimit informon UNMIK-un lidhur me shqetësime që kanë të bëjnë me vendimet e aktgjykimet marra nga Dhoma e Veçantë.

### **C. Funksionet e Shumëfishta dhe Paanësia e Gjyqtarëve**

Një brengë tjetër lidhur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2002/13, është nëse gjyqtarët e njëjtë që kryejnë funksione të procedurës përgatitore, ose që veprojnë si gjyqtarë gjykues dhe për ankesa, i plotësojnë standardet e gjykimit të drejtë.

Gjyqtarët e Dhomës së Veçantë shpesh kryejnë disa funksione në lidhje me rastin e njëjtë: së pari si Gjyqtar Raportues (i cili shqyrton padinë kur dorëzohet në fillim), më vonë si anëtar i Dhomës së Veçantë (i cili diskuton padinë kur i referohet lënda një gjykatë të rregullt). Për më shumë, i njëjti gjyqtar i cili referon rastin tek një gjykatë e rregullt apo i cili është anëtar i një kolegji me tre gjyqtarë mund të jetë pjesë e dëgjimit të ankesës ose rishqyrtimit në të njëjtin rast.

Neni 6.1 i Konventës parashikon dëgjimin nga një gjykatë e paanshme. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur paanshmëria e një gjykatë vlerësohet për qëllimin e nenit 6.1, jo vetëm bindja dhe sjellja personale e një gjyqtari të caktuar në një rast të caktuar janë me rëndësi. Përveç kësaj, pyetja nëse ka garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çfarëdo dyshimi legjitim në lidhje me këtë, është me rëndësi. Në këtë kuptim, vetë fakti që një gjyqtar ka marrë tanimë vendime para vetë gjykimit në vetvete nuk mund të konsiderohet si arsyetim i shqetësimeve për paanësinë e tij. Ajo që është e rëndësishme është fushëveprimi dhe natyra e vendimeve.<sup>210</sup>

Pjesëmarrja në gjykim nga një gjykatës (i cili para gjykimit ka bërë regjistrimin e deklaratave të një pale pa ekzaminuar meritat e rastit, si dhe ka ndërmarrë disa masa para gjykimit, të cilat përbëhen nga grumbullimi i informatave të thjeshta), ishte, për mendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e një karakteri përgatitor për kompletimin e lëndës para dëgjimit. Gjykata Evropiane konstatoi që frika sa i përket paanësisë së gjyqtarëve nuk është arsyetuar në mënyrë objektive dhe nuk ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.<sup>211</sup>

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjithashtu ka deklaruar që përfshirja paraprake e një gjyqtari në rast para gjykimit nuk shkel nenin 6 të Konventës, kur vendimi i gjyqtarit i nënshtrohet kontrollimit nga trupi gjykues që ka juridiksion të

<sup>210</sup> Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Hauschildt kundër Danimarkës*, Nr. 10486/83, aktgjykimi i 24 majit 1989, paragrafët 49-53; *Nortier kundër Holandës*, 24 gusht 1993, 13924/88, paragrafi. 33; *Saraiva de Carvalho kundër Portugalisë*, 22 prill 1994, aplikacioni nr. 15651/89, paragrafi. 35; *Castillo Algar kundër Spanjës*, 28 tetor 1998, aplikacioni nr. 28194/95, paragrafët. 46-51.

<sup>211</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Fey kundër Austrisë*, 24 shkurt 1993, Nr. 14396/88, paragrafi. 30-36.

plotë dhe siguron garancitë e nenit 6 të Konventës.<sup>212</sup> Megjithatë, kur gjyqtarët gjykues ftohen të përcaktojnë nëse vetë zbatimi i ligjit nga ana e tyre ka qenë adekuat atëherë ka shqetësim lidhur me paanshmërinë e gjyqtarëve.<sup>213</sup>

Kështu, duke supozuar që një gjyqtar i Dhomës së Veçantë nuk merr parasysh meritat e rastit kur vepron si Gjyqtar Raportues, ose kur e referon rastin tek një gjykatë e rregullt, ky kombinim i funksioneve duket të mos paraqesë shkelje të nenit 6.1 të Konventës, sipas interpretimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, shqyrtimi i një aktgjykimi të kolegjit me tre gjyqtarë nuk mund të konsiderohet si ankesë e vlefshme, sepse të njëjtit gjyqtarë që kanë marrë pjesë në kolegjin me tre gjyqtarë janë gjithashtu pjesë e Dhomës së plotë.<sup>214</sup> Duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, OSBE-ja mirëpret krijimin e shkallës së parë të ndarë dhe kolegjet për ankesa ku gjyqtarët e përfshirë në fazën e shkallës së parë nuk marrin pjesë në procedurën e ankesës në atë rast. OSBE-ja rekomandon që të nxirret një Urdhëresë e re Administrative për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4 e cila do të ofronte mbrojtje kundër krijimit të funksioneve të shumëfishta të gjyqtarëve në Dhomën e Veçantë, gjë që do të mund të përbënte shqetësime lidhur me konflikt të interesave.

## VIII. SHQETËSIMET E IDENTIFIKUARA NË SHQYRTIMIN GJYQËSOR TË AKTGJYKIMEVE TË DHOMËS SË VEÇANTË

OSBE-ja ka monitoruar afërsisht 56 raste në Dhomën e Veçantë që nga gushti 2006. Si pjesë e monitorimit të saj, OSBE-ja ka ndjekur seancat gjyqësore dhe ka shqyrtuar dosjet dhe aktgjykimet e gjykatës. Kjo pjesë përmbledh shqetësimet që janë vërejtur nga OSBE-ja në veprimtarinë e saj monitoruese.

### A. Publikimi i Vendimeve

OSBE-ja është e brengosur që Dhoma e Veçantë nuk publikon e as nuk shpërndan vendimet. Megjithatë, sipas Dhomës së Veçantë kjo ndodh sepse gjykatës i mungojnë resurset e nevojshme financiare dhe materiale, gjë që është jashtë kontrollit të saj.

<sup>212</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *De Haan kundër Holandës*, 26, gusht 1997, aplikacioni nr. 22839/93, , paragrafi. 47-51.

<sup>213</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *San Leonard Band Club kundër Maltës*, 29 korrik 2004, aplikacioni nr. 77562/01, , paragrafi. 61-66.

<sup>214</sup> Derisa shumica e gjykimeve në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut të cituara në këtë paragraf janë bërë në raste penale, e njëjta logjikë duket bindëse edhe në rastet civile. Për shembull në rastin *Aleksander Hadzijevic dhe Vera Frtunic kundër AKM-së dhe NSh-së Hotelet Trepça restoranti Parajsa* (SCA-07-0083), Agjencia e Mirëbesimit parashtrroi kërkesë për rishqyrtim, me 15 janar 2008, kundër aktgjykimit të lëshuar nga kolegji prej tre gjyqtarëve me 18 dhjetor 2007. Andaj, pasi që përgjithësisht janë vetëm pesë gjyqtarë që punojnë në Dhomën e Veçantë, tre nga gjyqtarët që kanë gjykuar rastin do të marrin pjesë në kolegjin e plotë prej pesë gjyqtarëve - përkundër kërkesës së Agjencisë së Mirëbesimit për përjashtimin e tre gjyqtarëve. Sipas Dhomës së Veçantë, rishqyrtimi -- i cili nuk është ankesë -- nuk ngrit shqetësime lidhur me paanshmëri ose gjykim korrekt kur zbulohet fakti i cili sipas natyrës së vet mund të ketë ndikim vendimtar në rezultatin e kontestit në fjalë dhe i cili nuk ishte i njohur për gjykatën në kohën kur ishte marrë vendimi, dhe i cili nuk ka pasur mundësi të jetë me arsye i njohur për palët. *Shih* neni (rregullin 80) të Rregullat e Procedurës të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Rregullat e Gjykatës") *Shih* gjithashtu rregullin 46 nga Rregullat e Procedurës të Kolegjit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Kosovës, i shkurtit 2008.

Në praktikën e saj sipas nenit 6.1 të Konventës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pranon rëndësinë e publikimit të gjykimeve.<sup>215</sup> Vlen të përmendet, seancat dëgjimore të Dhomës së Veçantë janë të hapura për publikun dhe aktgjykimet e saj shpallen në mënyrë publike, duke i plotësuar kështu standardet formale të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës.<sup>216</sup> Megjithatë, kopjet e aktgjykimeve mund të gjenden vetëm në recepcion të Dhomës. Në këtë kohë, vendimet nuk janë të gatshme për publikun – ato nuk botohen në gazetë zyrtare, e as që nxjerrën në internet.

Vendimet publike mund t'i shërbejnë shumë funksioneve të vlefshme, siç është rritja e transparencës në gjyqësor dhe edukimi i avokatëve në interpretimin e ligjeve relevante. Për më shumë, palët që mendojnë të parashtrojnë një padi në Dhomën e Veçantë mund të përballen me probleme kur mundohen të shqyrtojnë gjykimet e Dhomës së Veçantë.<sup>217</sup> Rrjedhimisht, OSBE-ja beson që për shkak të rëndësisë së gjykimeve të Dhomës së Veçantë për zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës, ajo duhet të publikojë vendimet e saj rregullisht në një gazetë zyrtare (si dhe preferohet që ato të shpërndahen në letër dhe në internet).

## B. Gjykatat e Rregullta marrin Juridiksionin

OSBE-ja është e brengosur për faktin që gjykatat civile në Kosovë, disa herë, kanë dështuar të shqyrtojnë juridiksionin e tyre, sipas detyrës zyrtare, në rastet ku Dhoma e Veçantë ka juridiksion primar apo ekskluziv. Një gjë e tillë jo vetëm që shkel të drejtën vendore procedurale, por gjithashtu mund të shkel të drejtën për t'u dëgjuar para gjykatës, siç përcaktohet me ligj.<sup>218</sup>

---

<sup>215</sup> Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “ parimet që qeverisin mbajtjen e dëgjimeve publike [...] gjithashtu vlejné për nxjerrjen publike të aktgjykimeve [...] dhe kanë të njëjtin qëllim, d.m.th gjykimin e drejtë [...] në secilin rast forma e publicitetit që do t'i jepet ‘aktgjykimit’ sipas ligjit vendor të shtetit të paditur duhet të vlerësohet në kuptim të karakteristikave të Veçantë në fjalë dhe duke iu referuar objektit dhe qëllimit të nenit 6.1.” shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Werner kundër Austrisë*, 24 nëntor 1997, aplikacioni Nr. 21835/93, paragrafët 54 dhe 55; shih gjithashtu aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Pretto dhe të tjerët kundër Italisë, 8 dhjetori 1983, aplikacioni nr. 7984/77, paragrafi 26; *Axen kundër Gjermanisë*, 8 dhjetor 1983, aplikacioni Nr. 8273/78 paragrafi 31; *Shutter kundër Zvicrës*, 22 shkurt 1984, aplikacioni Nr. 8209/78, paragrafi 33; *Diennet kundër Francës*, 26 shtator 1995, aplikacioni nr. 18160/91, paragrafi 33; *Malhaus kundër Republikës Çeke*, 12 korrik 2001, aplikacioni nr. 33071/96, paragrafi 55.

<sup>216</sup> Në një rast (ku aktgjykimi i Gjykatës së Kasacionit në Itali nuk ishte shpallur publikisht), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksonte që duke marrë parasysh juridiksionin e kufizuar të Gjykatës së Kasacionit, që depozitimi i gjykimit në regjistrin e gjykatës, gjë që i ven në dispozicion tekstin e plotë të gjykimit të gjithëve, do të ishte e mjaftueshme për të plotësuar këtë kërkesë. (Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 8 dhjetor në *Pretto dhe tjerët kundër Italisë*, aplikacioni nr. 7984/77, paragrafi 27). Megjithatë, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut gjeti shkelje të nenit 6(1) të Konventës aty ku vendimet i ishin dërguar aplikuesit dhe nuk janë dhënë në dëgjimet publike. Gjykata konsideroi që nuk është shpallur publikisht aktgjykimi dhe që publiciteti nuk është siguruar me mjete tjera në mënyrë të mjaftueshme. (Aktgjykimi i datës 24 nëntor 1997 i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në *Werner kundër Austrisë*, aplikacioni nr. 21835/93, paragrafët 56-60).

<sup>217</sup> Mungesa e publicitetit të aktgjykimeve është problem i përgjithshëm në Kosovë, sepse shumë gjykata nuk i publikojnë aktgjykimet. Në të kaluarën, janë publikuar dy vëllime me aktgjykime të Gjykatës Supreme, por kjo duket të jetë përjashtimi i vetëm.

<sup>218</sup> Shih nenin 14(1) e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe nenin 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut.

Konventa garanton të drejtën për gjykim të drejtë para një “gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj”.<sup>219</sup> Gjatë interpretimit të kësaj të drejte, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut theksoi se gjykata duhet të ketë përbërje të duhur “në pajtim me ligjin” dhe vërejtë se shkeljet ndodhin kur gjykata nuk funksionon në pajtim me të drejtën e zbatueshme procedurale.<sup>220</sup>

Sipas procedurës së zbatueshme civile, [menjëherë pas pranimit të deklarimeve mbi fajësinë, gjykata, sipas detyrës zyrtare, do të vlerësojë nëse është kompetente që të gjykojë atë rast të veçantë [...].”<sup>221</sup> “Nëse gjatë seancave gjyqësore, gjykata konstaton se rasti nuk është as në juridiksion të gjykatës së rastit [...], por se ajo bie në juridiksionin e një organi tjetër vendor apo të huaj, ajo do ta deklarojë veten si jo-kompetente, do të anulojë veprimet e kryera deri në atë kohë gjatë seancave gjyqësore dhe do të hedh poshtë paditë.”<sup>222</sup> Pasi që gjykata të ketë shpallur veten si jo-kompetente, ajo do t’ia caktojë rastin gjykatës apo organit kompetent.<sup>223</sup> Siç është përshtetur më lart, Dhoma e Veçantë ka juridiksion primar në paditë kundër ndonjë NSh-je të administruar nga Agjencia e Mirëbesimit.<sup>224</sup>

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE-ja ka vëzhguar raste kur gjykatat e rregullta në mënyrë të gabuar kanë marrë përsipër juridiksion në lëndët brenda juridiksionit primar apo ekskluziv të Dhomës së Veçantë:

Gjykata Komunale e Prishtinës/Priština në mënyrë të gabuar ka marrë juridiksionin mbi një padi të parashtruar kundër NSh-së së administruar nga Agjencia e Mirëbesimit në ankesën ndaj shkarkimit të padrejtë nga puna dhe për shkak të mospagimit të pagave. Më 23 nëntor 2005, Gjykata Komunale ka shpërblyer ankuesit me tre milion euro në vendimin kundër NSh-së. Me kërkesë të prokurorit publik, Gjykata Supreme e Kosovës anuloi aktgjykimin dhe me 14 korrik 2006 e dërgoi rastin në Dhomën e Veçantë. Arsyeja kryesore për atë vendim ishte se Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion ndaj NSh-së.

Sa i përket çështjes nëse Dhoma duhet ta referojë këtë lëndë përsëri në Gjykatën Komunale apo duhet vetë ta dëgjojë atë, Dhoma e Veçantë theksoi:

“Gjykata Komunale vendosi në bazë njohurisë së pa-balancuar të fakteve. Veç kësaj, Gjykata Komunale çorientoi [Agjencinë e

<sup>219</sup> Neni 6(1), i Konventës.

<sup>220</sup> *Zand kundër Austrisë*, Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 7360/76, Raporti i Komisionit, 12 tetor 1978.

<sup>221</sup> “Vlerësimi i juridiksionit është bërë në bazë të numrit të akuzave dhe në bazë të fakteve të njohura për gjykatën.” Shih nenin 15 (1) dhe (2) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Jugosllavisë Nr. 4/77 dhe amendamentet e saja pasuese). Veç kësaj, gjatë të gjitha procedurave gjyqësore, gjykata duhet që në mënyrë sipas detyrës zyrtare të kushtojë vëmendje nëse zgjidhja e kontesteve qëndron brenda juridiksionit të gjykatës. Shih nenin 16(1) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas nenit 354(2)(3) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, fakti që një vendim është marrë në një rast i cili nuk ishte brenda juridiksionit të asaj gjykate është shkelje substanciale e procedurës dhe bazë për ankesë ndaj vendimit.

<sup>222</sup> Neni 16(2) i Ligjit për Procedurën Kontestimore. Sipas nenit 354(2)(3) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, fakti që një vendim është marrë në një rast i cili nuk ishte brenda juridiksionit të asaj gjykate është shkelje substanciale e procedurës dhe bazë për ankesë ndaj vendimit.

<sup>223</sup> Neni 21(1) i Ligjit për Procedurën Kontestimore.

<sup>224</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 30.1; Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/13, neni 4.

Mirëbesimit] duke e informuar atë, si përgjigje ndaj pyetjes specifike, se nuk ka lëndë të pazgjidhura kundër NSh-ve... kur në të vërtetë padia tanimë ishte parashtruar. ... Në këto rrethana, Dhoma ka përfunduar se e tërë lënda duhet të rigjykohet para kësaj Dhome.”<sup>225</sup>

Veç kësaj, rastet në vijim dëshmojnë shembuj tjerë të dështimit të gjykatave të rregullta për të vlerësuar në mënyrë të duhur juridiksionin e tyre dhe për t'i referuar rastet në Dhomën e Veçantë:

Në një kontest pronësor para Gjykatës Komonale të Prizrenit kundër një NSh-je nën administrimin e autoritetit të Agjencisë së Mirëbesimit, gjykata ka vendosur në shqyrtimin preliminar më 21 shkurt të vitit 2006 që të vazhdojë me këtë lëndë pa e vlerësuar juridiksionin e vet.<sup>226</sup> Gjykata caktoi seancën e parë gjyqësore më 7 mars të vitit 2006 dhe nxori aktgjykimin më 3 maj 2006 me të cilin gjykata aprovoi kërkesën, duke shpallur kontratën pronësore të pavlefshme, urdhëroi palën e paditur të ia kthej pronën paditësve.

Në një kontest nga marrëdhënia e punës para Gjykatës Komonale të Mitrovicës/Mitrovica kundër një Ndërmarrjeje Publike në administrimin e autoritetit të Agjencisë së Mirëbesimit, gjykata mbajti katër seanca gjyqësore<sup>227</sup> dhe më pas nxori aktgjykimin ndaj të cilit u parashtrua ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica më 22 shtator 2005.

Në rastet e lartpërmendura, gjykatat nuk vlerësuan si duhet kompetencat e tyre për të dëgjuar kontestin. Meqë të dyja paditë përfshinin kërkesa kundër ndërmarrjeve në administrim të autoritetit të Agjencisë së Mirëbesimit, gjykatat është dashur t'i hedhin poshtë paditë dhe t'i referojnë ato në Dhomën e Veçantë, e cila ka juridiksion primar apo ekskluziv. Duke dëgjuar lëndët që janë jashtë juridiksionit të tyre, gjykatat komunale shkelën ligjin vendor dhe me shumë mundësi edhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

### **C. Cilësia e Përfaqësimit Ligjor**

Avokatët duhet të përfaqësojnë klientët e tyre me zell dhe t'i ndjekin interesat e tyre në maksimumin e aftësive të tyre. Kodi i Etikës Profesionale (“Kodi i Etikës”), i cili rregullon edhe marrëdhëniet në mes të avokatit dhe klientit, thekson se “[a]vokati këshillon dhe mbron klientin e tij me kujdes dhe zell,”<sup>228</sup> dhe kërkon që “[a]vokati të ketë kujdes që t'i ofrojë palës së tij mbrojtjen e nevojshme sa më parë që është e mundur dhe me sa më pak shpenzime që është e mundur, si dhe të luftojë çdo

<sup>225</sup> Sipas hulumtimit të OSBE-së, avokati i parashtruesit të kërkesës nuk dukej të jetë në gjendje apo i gatshëm që t'i përgjigjet pyetjeve të Kryetarit të Trupit Gjyqësor. Ky rast duket të jetë shembull i marrëveshjes së fshehtë në mes të palëve dhe gjyqtarëve në nivel të gjykatave të rregullta. Gjyqtarët e Dhomës së Veçantë kanë përmendur se kanë vërejtur ndodhi tjera të marrëveshjeve të fshehta.

<sup>226</sup> Në të njëjtën datë, gjykata urdhëroi që Agjencia e Mirëbesimit të njoftohet lidhur me rastin.

<sup>227</sup> Datë 17 janar, 10 shkurt, 10 mars, dhe 4 maj 2005.

<sup>228</sup> Neni 32, Kodi i Etikës.

vonesë.”<sup>229</sup> Më së paku, avokati duhet që me kujdes të përcjellë rregullat e përcaktuara procedurale sipas ligjit në fuqi dhe të mbrojë klientin e tij.

Përkundër këtyre kërkesave të përfaqësimit ligjor efektiv, të kujdesshëm, dhe të zellshëm, OSBE-ja ka vërejtur paraqitje të dobët të disa avokatëve pranë Dhomës së Veçantë. Shqetësimet kryesore janë mungesat e njohurive për ligjet në fuqi, përgatitja e dobët dhe dështimi i avokatëve që t'i ndjekin seancat gjyqësore pa njoftuar paraprakisht gjykatën. Veç këtyre, avokatët kanë dështuar të paraqesin autorizimet e avokatit në gjykatë, ashtu siç kërkohet me ligj.

Rastet në vijim, bazuar në monitorim të drejtpërdrejtë nga OSBE-ja, shërbejnë si shembuj:

#### 1) Mungesa e njohurisë mbi ligjet në fuqi

Në dy raste të kombinuara pranë Dhomës së Veçantë, paditësit kërkonin anulimin e tenderit dhe privatizimit nga ana e Agjencisë së Mirëbesimit, si dhe ri-shpalljen e një tenderi të ri, të pronës së patundshme në fshatin e paditësve. Gjatë seancës së dëgjimit të datës 2 gusht 2007, avokati theksoi se ai nuk e dinte se me cilin ligj është marrë në pronë shoqërore në të kaluarën prona e pretenduar nga klienti i tij. Avokati shtoi se ai nuk e dinte procedurën formale të zbatueshme për shitjen e pronës. Prandaj, avokati në këtë rast kishte njohuri të pamjaftueshme të ligjit.

#### 2) Përgatitje e dobët apo dështim që të paraqitet në seancat gjyqësore

Në një rast pranë Dhomës së Veçantë, Kryetari i Trupit Gjyqësor pyeti avokatin e punonjësve në dëgjimin e datës 11 shtator 2007 se cila është baza ligjore e padisë, kush kishte shkaktuar dëm dhe kur kishte ndodhur kjo. Avokati disa herë tha vetëm se çdo gjë është e shkruar në padi.

Gjatë seancës së paraqitjes së provave të 18 gusht 2007 në Dhomën e Veçantë, avokati i paditësit nuk mund të shpjegonte asnjë çështje ligjore të rastit (që kishte të bënte me çështjen e vlefshmërisë së një kontrate për këmbim të pronës) pranë kolegjit. Meqë Kryetari i Trupit Gjyqësor nuk mund të vazhdonte seancën dëgjimore pa pranuar një deklaram të qartë të avokatit të paditësit, p.sh. lidhur me bazat ligjore të padisë, gjykatësi kërkoi nga avokati t'i paraqiste parashtresat e tij me shkrim dhe i shtyri procedurat.

Në një tjetër seancë të paraqitjes së provave në Dhomën e Veçantë, të datës 22 tetor dy avokatët e paditësit nuk mund t'i përgjigjeshin pyetjeve të Dhomës. Më saktësisht, avokatët nuk mund të sqaronin gjendjen e procedurave pranë gjykatave komunale lidhur me paditësin, të cilat ishin relevante për rastin. Prandaj, Kryetari i Trupit Gjyqësor e pezulloi rastin.

Është e qartë se avokatët në këto raste ishin dobët të përgatitur për seancat dëgjimore të gjyqit.

---

<sup>229</sup> Neni 50, Kodi i Etikës.

Cilësia e avokatëve të Agjencisë së Mirëbesimit në shumicën e rasteve dukej të jetë më e mirë sesa ajo e avokatëve që përfaqësonin palët private. Megjithatë, edhe avokatët e Agjencisë së Mirëbesimit, në disa raste, nuk ishin të përgatitur, apo kërkonin shtyrje për detyra të thjeshta procedurale apo që të njihen me dosjen:

Për shembull, gjatë një seance të dëgjimit në Dhomën e Veçantë, avokati i Agjencisë së Mirëbesimit erdhi i papërgatitur sepse shkresat e lëndës i ishin dhënë avokatit në çast të fundit. Në një rast tjetër, avokati i Agjencisë së Mirëbesimit ishte prezent mirëpo nuk mundi të përgjigjet në asnjë pyetje (seanca e datës 30 tetor 2007).

Veç kësaj, dështimet e rastit të avokatëve të Agjencisë së Mirëbesimit për t'u paraqitur për NSh-të si palë përgjegjëse në gjykatat e rregullta krijon rrezik të aktgjykimeve në mungesë të palëve kundër atyre NSh-ve, shpesh herë me shuma të mëdha.<sup>230</sup> Kjo nuk ndodh vetëm nëse gjykata e rregullt dhe menaxhmenti vendor i NSh-së nuk informojnë Agjencinë e Mirëbesimit, por madje edhe nëse Dhoma e Veçantë referon paditë kundër një NSh-je në gjykata të rregullta (dhe informon Agjencinë e Mirëbesimit mbi këtë):

Avokatët e një NSh-je dhe Agjencia e Mirëbesimit nuk janë paraqitur në seancat preliminare në një Gjykatë Komunale të mbajtur më 27 shtator 2007. Dhoma e Veçantë kishte referuar këtë çështje në Gjykatën Komunale dhe ka informuar Agjencinë e Mirëbesimit (palën e seancave gjyqësore) mbi këtë.

Agjencia e Mirëbesimit gjithashtu nuk ishte paraqitur edhe për NSh-në e paditur në një çështje të cilën Dhoma e Veçantë e kishte referuar në Gjykatën Ekonomike të Qarkut të Prishtinës/Priština më 28 shkurt 2007. Më 4 tetor 2007, Dhoma e Veçantë, më vonë, kundërshtoi ankesën e Agjencisë së Mirëbesimit kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Prishtinës/Priština.

Agjencia e Mirëbesimit këshillon se, me resurse të kufizuara asaj i duhet të përqendroj vëmendjen në raste specifike, Veç kësaj, në disa raste NSh-të sigurojnë avokatët e vet. Sipas Agjencisë së Mirëbesimit, nga ajo nuk kërkohet, dhe as që mundet t'i përfaqësojë të gjitha NSh-të lidhur me të gjitha paditë që kanë të bëjnë me to. Megjithatë, Rreziku që merr përsipër Agjencia e Mirëbesimit duke mos paraqitur mbrojtje në seancat gjyqësore të Gjykatës së rregullt është i qartë në aktgjykimin (i datës 1 nëntor 2007) e Dhomës së Veçantë në çështjen *Vehbi Thaqi dhe të tjerët kundër NSh Fabrika e Letrës* (SCA-07-0059).

Në këtë rast, paditësit kishin parashtruar padi kundër NSh-së pranë Dhomës së Veçantë në vitin 2005. Dhoma e Veçantë e ia referoi rastin Gjykatës Komunale në Lipjan/Lipljane dhe i përcolli një kopje të këtij vendimi Agjencisë së Mirëbesimit. Gjykata Komunale e shqyrtoi rastin dhe morri vendimin (i datës 27 shtator 2005) kundër NSh-së. Agjencia e Mirëbesimit nuk prezantoi asnjë mbrojtje në të mirë të

---

<sup>230</sup> Shih Idriz Hergaja e të tjerët kundër NSh Kosovoatex/Kosovka, SCA-06-0001 dhe Abaz Lushi dhe 911 të tjerë kundër Fabrikës së Gypave, NSh dhe AKM-së, SCA-06-008.



NSh-së dhe nuk parashtrori ankesë kundër vendimit. Paditësit më pas morën një urdhër për përmbarrim dhe tentuan ta marrin shumën sipas vendimit të gjykatës nga xhirollogaria e mirëbesimit e Agjencisë së Mirëbesimit në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Autoriteti Bankar refuzoi të bashkëpunojë. Pas kësaj, Agjencia e Mirëbesimit e vendosi NSh-në në likuidim dhe kërkoi nga Dhoma e Veçantë që t'i suspendoj të gjitha rastet kundër NSh-së. Megjithatë, kolegji i Dhomës së Veçantë i përbërë nga tre gjyqtarë i japi paditësve leje që të kundërshtojnë xhirollogarinë e mirëbesimit të Agjencisë së Mirëbesimit. Kolegji i plotë refuzoi kërkesën e Agjencisë së Mirëbesimit për ta rishikuar këtë vendim dhe shtoi se baza për të kërkuar këtë gjë qëndron në atë se Agjencia e Mirëbesimit nuk kishte prezantuar mbrojtje në procedurën pranë gjykatës komunale. Fakti se Agjencia e Mirëbesimit zgjedh që të mos sigurojë përfaqësim nuk mund të krijojë bazë për të anuluar vendimin tashmë përfundimtar dhe ligjor të gjykatës.<sup>231</sup>

### 3) Mungesa e autorizimit të avokatit

OSBE-ja, gjithashtu, është e shqetësuar për faktin që avokatët shpeshherë nuk parashtrojnë autorizimet e avokatit në Dhomën e Veçantë, siç kërkohet me ligjin vendor.<sup>232</sup>

Neni 21.4 i Urdhresës Administrative nr. 2006/17, kërkon që Avokati që e përfaqëson palën duhet të paraqesë në zyrën e regjistrimit pranë Dhomës së Veçantë një kopje të autorizimit me anë të së cilit ai autorizohet që ta përfaqësojë palën. Nëse avokati nuk e paraqet kopjen e autorizimit, Dhoma e Veçantë e hedh padinë si të papranueshme (neni 21.6).

Përkundër kësaj kërkesë ligjore, OSBE-ja ka vërejtur se në disa raste avokatët e parashtruesve të ankesës nuk mund të paraqitnin autorizim:

Në një rast lidhur me kundërshtimin e vendimit të komisionit të likuidimit të një NSh-je në Dhomën e Veçantë, vetëm 5 nga 61 punonjës ia kishin dhënë autorizimin e kërkuar avokatit në kohën e dëgjimit të datës 7 gusht 2007.

Një situatë e ngjashme është ngritur në një rast ku Dhoma e Veçantë kishte dhënë urdhër kundër synimit të Agjencisë së Mirëbesimit për të privatizuar tokën e kontestuar. Pas kësaj, paditësit ndërruan avokatët e tyre dhe avokatët e rinj kurrë nuk parashtruan autorizimet e tyre dhe asnjëherë nuk iu përgjigjen komunikimeve të Dhomës së Veçantë. Si rrjedhojë, më vonë Dhoma e Veçantë tërhoqi vendimin.

Në pajtim me rregullat në fuqi, Dhoma e Veçantë i shpalli ankesat si të papranueshme në rastet kur avokatët nuk paraqitnin autorizimet e tyre. Për shembull, shih vendimin e 20 korrikut 2006 (*Dragoljub Grujic e të tjerët në Ringov Peja, NSh kundër AKM-së, SCEL-05-0016*).

<sup>231</sup> Shih vendimin e Dhomës së Veçantë të datës 1 nëntor 2007 në çështjen *Vehbi Thaqi dhe të tjerët kundër NSh-së Fabrika e Letrës* (SCA-07-0059).

<sup>232</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2006/17, neni 21.4 -6 të diskutuar në Kapitullin VI. B.

Prandaj, në këto raste avokatët dështuan që të ndjekin me zell rregullat e caktuara procedurale sipas ligjit të zbatueshëm, gjë që nuk i shërbeu interesit më të mirë të klientëve të tyre, duke shkelur Kodin e Etikës.

#### D. Vonesat

OSBE-ja është e shqetësuar që vonesat në procedurat e gjyimit në Dhomën e Veçantë (apo proceduat që fillimisht ishin parashtruar në një tjetër gjykatë dhe të referuara në Dhomën e Veçantë) pengojnë administrimin e drejtësisë dhe me siguri shkelin të drejtat e palëve në gjykim brenda një kohe të arsyeshme.

E drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme nënkuptohet në garancinë e të drejtës për proces të rregullt gjyqësor (neni 6 i Konventës), e cila, po ashtu, aplikohet, në procedurat civile.<sup>233</sup> Për të përcaktuar atë që përbën “kohë të arsyeshme”, për qëllime të nenit 6 të Konventës, duhet të kushtohet kujdes në rrethanat e çdo rasti. Kjo përfshin ndërlikueshmërinë e çështjeve faktike apo ligjore që ngrihen nga rasti, sjelljen e paditësit dhe të shtetit.<sup>234</sup> Në këtë kontekst, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mori vendim që shtetet duhet të organizojnë sistemet e tyre ligjore ashtu që të lejojnë gjykatat që t’i binden kërkesave të nenit 6 të Konventës.<sup>235</sup> Qëllimi i kësaj kërkesë është garantimi që brenda një kohe të arsyeshme, përmes vendimi gjyqësor, përfundohet pasiguria me të cilën përballet një person në lidhje me pozitën e tij karshi së drejtës civile.<sup>236</sup>

Megjithatë, autoritetet publike nuk janë përgjegjëse për vonesat që i atribuohen palëve ose avokatëve të tyre, andaj vonesat e tilla nuk merren parasysh kur vendoset se a e plotëson rasti standardin e “afatit kohor të arsyeshëm”.<sup>237</sup> Megjithatë, avokatët duhet të përmirësojnë performansën e tyre dhe të veprojnë në pajtim me obligimet e tyre nën Kodin e Etikës, në mënyrë që të shmangen vonesat.<sup>238</sup>

Përderisa shumica e lëndëve gjyqësore që u shqyrtuan tregonin një menaxhim aktiv të rasteve nga Dhoma dhe veprime me kohë nga ana e palëve, në disa raste kishte edhe vonesa substanciale:

Një vonesë e gjatë ngjau në një lëndë të cilën Gjykata Ekonomike e referoi në Dhomën e Veçantë më 12 qershor 2003 për shkak të mungesës së juridiksionit. Paditësi parashtroi padinë në Dhomën e Veçantë më 23 mars 2004. Pasi që kaluan katër muaj për përkthimin dhe qartësimin e padisë, paditësi dorëzoi përgjigjen e tij më 6 gusht 2004. Vonesa shitesë ngjanë në periudhën kohore tetor 2004 – shkurt 2005 dhe prej prillit

<sup>233</sup> Shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Moreira kundër Portugalisë*, 26 tetor 1988, aplikacioni nr. 11371/85, , paragrafi 46.

<sup>234</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Pailot kundër Francës*, 22 prill 1998 aplikacioni nr. 32217/96, paragrafi 61.

<sup>235</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Muti kundër Italisë*, 23 mars 1994, aplikacioni nr. 14146/88, , paragrafi 15; *Sussmann kundër Gjermanisë*, 16 shtator 1996, aplikacioni nr. Nr. 20024/92, paragrafi 55 dhe 56.

<sup>236</sup> P. van Dijk dhe G.J. H. van Hoof, *Teoria dhe praktika e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*, faqe 602.

<sup>237</sup> Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin, *Konig kundër Republikës Federative të Gjermanisë*, 28 qershor 1978, aplikacioni nr. 6232/73, i datës, paragrafët 97-114.

<sup>238</sup> Neni 50, Kodi i Etikës.

2005 deri më 9 gusht 2007 kur edhe u mbajt seanca e dëgjimit. Gjatë kësaj seance të dëgjimit, avokati i paditësve theksoi se është emëruar rishtas dhe kërkoi shtyrje në mënyrë që të njihet me lëndën. Kryetari i trupit gjykues shprehi shqetësimin e tij dhe tha se ai nuk mund të pranojë këtë kërkesë për shkak se emërimi i avokatit ka qenë i njohur gjashtë muaj më parë. Gjatë një seance të mëvonshme të dëgjimit të të njëjtit rast (31 tetor 2007) avokati i të paditurit deklaroi se ishte caktuar dy orë më herët dhe kërkoi shtyrje.

Në këtë rast, menaxhimi i dosjes së rastit nga ana e Dhomës së Veçantë mund të mos ketë qenë optimal, por avokatët apo klientët e tyre paraqiteshin për të keqpërdorur të drejtat e tyre procedurale dhe shkelnin Kodin e Etikës duke shkaktuar vonesa.

OSBE-ja, gjithashtu, ka vërejtur vonesa të konsiderueshme në disa raste tjera:

Pala parashtrroi padinë e saj në Dhomën e Veçantë më 5 korrik 2006 dhe i padituri (Agjencia e Mirëbesimit) pranoi padinë më 20 dhjetor 2006. Dhoma e Veçantë regjistroi përgjigjen më 19 janar 2007 por nuk caktoi seancën e dëgjimit deri më 6 shtator 2007.

Në rastin e dytë në Dhomën e Veçantë një kërkesë për masë të përkohshme (për të urdhëruar një tender të caktuar për datën 6 shtator 2006) u parashtrua në Dhomën e Veçantë më 4 shtator, por i ishte dërguar të paditurit (Agjencisë së Mirëbesimit) më 16 maj 2007. Për rrjedhim, (më 22 korrik 2007), Agjencia e Mirëbesimit ka shitur pronën të cilën parashtruesi i ankesës dëshironte ta bashkonte në urdhër.

Faktorë të ndryshëm mund të shkaktojnë vonesa. Në këto përfshihet numri i madh të lëndëve, mungesën e stafit dhe gabimet administrative nga ana e Dhomës së Veçantë, zvarritjen dhe keqpërdorimin e të drejtave procedurale nga palët apo avokatët e tyre dhe ndërrimet e avokatëve. Megjithatë, shkaktar i rëndësishëm është me gjasë cilësia e dobët e avokatëve (veçanërisht e atyre që përfaqësojnë paditësit). Shumica e padive të parashtruara në Dhomën e Veçantë janë të mangëta dhe kanë nevojë që të përmirësohen dhe të kompletohen para se të mund të fillojnë procedurat gjyqësore.

Për të mbrojtur të drejtat e palëve për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, siç kërkohet me të drejtën ndërkombëtare, Dhoma e Veçantë dhe Agjencia e Mirëbesimit duhet të minimizojnë vonesat në këto raste.

## **E. Gabimet Administrative**

OSBE-ja, po ashtu, ka vërejtur gabime të ndryshme administrative në monitorimin e saj të Dhomës së Veçantë:

Në disa raste, parashtruesi e një pale nuk ishte në dosjen e palës tjetër apo në dosjen e Dhomës së Veçantë. Ndryshimi i padisë është dërguar nga Dhoma e Veçantë te i padituri. Gjatë seancës së dëgjimit, ajo nuk ishte në dosjen e gjykatës. Në tri rastet e ndërlidhura, dy paditësit nuk kishin pranuar deklaratën e palës së paditur. Në rastin e tretë, gjatë seancës së dëgjimit, një nga parashtruesit e paditësit nuk ishte në dosjen e gjykatës.

Diçka e ngjashme ndodhi në një rast tjetër të monitoruar nga OSBE-ja.<sup>239</sup>

Në një çështje të listës së punonjësve, formulari i regjistrimit në administratën e Dhomës së Veçantë (dhe aktgjykimi i 10 tetorit 2006) thekson se “afati për parashtrimin e ankesave ishte 12.06.2006”. Megjithatë, Dhoma e Veçantë pranoi një ankesë e cila sipas të njëjtit formular të regjistrimit ishte e datuar 06 korrik 2006 (pas përfundimit të afatit).

## IX. KONKLUZION

Ky raport përmbledh ligjet e zbatueshme për Agjencinë e Mirëbesimit dhe Dhomën e Veçantë dhe shënon shqetësimet e OSBE-së lidhur me pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Vlen të përmendet, rregullat e Agjencisë e Mirëbesimit janë komplekse dhe, sipas mendimit të OSBE-së nuk i përmbushin kërkesat procedurale të Konventës nëse privatizimi shihet si shpronësim. Një problem i madh me ligjet e Dhomës së Veçantë është se ato nuk i ofrojnë palëve të drejtën për ankesë.<sup>240</sup>

Në monitorimin e drejtpërdrejt të rasteve të Dhomës së Veçantë, OSBE-ja ka vërejtur probleme siç janë mungesa e publikimit të vendimeve, marrja e gabuar e juridiksionit nga ana e gjykatave të rregullta në lidhje me çështjet që janë në juridiksion primar apo ekskluziv të Dhomës së Veçantë, kryerja e dobët e punës nga Agjencia e Mirëbesimit dhe avokatëve tjerë, si dhe vonesat në procedura

Privatizimi në Kosovë është në vazhdim e sipër që gati katër vite dhe Agjencia e Mirëbesimit ka shitur një numër të madh të NSh-ve më të mëdha dhe atyre më premtuese. NSh-të tjera të rëndësishme – siç është privatizimi lidhur me qendrën skitare në Brezovicë/Brezovica – ende nuk janë privatizuar. Shumë kompani tjera do t'i nënshtrohen likuidimit. Veç kësaj, Agjencia e Mirëbesimit duhet të finalizojë likuidimet dhe riorganizimet – siç është miniera e Trepçës – të cilat i ka filluar, por që nuk i ka përfunduar.

Meqë privatizimi do jetë vendimtar për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe politike të Kosovës, është me rëndësi që procesi i Agjencisë së Mirëbesimit dhe rishqyrtimi gjyqësor i Dhomës së Veçantë të jenë të drejtë, transparent dhe në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

---

<sup>239</sup> Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ka pasur shumë gabime administrative. OSBE-ja ka vërejtur se disa herë, dokumentet përkohësisht merren nga dosja kryesore e gjykatës nga ana e një gjykatësi përgjegjës për të shqyrtuar dosjen, apo për të bërë fotokopje dhe më pas janë kthyer prapa.

<sup>240</sup> Megjithatë, Rregullorja e re e UNMIK-ut Nr. 2008/4 Nr. 2008/4 e cila do të hyjë në fuqi me 31 mars 2008, parasheh të drejtën për ankesë..

## **REKOMANDIME**

### **Sugjerimet për ndryshime në Legjislacionin e Zbatueshëm**

- Të ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/18 në lidhje me Agjencinë e Mirëbesimit për të siguruar se rregullat që qeverisin privatizimin janë në përputhje me kërkesat e nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës në lidhje me mbrojtjen e pronës. Ligji duhet të mundësojë përcaktimin e pronësisë dhe rikthimin e aseteve të pronarët e tyre të ligjshëm para privatizimit. Ligji duhet të jetë i detajuar në mënyrë të mjaftueshme. Veç kësaj ligji duhet ta bëjë të qartë se cilat padi të pronësisë do të njihen (ligji mbi rikthim duhet të përpilohet dhe të miratohet).
- Duhet të definohet termi “mirëbesim”.
- Neni 13.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/1, i cili pezulloi të gjitha procedurat kundër NSh-ve në likuidim, përmes njoftimit të thjeshtë të Dhomës së Veçantë, duhet të ndryshohet në mënyrë që të lejojë për vendime ligjore për suspendim ose rishikim gjyqësor të vendimeve të tilla.
- Rregulloret e UNMIK-ut nr. 2002/13 dhe 2008/4, dhe Urdhëresa Administrative nr. 2006/17 duhet të ndryshohen për të siguruar që mos të ketë ndikime politike në emërimet gjyqësore.
- Të thjeshtësohet dhe zvogëlohet numri i Rregulloreve dhe Urdhësarave Administrative që qeverisin Dhomën e Veçantë, Agjencinë e Mirëbesimit dhe procesin e privatizimit. Konfliktet me ligjet tjera të Kosovës duhet të eliminohen, siç janë dëshmitë që kërkohen në çështje të diskriminimit dhe periudha kohore për të parashtruar ankesa ndaj aktgjykimeve.

### **Për Dhomën e Veçantë**

- Të publikojë dhe vë në dispozicion të publikut vendimet e gjyqit në kopje të shtypura dhe elektronike (p.sh. në internet).

### **Për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**

- Të qartësojë ligjin në fuqi dhe zgjidhjet e kontesteve në Rregullat e Tenderit.
- Të shpallë rregulla shtesë në lidhje me administrimin dhe likuidimin e NSh-ve dhe t'i bëjë publike politikat operative, si dhe raportet tremujore dhe vjetore të auditimit.
- Të sigurojë që të ketë përfaqësim efektiv ligjor për paditë kundër NSh-ve para gjykatave të rregullta ose në rastet pranë Dhomës së Veçantë në të cilat është palë.

**Për Odën e Avokatëve të Kosovës:**

- Të zhvillojë trajnime për avokatët për ligjet që qeverisin Dhomën e Veçantë, Agjencinë e Mirëbesimit dhe procesit të privatizimit.
- Të i disiplinojë avokatët të cilët shkelin Kodin e Etikës Profesionale.

## Shtojca I: Faktet dhe shifrat e Agjencisë së Mirëbesimit dhe Dhomës së Veçantë

### Dhoma e Veçantë

Dhoma e Veçantë filloi punën e saj në qershor të vitit 2003. Deri në tetor të vitit 2007, Dhoma e Veçantë ka pasur në radhët e saj 32 të punësuar, përfshirë pesë gjyqtarë (tre ndërkombëtarë dhe dy vendorë), pesë zyrtarë ligjorë (tre ndërkombëtarë dhe dy vendorë), një referent, pesë përkthyes dhe një procesmbajtës. Gjithsej, pjesë e stafit janë 12 ndërkombëtarë dhe 20 vendorë.

Nga gjyqtarët në detyrë, tre gjyqtarët ndërkombëtarë filluan punën në Dhomën e Veçantë në pjesën e parë të vitit 2005, një gjyqtar vendor arriti para vitit 2005 dhe gjyqtari tjetër vendor filloi në pjesë të parë të vitit 2007.

Dhoma e Veçantë i ndan lëndët në kategoritë vijuese: procedurat ankimore; aplikacionet me rregullore të riorganizimit; paditë e kreditorëve kundër vendimeve të komisioneve të likuidimit; dhe ankesat e listave të punonjësve.<sup>241</sup> Më poshtë, mund të shihni një studim të rasteve të parashtruara, të vendosura dhe në pritje të vendimit, të renditura sipas kategorive të sipërpërmendura.

### Rastet me Ankesë

Viti	Gjithsej ankesa të parashtruara	Gjithsej ankesa të vendosura	Gjithsej ankesa aktive
2005	4	3	1
2006	27	15	12
2007	59	5	54
Total	90	23	67

### Aplikacionet me Rregullore të Riorganizimit

Viti	Gjithsej aplikacione të parashtruara	Gjithsej aplikacione të vendosura	Gjithsej aplikacione aktive
2005	6	4	2
2006	1	1	0
Total	7	5	2

### Paditë kundër Vendimeve të Komisioneve të Likuidimit

Viti	Gjithsej padi të parashtruara	Gjithsej padi të vendosura	aktive
2006	7	3	4
2007	6	2	4
Total	13	5	8

<sup>241</sup> Ekziston edhe një kategori, rastet për mbrojtje të ligjshmërisë. Kjo kategori nuk është përfshirë këtu sepse OSBE-ja është në dijeni të vetëm një rasti të tillë.

## Ankesat e Listave të Punonjësve<sup>242</sup>

Viti	Gjithsej ankesa të parashtruara	Gjithsej ankesa të vendosura	Gjithsej ankesa aktive
2003	17	Të shtyra për 2004	0
2004	2101	2101	0
2005	2030	1978	3
2006	1251	1247	6
2007	1		1
Total	5385	5326	10

### Agjencia e Mirëbesimit

Agjencia e Mirëbesimit është organ i pavarur me subjektivitet të plotë ligjor.<sup>243</sup> Zyrat qendrore të AKM-së janë në Prishtinë/Priština ndërsa ka pesë zyra rajonale, në Prishtinë/Priština, Prizren, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peç dhe Gjilan/Gnjilane. Agjencia e Mirëbesimit ka një pjesë të përgjithshme (të drejta) të kapitalit prej 10,000,000 € nga të cilat 1,000,000 € janë paguar<sup>244</sup> nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.<sup>245</sup> Agjencia e Mirëbesimit ka Bordin e Drejtorëve që përbëhet prej tetë anëtarëve - katër drejtorë ndërkombëtarë dhe katër banorë të Kosovës.<sup>246</sup> Bordi cakton drejtorin menaxhues (i cili është anëtar i Bordit) dhe zëvendës drejtorët menaxhues pas emërimeve të Kryesuesit.<sup>247</sup> Agjencia e Mirëbesimit ka afërsisht 245 punonjës, përfshirë 44 ndërkombëtarë, 201 kosovarë dhe gjashtë konsulentë ndërkombëtarë. Rreth 30 pjesëtarë të stafit në zyrat qendrore punojnë me NSh-të, përfshirë dymbëdhjetë ndërkombëtarë dhe pesë juristë kosovarë.

Agjencia e Mirëbesimit ka një njësi të madhe për ankesa për regjistrimin dhe procedimin e dhjetëra mijëra ankesash, disa herë kundër Agjencisë së Mirëbesimit por kryesisht kundër NSh-ve. Në proceset e privatizimit, zakonisht ngrihen padi të pronësisë. Në proceset e likuidimit të NSh-ve, ngrihen padi të kreditorëve dhe ato i nënshtrohen vendimeve të Komisioneve relevante të Likuidimit dhe me siguri

<sup>242</sup> Dhoma e Veçantë theksoi se deri në tetor të vitit 2007 janë lëshuar vendime për 5326 ankesa të listave të punonjësve nuk janë lëshuar aktgjykime individuale për secilin paditës. Aty ku ka qenë e mundur, Dhoma ka përfshirë të gjithë parashtruesit e ankesave e çdo ndërmarrjeje të privatizuar në një aktgjykim. Megjithatë, këto raste disa herë shpenzojnë shumë kohë, meqë gjykata duhet të kontrollojë dëshmi të konsiderueshme për secilin ankues.

<sup>243</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 1.

<sup>244</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18, neni 17.

<sup>245</sup> Informata nga Agjencia e Mirëbesimit.

<sup>246</sup> Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron drejtorët e Kosovës, një nga të cilët do të jetë zëvendës-kryesues i Bordit. Tre nga drejtorët kosovarë janë ministra të Qeverisë së Kosovës, përfshirë një ministër të komunitetit serb. Ministri i katërt kosovar është kryetar i Federatës së Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Drejtorët ndërkombëtarë janë Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik, i cili është Kryesues i Bordit; Ndihmësi i Zëvendës Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Rindërtim Ekonomik; Zëvendës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për Administratë Civile, si dhe Drejtori Menaxhues i Agjencisë së Mirëbesimit. Drejtorët tjerë, përveç kryesuesit dhe zëvendës-kryesuesit kanë mandat të ripsëritshëm dyvjeçar.

<sup>247</sup> Bordi i Drejtorëve mund të shkarkojë drejtorin menaxhues dhe zëvendësdrejtorët menaxhues në çdo kohë, në pajtim me nenin 15.5 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/18.



rishikimit të Komisionit të Rishikimit dhe pastaj rishikimit të mëtutjeshëm nga ana e Dhomës së Veçantë.<sup>248</sup>

Që nga nëntori 2007 numri i përgjithshëm i NSh-ve të cilat administrohen nga Agjencia e Mirëbesimit është përafërsisht 650. Varësisht nga vlera, madhësia dhe rëndësia e NSh-së së caktuar, Agjencia e Mirëbesimit administron disa NSh nga afër, e disa tjera nga largësia. NSh-të më domethënëse” përfitimet e zhvillimit ekonomik të të cilave dukej të ishin më të mundshme apo komplikimet teknike (p.sh. kadastrale) të të cilave dukeshin minimale, janë privatizuar, me likuidim ose në pritje. Që nga nëntori 2007, Agjencia e Mirëbesimit ka qenë e përfshirë në privatizimin e përafërsisht 320 NSh-ve (për të cilat përafërsisht ishin krijuar 350 filiale) dhe 110 NSh janë vendosur në procedurë të likuidimit. Nga pjesa e mbetur e NSh-ve, një numër i tyre pritet t’i nënshtrohen privatizimit dhe likuidimit. NSh-të tjera, asetet e të cilave janë të parëndësishme apo komplikimet teknike të të cilave (mungesa të regjistrave kadastrale, etj) janë të larta, vetëm do të likuidohen. Asnjë proces i likuidimit nuk është finalizuar ashtu që (apo për shkak se) kreditorët akoma nuk i kanë pranuar pagesat.<sup>249</sup>

---

<sup>248</sup> Urdhëresa Administrative Nr. 2007/1, neni 9.

<sup>249</sup> Sipas informatës të pranuar gjatë një interviste me një zyrtar të Agjencisë së Mirëbesimit, nëntor 2007.